

Janar 2012  
Numri: 46  
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - [www.revistaetika.com](http://www.revistaetika.com)

# ETIKA

Shqipëri: 150 Lek  
Kosovë: 1 Euro  
Maqedoni: 60 Den



**KOHA  
E DASHURISË  
DHE E VËLLAZËRISË**



# Editorial

Kujtoni atë begati dhe...

Kapuni fort pas litarit të Allahut...

Ja pra, ju që ishit armiq të njëri-tjetrit...

Që ishit në skaj të gropës së zjarrit...

Zemrat tuaja ishin shndërruar në gropa prej zjarri. Smira, urrejtja dhe armiqësia jua kishin kapluar zemrat tuaja...

Allahu ju shpëtoi juve prej aty.

***"Zemrat tuaja u ngrohën për njëra-tjetrën dhe me begatinë e Zotit ju u bëtë vëllezër të njëri-tjetrit."***

Vëllazëria...

Krijesa që ngroh zemrat me njëra-tjetrën dhe e konsiderojmë si "vëllazëri" në marrëdhëniet tona, është mirësi nga Krijuesi ynë.

Zoti caktoi parimin që ***"Besimtarët janë vëllezër me njëri-tjetrin"***.

Afrimi i zemrave me njëra-tjetrën ka qenë përherë i vështirë.

Ja çfarë i thotë Krijuesi të dërguarit të Tij besnik:

***"...Sikur të shpenzoje tërë pasurinë që gjendet në tokë, nuk do të mund t'i bashkoje zemrat e tyre, por Allahu i bashkoi ato. Ai është vërtet i Plotfuqishëm dhe i Urtë."***

Zoti bëri që ne ta duam imanin...

Ai e gdhendi besimin në zemrat tona...

***"Ai bëri që ne të mos pëlqejmë mosbesimin, largimin nga rruga e drejtë dhe gjynahun..."***

Pra zemrat janë lidhur pas kritereve të Zotit.

Kështu u arrit që zemrat të afrohen me njëra-tjetrën.

Kështu u realizua vëllazëria.

I Dërguari i Allahut ndërtoi nga mesi i shoqërisë, që njihet si "shoqëria e injorancës" një shoqëri dashurie nën dritën e vahjit, me shenjat e Zotit të Plotfuqishëm, duke u strehuar nën ndihmën dhe favorizimin (lutuf) e Tij, por dhe duke punuar sikur të ishte duke "thurrur zemrën e ndjeshme" të kësaj shoqërie.

Populli injorant e kishte mposhtur krenarinë e tij të sëmurë...

Shoqëria e kishte mposhtur krenarinë e saj të sëmurë...

Gjuha e lëkurës, raca dhe gjuha që flitej, e patën mposhtur krenarinë e tyre të sëmurë...

Pasuria, paraja, familja dhe rrethi familjar, e patën mposhtur krenarinë e tyre të sëmurë...

Në zemra që gdhendur kriteri se "arabi nuk është më i mirë se joarabi, se përparësia matej vetëm me devotshmëri"... ndonëse që arab, populli i tij që lidhur pas një konsistence humane që vinte në vend të parë cilësinë e njeriut, devotshmërinë dhe varësinë ndaj Krijuesit.

Përreth Profetit (a.s.) gjendeshin:

Ebu Bekri, që ishte arab...

Selmani persian...

Suhejbi romak...

Bilali etiopian...

Duke qëndruar krah për krah për të formuar ume-tin...

Kjo ishte një bashkësi besimi...

Duke gdhendur në histori përfundimin se "kjo është shoqëria që ndërton feja islame".

# Do të lexoni:



- Ahmet Tashgetiren / 4** Koha e dashurisë dhe e vëllazërisë
- Nexhat Ibrahimimi / 8** Hixhreti dhe sfondi i tij shumëdimensional -2-
- Alltan Murat Ynall / 11** Islami dhe shija estetike
- Ma. Gilman Kazazi / 12** Islami dhe Laicizmi
- Prof. dr. Ibrahim Sarmësh / 14** Të kamurit e kohës së Kuranit
- Prof. dr. Ismail L. Çakan / 17** Nëse puna si jepet ekspertit
- M. Sami Ramazanogllu / 20** Të mbash në këmbë drejtësinë
- Edison Çeraj / 22** Raporti i qytetit me tempullin
- Prof. dr. Hasan K. Jëllmaz / 24** Hasan Basriu (r.a.)
- / 28** Fotoja e muajit
- / 30** 20 vjet Medrese
- Mustafa Erish / 32** Nga duhet të fillojmë që ta lexojmë dhe mësojmë Islamin?
- Imam Muhamed Sytari / 36** Vlëra dhe dëshmi nga një libër që nxit respekt

**Ahmet Tashgetiren /**  
Koha e dashurisë dhe e vëllazërisë

4



**Prof. dr. Ibrahim Sarmësh /**  
Të kamurit e kohës së Kuranit

14



**Mustafa Erish /**  
Nga duhet të fillojmë që ta lexojmë dhe mësojmë Islamin?

32



Viti: VI | Numri: 46 | Janar 2012

Drejtor & Kryeredaktor:

**Alban Kali**

albankali@yahoo.com

+355 67 20 86767

Redaktor:

**Zija Vukaj**

Korrektore:

**Ma. Irida Hoti**

Përkthyesit:

**Albert Halili / Arjan Ymeraj / Artur Tagani**

**Elona Sytari / Fatmir Sulaj / Ilir Hoxha**

Kopertina:

**Edison Çeraj**

Dizajn-Grafik:

**Bledar Xama**

Për artikuj:

e-mail: revistaetika@progresibotime.com

e-mail: kosova@progresibotime.com

e-mail: maqedoni@progresibotime.com

# Janar 2012

40

**Osman Nuri Topbash /**  
Edukata dhe mirësjellja



48

**Doç. dr. Fahredin Jëlldëz /**  
Bindja



54

**Nuredin Nazarko /**  
Të jetosh me të vërtetën



Një Ajet - Një Hadith  
Edukata dhe mirësjellja  
Krizë financiare globale:  
A mund të ofrojë ndihmë financa  
islame në zgjidhjen e saj?

**38 -39/**

**40 / Osman Nuri Topbash**

**46 / Idrir Bektashi M. B. A.**

Bindja

**48 / Doç. dr. Fahredin Jëlldëz**

Refleksione rreth krijimtarisë së  
shkrimtarit Tefik Gjyli  
në gjininë e përrallës -2-

**50 / Xhahid Bushati**

Të jetosh me të vërtetën

**54 / Nuredin Nazarko**

Tefsiri i surei Qeutherit

**56 / Zani i s'kaluemes**

Zoti të pret të pendohesh,  
kurse ti refuzon?

**58 / Imam Naim Drijaj**

Proza në kulturën Islame

**60 / Ma. Artur Tagani**

Dispozitat e udhëheqjes dhe  
zgjedhjes së prijësit (kalifit)

**62 / Ma. sci. Flamur Sofiu**

Toleranca e myslimanëve  
ndaj të krishterëve të spanjës

**66 / Enciklopeti Islame**

Fermanët e sulltanëve  
në mbrojtje të të drejtave  
të jomyslimanëve në Shqipëri

**68 / Ma. Ermal Nurja**

Hz. Erva binti Abdulmutalib  
halla e Profetit (a.s.)

**70 / Familja**

**PROGRESI**  
BOTIME  
www.progresibotime.com

**Adresa:**

**L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi**

**Shkodër / Albania**

**Tel: +355 22 254 634**

**Fax: +355 22 254 633**

**Zyra e përfaqësimit Maqedoni**

Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25

Shkup / Maqedoni

+389 71 956 271

**Zyra e përfaqësimit Kosovë:**

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin

Prizren / Kosovë

Tel: +381 29 222 795

Fax: +381 29 222 797

+377 4411 98 48

**Çmimi:**

**Shqipëri: 150 Lekë**

**Abonim (një vjetor): 1500 Lekë**

**Kosovë: 1 Euro**

**Abonim (një vjetor): 10 Euro**

**Maqedoni: 60 DEN**

**Abonim (një vjetor): 720 DEN**

**Europë: 2 Euro**

**Abonim (një vjetor): 24 Euro**



# Koha e dashurisë dhe e vëllazërisë

Ahmet Jashgetiren

**D**allë, a kemi paqe me veten? A janë të gjitha organet e trupit në harmoni me njëra-tjetrën?

A janë mendja dhe shpirti në paqe me egon tonë? A janë trupi dhe shpirti ynë në gjendjen e prehjes apo kënaqësisë që prodhon dashuria? Apo mos janë në gjendje nevoje me to?

A jeton familja, e cila duhet të jetë edhe vatra e dashurisë, por njëkohësisht edhe atmosfera e lumturisë ku gjendet dashuria, brenda një dashurie të thellë? A janë marrëdhëniet mes bashkëshortëve, mes vëllezërve, mes prindërve dhe fëmijëve, marrëdhënie mëshire dhe dashurie të thellë? Apo mos vallë dosjet e shkurorëzimit që vihen palë-palë çdo ditë, lajmërojnë ftohtësinë që kaplon zemrat brenda familjes? Çfarë paralajmërojnë krimet brenda familjeve?

A ekziston ndjenja e thellë e dashurisë dhe dedikimi në marrëdhëniet e tubimeve dhe bashkimeve të formuara për shërbim në rrugën e Allahut? Apo mos vallë ndjenjat që brejnë zemrat dhe shkrijnë sinqeritetin, siç janë mendjemadhësia, dëshira për të dalë në plan të parë, dëshira për lidhshmëri, përgojimi, kanë marrë dhenë së bashku me njerëzit dhe janë duke asgjësuar virtytet e hijshme?

Çfarë sundon në marrëdhëniet ndërmjet këtyre grupeve që i shërbejnë fesë? Opinioni i mirë për njëri-tjetrin, lutjet që tjetri të jetë i suksesshëm aq sa dëshirojmë të jemi edhe ne vetë, lutje mëshire dhe dashurie për njëri-tjetrin? Një miqësi e ngrohtë? Apo mos ndoshta edhe zili për mëshirën hyjnore? Të qëmtosh të metat e tjetrit? Të cilësosh të mangët çdo punë të tjetrit? Të përgojosh? Madje edhe të shpifësh? Të përpiqesh të ngresh pengesa të vazhdueshme, që të presësh rrugën e të tjerëve drejt xhenetit?

Përkatësia ndaj një medhhebi, që është formuar në rre-

dhën e historisë islame, a është lufta jonë që çdo gjë tonën ta "shndërrojë në çdo gjë për Allahun" apo përpjekje që të përjashtojmë të tjerët "nga rruga e Allahut"? Të kapur nga ndjenjat e garës për hir të Allahut, a shohim me mirë-kuptim përpjekjet më të mëdha që bëjnë të tjerët në këtë drejtim dhe ndiejmë gëzim apo përpiqemi që të pengojmë njëri-tjetrin në këtë rrugë, duke futur shkopinj në rrota? Çdo të thotë të hedhësh bomba nëpër "faltoret" e pjesëtarëve të këtij apo atij medhhebi mysliman, kur feja jonë islame është treguar aq delikate, saqë ka urdhëruar që të mos preken as faltoret e feve të tjera? Pra, çfarë shkruhet në regjistrin e veprave të atyre që hedhin bomba në vendet ku i bëhet sexhde Allahut? Si do ta shpien atë regjistër veprash përpara Allahut?

Po fakti që dy bashkësi myslimane luftojnë me njëra-tjetrën, në emër të kombeve dhe shteteve të ndryshme, të cilave u përkasin? Me vite të tëra... Duke u derdhur gjaku i dhjetëra dhe qindra mijëra njerëzve? Cila përkatësi myslimane e ushqen këtë gjë? Çfarë qëndrimi pret prej Krijuesit ai që thotë se "është mysliman iranian, prandaj ka vrarë kaq ose aq myslimanë irakenë" apo myslimani iraken që shpall një listë të ngjashme masakrash? A nuk do të takohen këta njerëz me njëri-tjetrin të nesërmen nën flamurin e Lavdërimit të të dërguarit të Allahut? Mos vallë do të zhveshin shpatat dhe do të derdhin bomba mbi njëri-tjetrin, kur të takohen nën atë flamur? A do të kërkojnë edhe nën atë flamur që të marrin jetë njerëzish? A do të përtypin mishin e vëllait mysliman që kanë vrarë?

Po dëshira për t'u quajtur më superiorë, që ushqejnë ndaj njëri-tjetrit popujt myslimanë, që jetojnë brenda një shteti... dëshira për t'u hequr me të madhe...Tregtia e tyre prej urrejtjeje dhe smire...Pretendimet e tyre për epërsi ndaj njëri-tjetrit, përjashta afërsisë së Allahut... Në hapësirën e mahsherit, aty ku kombet dhe shtetet humbasin kuptimin e tyre, për cilin konflikt do të hidhen njerëzit? Çfarë do të shpien ata përpara Allahut në ditën e gjykimit? Smirën që ushqejnë për njëri-tjetrin apo ndjenjën e robërisë ndaj Allahut?

A mund të vlerësohet kjo si diçka prej myslimani?

Pa mendo njëherë rreth "begatisë që të ka dhuruar Allahu"...

Kujtoni atë begati dhe...

Kapuni fort pas litarit të Allahut...

Ja pra, ju që ishit armiq të njëri-tjetrit...

Që ishit në skaj të gropës së zjarrit...

Zemrat tuaja ishin shndërruar në gropa prej zjarri. Smirra, urrejtja dhe armiqësia jua kishin kapluar zemrat tuaja...

Allahu ju shpëtoi juve prej aty.

**"Zemrat tuaja u ngrohën për njëra-tjetrën dhe me begatinë e Zotit ju u bëtë vëllezër të njëri-tjetrit."** (Ali Imran, 103.)

Vëllazëria...

Krijesa që ngroh zemrat me njëra-tjetrën dhe e konsiderojmë si "vëllazëri" në marrëdhëniet tona, është mirësi nga Krijuesi ynë.

Zoti caktoi parimin që **"Besimtarët janë vëllezër me njëri-tjetrin"**.

Afrimi i zemrave me njëra-tjetrën ka qenë përherë i vështirë.

Ja çfarë i thotë Krijuesi të dërguarit të Tij besnik:

**"...Sikur të shpenzoje tërë pasurinë që gjendet në tokë, nuk do të mund t'i bashkoje zemrat e tyre, por Allahu i bashkoi ato. Ai është vërtet i Plotfuqishëm dhe i Urtë."** (Enfal, 63.)

Zoti bëri që ne ta duam imanin...

Ai e gdhendi besimin në zemrat tona...

**"Ai bëri që ne të mos pëlqejmë mosbesimin, largimin nga rruga e drejtë dhe gjynahun..."** (Huxhurat, 7-8.)

Pra zemrat janë lidhur pas kritereve të Zotit.

Kështu u arrit që zemrat të afrohen me njëra-tjetrën.

Kështu u realizua vëllazëria.

I Dërguari i Allahut e pati ndërtuar nga mesi i shoqërisë, që njihej si "shoqëria e injorancës" këtë shoqëri dashurie nën dritën e vahjit, me shenjat e Zotit të Plotfuqishëm, duke u strehuar nën ndihmën dhe favorizimin (lutuf) e Tij, por dhe duke punuar sikur të ishte duke "thurur zemrën e ndjeshme" të kësaj shoqërie.

Populli injorant e kishte mposhtur krenarinë e tij të sëmurë...

Shoqëria e kishte mposhtur krenarinë e saj të sëmurë...

Gjuha e lëkurës, raca dhe gjuha që flitet, e patën mposhtur

krenarinë e tyre të sëmurë...

Pasuria, paraja, familja dhe rrethi familjar, e patën mposhtur krenarinë e tyre të sëmurë...

Në zemra që gdhendur kriteri se "arabi nuk është më i mirë se joarabi, sepse përparësia matej vetëm me devotshmëri"... ndonëse që arab, populli i tij që lidhur pas një konsistence humane që vinte në vend të parë cilësinë e njeriut, devotshmërinë dhe varësinë ndaj Krijuesit.

Ata që dridheshin nga madhështia e tij, profeti i kishte qetësuar me fjalët: *"Unë jam djali i një gruaje prej fisit kurejsh, që ushqej me mish të thatë."*

Ai që larguar nga kjo jetë duke shpallur me fjalët: "Binduni ndaj kryetarit tuaj, edhe në qoftë se ai është një i ri, etiopian me lëkurë të zezë si rrushi i thatë", se madje edhe maja e drejtimit të shoqërisë nuk u takon staturave të veçanta.

Ai kishte shkelur mbi ndjenjat e veta, kur kishte falur edhe vrasësin e xhaxhait të tij më të dashur; edhe personin që i kishte shqyer mushkëritë dhe ia kishte ngrënë të gjalla...

Ai kishte shkallmuar vrerin dhe urrejtjen e formuar mes fiseve Evs dhe Hazreth ndër vite luftëra.

Duke realizuar vëllazërimin mes besimtarëve të Mekës me ata të Medinës, ai pati arritur të gdhendte në zemra se pronësia mbi paratë dhe objektet, në një shkallë të caktuar është vetëm relative...

Ja, në këtë pikë përreth tij gjendeshin:

Ebu Bekri, që ishte arab...

Selmani persian...

Suhejbi romak...

Bilali etiopian...

Duke qëndruar krah për krah për të formuar umetin...

Kjo ishte një bashkësi besimi...

Duke gdhendur në histori përfundimin se "kjo është shoqëria që ndërton feja islame".

Një ditë Ebu Dheri, njëri nga besimtarët që qëndronte pranë të dërguarit të bekuar, i pati thënë Bilal etiopianit: "O djali me nënë të zezë"... Bilali që pikëlluar shumë nga këto fjalë. Atë që ngjau, ia patën treguar të dërguarit të Allahut. Ai e pati thirrur Ebu Dherin dhe e pati vënë në dijeni për mërzinë që kishte ndjerë nga ato fjalë. Fjalët e tij: "O Ebu Dher, fëmija me nënë të bardhë nuk ka ndonjë epërsi ndaj fëmijës me nënë të zezë", qenë bërë përmendore të kriterit islam të humanizmit.


Pasi e kishte kuptuar se sa fjalë të rëndë kishte thënë, Ebu Dheri që shtrirë përdhe dhe i pati thënë Bilalit:

- Nuk ngrihem, pa më shkelur ti faqen me këmbë.

Bilali nuk pranonte një gjë të tillë, por e kishte kapur Ebu Dherin për krahu dhe e kishte ngritur në këmbë. Të dy qenë përqafuar vëllazërisht në prani të Profetit.

Ja pra...

Ky është kriteri që Islami vendosi për të dalluar të saktën



nga e gabuara.

Purifikimi dhe stolisja e personalitetit.

Feja islame ka realizuar këto dy gjëra në mënyrë që të sigurojë konsistencën e “vëllazërisë” në mesin e myslimanëve. Ai arriti që myslimanët ta purifikonin dhe ta stolisnin personalitetin e tyre.

E para: Synoi të purifikonte njerëzit nga ndjenjat dhe prirjet që pengojnë vëllazërimin.

E dyta: U përpoq që tek njerëzit, të ndërtonte ato veçori që e forcojnë vëllazërinë në zemra.

Islami dëshiroi që njerëzit të purifikoheshin prej:

- Përgojimeve. Pra që besimtari të mos flasë gjëra që vëllai i tij nuk dëshiron t'i thuhen.

Kurani e ka krahasuar përgojimin me ngrënien e mishit të njeriut, pra me një gjë shumë të neveritshme. Nga kjo mund të kuptojmë këtë gjë: Përgojim pra, është si të vrasësh vëllain tënd të dashur dhe më pas të përtypësh mishin e tij. **“E neveritshme apo jo?”** kumbon mesazhi i Krijuesit të Lartë. (Huxhurat, 12.)

Ja një ngjarje për të marrë mësim:

Një ditë, Aishja po fliste me të dërguarin e Allahut, në lidhje me Safijen dhe përdori një fjalë me të cilën dëshiron të thoshte se Safija qe trupshkurtër. I Dërguari i Allahut i tha Aishes:

“Ti the një fjalë të atillë që, po të përzihej me ujin e detit, do ta kishte fëlliqur atë.”

Sa fjalë rrënqethëse apo jo?

- Të flasësh pa e menduar atë që thua. Të flasësh rreth të tjerëve pa pasur njohuri të sigurt, është një veprim që nuk pajtohet me kriteret e Kuranit.

Mos shko pas diçkaje për të cilën nuk ke dijeni. Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjitha do të merren në llogari. (Isra, 36.)

- Mendimi i keq për tjetrin. Të pandehësh ashtu siç të vijnë, gjëra të ndryshme rreth njerëzve. Edhe kjo bie ndesh me kriteret e Kuranit.

**“O ju që keni besuar! Mënjaroni shumë dyshime, se vërtet, disa dyshime janë gjynah.”** (Huxhurat, 12.)

- Tallja. Edhe talljen duke bërë shenjë me sy e me vetulla, Kurani e konsideron ndër sjelljet që nuk i kanë hije personalitetit të besimtarit.

**“Mjerë për çdo përqeshës!”** (Humeze, 1.)

- Të mbartësh fjalë.

- Të shash një mysliman dhe ta fyesh atë, konsiderohet mëkat, ndërsa të luftosh me të, konsiderohet kufr.

- Të shkelësh mbi gjakun, nderin dhe personalitetin e një myslimani.

- Të shpifësh. Shpifja është një faj më i rëndë sesa përgojimi, sepse do të thotë të cilësosh një mysliman me një gjë që ai nuk e ka.

- Të ushqesh armiqësi.

- Ndërprerja e marrëdhënieve me një mysliman apo t'i kthesh shpinën atij, kur ka nevojë për ty.

- Të nënvleftësosh një mysliman.

- Ta konsiderosh se je kushedi se çfarë.

- Të ushqesh zili.

- Të kesh smirë. Të dëshirosh që myslimani të humbasë një të mirë që zotëron.

- Të kërkosh të dish të metat dhe gabimet e një myslimani. Kjo është e ndaluar.

- Të përpiqesh të mësosh një të fshehtë të tjetrit, të cilën ai nuk dëshiron t'i bëhet publike.

- Të mburresh me ndonjë gjë përpara të tjerëve.

- Të shtypësh.

- Të prishësh pazarin e tjetrit.

- Të etiketosh të tjerët me gjëra negative.

- Të gëzohesh për fatkeqësinë në të cilën ka rënë një mysliman.

I Dërguari i Allahut thotë: *“Mos u gëzo me fatkeqësinë që i ka ndodhur vëllait tënd besimtar, sepse mund të ndodhë që Allahu e mëshiron atë dhe ta sjell ty atë fatkeqësi.”*

- Të bësh dredhi.

- Të hash fjalën e dhënë.

- Të bësh premtime të gënjeshtërt.

- Të mos e ruash amanetin.

- Të tregohesh mosmirënjohës për të mirën që të është bërë.

- Të mbjellësh armiqësinë, ngatërresën dhe përçarjen mes myslimanëve.

- Të flasësh kur je në grup, duke pëshpëritur në vesh me njerëz.

- Të pozosh.

- Ti thuash një myslimani se është qafir.

- Të debatosh me myslimanët. Ta kalosh kufrin kur diskuton me një mysliman.

- Të dëmtosh me fjalë dhe me veprime një mysliman tjetër.

Të gjitha këto që numëruam janë karakteristikat e sjelljeve që plagosin personalitetin e myslimanit në rrugën e vëllazërimit, prandaj një mysliman duhet ta pastrojë personalitetin e tij nga këto vese. Në suren Huxhurat në Kuran, janë përcaktuar kriteret shumë të qarta në lidhje me “marrëdhëniet ndërmjet myslimanëve”. Format e sjelljeve që përmendëm më lart, përmenden edhe në hadithet fisnike të Profetit Muhamed.

## NDËRTIMI I NJË PERSONALITETI TË SHËNDOSHË

Përkrah kësaj edhe ndërtimi i veçorive që e forcojnë vëllazërinë në zemra, është përkufizuar si në fjalën hyjnore që gjendet në Kuran, ashtu edhe në kriteret e bekuara të Profetit Muhamed.

Në krye të këtyre veçorive vjen **“Të kapesh fort pas Allahut”** (Haxh, 78.) dhe **“Kapja e të gjithë besimtarëve pas litarit të Allahut dhe mospërçarja.”** (Ali Imran, 103.) Aty është edhe enigma e punës. Me çfarë i keni të zëna duart? Me kë janë të lidhura zemrat tuaja? Çfarë do të thotë për ju që të kapeni pas Allahut? Këto janë pyetjet themelore të vetëllogarisë në këtë botë dhe të llogaridhënies në botën tjetër? Të gjitha lidhjet, përkatësitë, pasionet që formohen pa menduar më parë këtë, të shpien në rrugë të gabuara. Të gjitha varësitë dhe përkatësitë, të gjitha emocionet dhe dashuritë, duhet të rreshtohen rreth “varësisë ndaj Allahut”.

Thelbi i personalitetit të myslimanit duhet të formohet në këtë mënyrë.

Përveç bindjes ndaj Allahut dhe të dërguarit të Tij, na kujtohet nevoja që “të mos grindemi dhe të mos sulmojmë njëri-tjetrin”, sepse këto situata nuk duhet harruar se dobësojnë besimtarët, ua thyejnë fuqinë që kanë, madje edhe shtetin që i mban. Prandaj duhet të tregohemi durimtarë gjatë sprovimeve të vështira...(Enfal, 46.) Kurani shpreh: **“Në qoftë se grindeni me njëri-tjetrin, atëherë do të dobësoheni”**. Një myfesiser e ka komentuar këtë ajet me fjalët “Humbni edhe shtetin tuaj”. Po të shohim se si myslimanët i kanë humbur shtetet e tyre në shekullin e fundit, për shkak të grindjeve të brendshme, mund të themi se ky komentim nuk është i huaj për ditët e sotme.

Një tjetër këshillë e Kuranit në lidhje me marrëdhëniet mes besimtarëve, në mënyrë që të ushqehet atmosfera vëllazërore, është nxjerrja në pah e modestisë. **“Modest me besimtarët dhe hijerëndë me qafirët...”** (Maide, 54.) apo “të paepur përpara qafirëve dhe të mëshirshëm për njëri-tjetrin”, është lloji i marrëdhënies. Pra i thuhet jo tolerancës me qafirët, kundrejt marrëdhënies të ashpra me njëri-tjetrin...

Në marrëdhëniet mes besimtarëve veprohet sipas parimit të kundërshtimit dhe refuzimit të gabimeve dhe gjynaheve që bën një person tjetër, jo kundër personalitetit të tij, si dhe sipas parimit që atë ta pastrojë nga gabimet, jo ta fshijë fare nga lista. Pra, qasja është shpëtimi i tjetrit nga mëkatet dhe jo distancimi total prej tij.

Dhe lutja... Të lutesh për të gjithë besimtarët... që zemra jonë të kërkojë që Zoti t’i falë të tjerët dhe të lutet që t’i pastrojë ata nga mëkatet.

Në këtë ajet na mësohet kjo dua:

**“O Zoti ynë, na fal ne dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!”** (Hashr, 10.)

Duhet që zemrat tona të duan dhe të përbuzin vetëm për hir të Allahut.

Thelbi i gjithë këtyre që shprehëm në këto rreshta, është kërkimi i një personaliteti, i cili është bërë një me dhembshurinë, dashurinë, mëshirën, gëzimin dhe keqardhjen dhe i cili e ka shndërruar në themelin e ndërtimit të marrëdhënies njerëzore dhe të shoqërisë, dashurinë që pasqyrohet nga atributi Vedud i Zotit dhe mëshirën që pasqyrohet nga atributet Rrahman dhe Rrahim të Tij.

Pa harruar këtë hadith të transmetuar nga i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ve sellem):

**“Nuk do të hyni në xhenet, derisa të besoni dhe nuk keni besuar siç duhet, përderisa nuk e doni njëri-tjetrin.”**

## EDUKIMI

Me kaq veçori të personalitetit që numëruam më lart, është e qartë edhe nevoja e edukimit të personalitetit të vendosur, në mënyrë që edhe të pastrohemi, edhe të stolisemi.

Pasi këto veçori mund të ndërtojnë një shoqëri myslimane dhe një personalitet mysliman që e ka përthithur ndjenjën e vëllazërisë, vetëm nëse arrijnë të zbatohen në jetën e përditshme.

Të arrijmë të edukohemi, duhet që të të jetojmë 24 orët e ditës sipas kësaj përpikmërie dhe në çdo çast t’i mësojmë nefsit tonë domosdoshmërinë e dashurisë për besimtarët.

Në thelb të edukimit duhet të qëndrojmë ndjeshmëria, që çdo besimtar duhet ta pranojmë si një pjesë të trupit tonë. Kjo mund të realizohet, vetëm nëse ekziston përcimi mes zemrave. Për këtë arsye, zemrat duhet t’i shndërrojmë në burime që mund të përçojnë rrymën mes tyre.

Sot besimtarët janë të pafuqishëm, shtetet e tyre shemben, umeti është disa herë më i madh për nga numri po të krahasohet me umetin e kohës së Profetit Muhamed, por shumë më i dobët në vendimmarrje...

Përse?

Ngaqë nuk zotëron nivelin e vëllazërisë që kishin sahabët mes tyre, kur gjendeshin përreth Profetit. Dinjitetin e umetit të formuar nga besimtarë që janë vëllazëruar aq shumë, saqë janë shkruar në njëri-tjetrin... Po të realizohet kjo gjë, çdo njëri prej nesh bëhet njëmijë. Po të realizohet kjo, vetë melekët vijnë të na ndihmojnë. Po të realizohet kjo, mëshira e Zotit do të jetë mbi umetin. Në qoftë se umeti mysliman bëhet si muri i formuar nga tullat e thurura mirë me njëra-tjetrën (bunjanun mersus), atëherë shndërrohet në një shoqëri syapatrembur, që mund të thotë: “Në kraharorin tonë shuajmë edhe flakët e xhehenemit, sepse kjo rrugë është rruga e Zotit dhe nuk ka kthim pas”.

Atëherë me fjalët “umeti mysliman” nuk do të nënkuptohen hapësira gjeografike ku jetojnë njerëz të shtypur, por do të na vijë ndërmend një bum qytetërimi.

Fjala e fundit: Të shohim zemrat tona. Çfarë ndjejmë për besimtarët në lindje dhe në perëndim? Çfarë ndjeni kur vlerësoni marrëdhënien tuaj me Zotin? Çfarë ndjejmë tek shëtisim mes zemrës, mendjes dhe nefsit?

Një umet që meritonte Profeti.

Këtë do të na kërkojnë të nesërmen në fushën e mahsherit.

Myslimani është njeriu që nuk e harron kurrë se çdo të ngjasë në mahsher dhe që përgatitet çdo çast për llogarinë që do të japë atje.





# Hixhreti

## dhe sfondi i tij shumëdimensional

### E TËRË ARABIA KUNDËR PEJGAMBERIT TË ALLAHUT

Arabia të bëhet kundër Pejgamberit (a.s.)! Përse? A nuk e quanin vetë ata "el-emin" (besnik) deri në atë kohë? A nuk i ofruan ata postin udhëheqës, pasuri që nuk e ka imagjinuar, femrat më të bukura e të tjera vetëm me një kusht: të heqë dorë nga idetë e tij të monoteizmit?

Përse ndodh kështu duke e marrë parasysh se edhe kundërshtarët e dinin se cilësitë e tij ishin kthjelltësia, largpamësia, oratoria, thjeshtësia, maturia, fisnikëria, njerëzia, dashuria, sinqeriteti, pastërtia e zemrës, dinjiteti, serioziteti, drejtësia, durimi, vendosmëria, trimëria, përkushtimi dhe dashuria e pafund ndaj Krijuesit.

Muhamed (a.s.) thotë:

*"Dija është pasuria ime, besimi është fuqia ime, durimi është veshja ime, e vërteta është mbrojtja ime, kënaqësia me pak është pasuria ime, përmendja e Zotit është biseda ime, gëzimi im është në namaz."*

Muhamedi (a.s.) iu drejtua mekasve me fjalët:

*"Idhujt që ju i adhuroni janë mashtrim i pastër. Pushoni së adhuruari. Kurrfarë qenie njerëzore, yje, dru, gurë nuk meriton të adhurohet. Mos e përlini kokën tuaj para tyre. Tërë kozmosi i përket Allahut të Gjithëfuqishëm. Vetëm Ai është krijuesi juaj. Vetëm Allahut duhet t'i përleni, ta lutni dhe t'i nënshtroheni. Prandaj, vetëm Atë adhurojeni dhe zbatoni urdhrat e Tij. Plaçkitja, vrasja, vjedhja, egërsia dhe padrejtësia janë krime. Largohuni nga mëkati. Flisni të vërtetën. Bëhuni të drejtë. Ju jeni qenie njerëzore kurse të gjitha ato janë të barabarta te Allahu. Bujar dhe i ndershëm është ai i cili ka drojë ndaj Allahut, i cili është i devotshëm. Njeriu më i devotshëm është ai që beson dhe punon vepra të mira. Ju do të jepni llogari për të gjitha*

*punët tuaja, të mira dhe të këqija. Asgjë nuk do të mund të fshihni. Tërë historia e jetës suaj do të jetë si libër i hapur para Zotit. Fati juaj do të varet nga veprat tuaja. Nuk do të mund t'i korruptoni. Vetëm besimi i vërtetë dhe veprat e mira do të merren parasysh në atë moment. Shpërblimi është xheneti, kurse ndëshkimi është xhehenemi."*

Tërë kjo armiqësi, pra, vinte për shkak se ai kërkonte nga ata ta adhurojnë vetëm Allahun, t'i luten Atij dhe të jetojnë jetë të ndershme dhe të drejtë.

Përse Muhamedi (a.s.) i duroi të gjitha këto vështirësi?

Në rrugën e të vërtetës Pejgamberi i Allahut i përballonte të gjitha me buzëqeshje. Madje, edhe kur u ndërrua strategjia, kur nga dhuna e kërcënimi iu ofrua pasuria, respekti dhe pushteti, ai mbeti i njëjtë.

Ja si e përshkruan Kurani përgjigjen e Pejgamberit (a.s.) nëpërmjet Kuranit:

**"Hâ, Mîm. (Kjo është) Shpallja prej të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit, Libër, argumentet e të cilit janë të qarta, (që është) Kurani në gjuhën arabe, për popullin që di, si sihariques dhe paralajmërues, por shumica e tyre janë shmangë (prej studimit të tij) e nuk duan të dëgjojnë, (por) thonë: "Zemrat tona janë të mbuluarra (blinduarra e nuk kuptojnë) atë që ti na thërret ne, veshët tanë janë të shurdhër për atë, e në mes nesh e teje ka perde, andaj puno ti (në idenë tënde), (por) me të vërtetë, dhe ne do të punojmë". Thuaj: "Unë, me të vërtetë, jam njeri si ju, mua më është shpallur që Zoti juaj është vetëm një Zot, andaj lutuni Atij sinqerisht dhe kërkoni falje prej Tij! E, mjerë për ata që i bëjnë shok Atij, të cilët nuk japin zeqatin dhe të cilët nuk**

**besojnë në jetën tjetër! Me të vërtetë, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira do të kenë shpërblim të pa-ndërprerë.”** (Fussilet, 1-8).

## VEPRA E TIJ ISHTE FJALA

Hixhreti ngërthen në vete këmbëngulësinë, vendosmërinë deri te e vërteta finale. Ai ishte manifestim i vlerave të pakundërshtueshme. As poetët, as predikuesit, as oratorët nuk iu afruan në asgjë Muhamedit (a.s.) Para popullit të tij u paraqit si filozof unik, reformator i jashtëzakonshëm, politikan i lavdishëm, gjykatës me nam, lider i madh dhe komandant i pakrahasueshëm. Muhamedi (a.s.) ligjëroi probleme të rënda teologjike dhe metafizike para njerëzve, diskutoi rreth rrënimin të popujve dhe perandorive, duke shtruar fakte nga e kaluara etj. Ishte tregtar i qetë dhe paqedashës por edhe ushtar i guximshëm. Shumë shpejt ushtria e tij u bë faktor në rajon. Ishte njeri i qetë por në çast u bë shtetar i madh dhe reformator politik. Për një kohë të shpejtë i unifikoi fiset e shpërndara, ua hoqi veset e liga, filloi ta arsimojë popullin. Barbarët dhe hajdutët e rrugës u shndërruan në njerëz të devotshëm e të drejtë, mësues e krijues. E tërë kjo u arrit pa dredhi, pa forcë, pa ashpërsi. Ai i fali armiqtë, madje edhe ata që e rrezikuan jetën e tij. Ju do të gjeni një Neron të madh, ju do të gjeni një Lekë të madh, ju do të gjeni në Xhingis-kan të madh, ju do të gjeni një Bonapart të madh, ju do të gjeni një Hitler të madh, por ju nuk do të gjeni edhe një Muhamed: i përsosur në të gjitha pikëpamjet e jetës.

## KUSH JANË MUHAXHIRËT?

Takimi në Akabë rezultoi me premtimin se medinasit do të marrin përgjegjësinë për mekasit e ikur në pikëpamje të sigurisë, të mirëqenies etj. Kështu edhe ndodhi. Të gjithë qytetarët (përveç hipokritëve) jetën e tyre personale, familjare dhe kolektive ia kanë përshtatur udhëzimeve hyjnore. Qenë të gatshëm në çdo kohë për çdo sakrificë: morale, fizike dhe materiale. Kjo ishte kështu sepse besimi i Pejgamberit (a.s.) në misionin e tij nuk u luhet kurrë. Nuk ka bërë kompromis me të vërtetën. Ishte i bindur thellë se misioni i tij ka përgjigje në çështjet e shumta të pazgjidhura të njerëzisë.

Një numër modest i njerëzve për fillim u zotua për këtë mision. Ky numër më vonë u shtua, që do të thotë se asgjë nuk ndodhi befasisht dhe rastësisht, por nga bindja dhe mësimi.

Kurani thotë:

**“Njerëzit mendojnë se do të lihen (të qetë) nëse thonë: “Ne kemi besuar! E që ata nuk do të vihen në provë?”** (El-Ankebut, 2)

**“A mendoni ju të hyni në xhennet pa i përjetuar ato (vuajtjet) ashtu si i kanë përjetuar të tjerët para jush? Ata i pat goditur mjerimi dhe sëmundjet dhe qenë tronditur aq shumë saqë pejgamberi dhe ata që ishin me të thirrën: “Kur më do të arrijë ndihma e Perëndisë?!” Ja, ndihma e Allahut është afër!”** (El-Bekare, 214)

Myslmanët e parë e pranuan Islamin me tërë zemrën pa dilema. Në shpërblime ishin modestë, ndërsa në ndëshkime vullnetarisht i shtroheshin ndëshkimeve. Motiv kryesor për mirëbërje ishte premtimi i xhenetit. Kur e pyetën Muhamedin (a.s.) se si mund të bëhen muhaxhirë ata që nuk janë, ai u përgjigj:

*“Muhaxhir është kushdo që braktis atë që Allahu e ka ndaluar, dhe kryen atë që ka urdhëruar.”*

Përbërja nacionale e grupit të parë të myslimanëve ishte e ngjashme me një kopsht të bukur lulësh: Ebu Bekri arab, Bilali etiopias, Suhejbi romak, Selmani persian etj. Lidhjet e tyre fetare i eliminuan ndjenjat e tyre fisnore dhe racore, dallimet e gjuhës dhe ngjyrës.

Brezi i parë kishte përgjegjësi të madhe kundrejt problemeve të kohës dhe këtë përgjegjësi tentonin t’ia mbëltojnë edhe shoqërisë së tyre të gjerë. Gjithnjë e kishin parasysht urdhrin kuranor:


**“Ju (besnikët e Kuranit) jeni njerëzit më të mirë nga i gjithë populli që janë paraqitur ndonjëherë:**

**dhe besoni Allahun...”** (Ali Imrani, 110)

**“Ne po ta tregojmë historinë e tyre me tërë vërtetësinë e saj. Ata, ishin djelmohat që besonin Zotin, dhe Ne ua forcuam atyre drejtimin. Ne, ua forcuam zemrat e tyre kur u ngritën dhe thanë: “Zoti ynë është Zoti i qiejve dhe i Tokës. Ne nuk lusim asnjë zot tjetër, përpos Tij. (Përndryshe) - atëherë do të thoshnim gënjeshtër të madhe.”** (El-Kehf, 13-14)

## KURANI SI FRYMËZIM SHPIRTËTOR PËR BREZAT E PARË TË MYSLIMANËVE

Kurani ka qenë kriteri i myslimanëve të parë për çdo gjë të huaj. Ata frymëzoheshin ekskluzivisht nga Kurani. Por, me kalimin e kohës gjërat u ngatërruan. Frymëzimi filloi të shtrihet pa kriter. Kjo bëri që të bie vlera e brezave të rinj para vetvetes dhe para të huajve.



Të frymëzuar nga Kurani muhaxhirët bënë shumë. Gjithashtu edhe ensarët në Medinë.

Ç'thotë Kurani për hixhretin?

***"Ata që besuan dhe emigruan dhe luftuan në udhën e Allahut, ata shpresojnë në mëshirën e Allahut. Allahu është mëshirues dhe fal."*** (El-Bekare: 218)

***"Dhe Zoti iu përgjigj lutjes së tyre: "Unë, nuk ia humb mundin asnjë punëtori nga ju, qoftë mashkull apo femër, - ju jeni të gjithë (të barabartë në shpërblim). Atyre që emigruan, dhe u dëbuan nga vatrat e tyre, dhe u munduan në rrugën Time, dhe luftuan e u vranë, Unë me siguri, do t'ua mbuloj veprat e këqija (me falje) dhe do t'i shpie në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, - shpërblim nga Allahu. E, shpërblimi më i mirë është te Allahu."*** (Ali Imran: 195)

## **DOMETHËNIA DHE RËNDËSIA E HIXHRETIT**

Është vështirë të shteren domethëniet e hixhretit me një shkrim apo me një ligjëratë. Sidomos kur shkrimi ka natyrë informative dhe të shkurtër. Megjithatë, do t'i cekim disa syrësh:

Hixhreti është ngjarja që i ndërroi rrjedhat e historisë në përmasa globale. Ai nuk është ikje para problemeve, por kërkim i mjedisit më të mirë, më të përshtatshëm për përhapjen dhe zhvillimin e myslimanëve. Hixhreti paraqet sakrificën kulmore të cilën njeriu mund ta bartë (duke e lënë pasurinë, familjen dhe farefisin) duke iu afëruar njerëzve të afërm sipas zemrës, shpirtit dhe bindjes. Hixhreti në anën tjetër është ndarje e të vërtetës nga e pavërteta. Është frymëzim dhe nxitje për besimtarët e sinqertë. Domethënia e hixhretit do të duhej të jetë edhe domethënia e jetës tonë.

Po ashtu, hixhreti është fillimi i aplikimit të gjerë të parimeve islame në pikëpamjen sociale dhe kulturore, është një revolucion social dhe shpirtëror, por njëkohësisht është ikje para tiranisë dhe dhunës. Hixhreti është braktisja e asaj që Allahu nuk e do, por edhe angazhimi drejt asaj që e kënaq Allahun. Ai ishte kthesë në jetën e myslimanëve të parë. Nga ky çast Islami është forcuar dhe myslimanët janë bërë të dinjitetshëm.

Hixhreti është kthesë e madhe në zhvillimin e njerëzisë, i cili ndodhi me dëshirën e Allahut. Hixhreti është harmoni e jetës së njeriut me ligjet e Zotit dhe ngadhënjim i shpirtit ndaj materies. Hixhreti është përpunimi i parë praktik i mendimit islam në histori. Në vete mbart idenë e aksionit, ndryshimit dhe rimëkëmbjes dhe është i vetëdijshëm se pa sakrificë, angazhim dhe plane e metoda të mira nuk ka rezultate dhe suksese. E tërë kjo duke e pasur parasysh pjekurinë e bindjeve fetare, idenë e përbashkësisë, humanitetit dhe drejtësisë.

Hixhreti është kthesë në historinë islame, ngjarje me rëndësi botërore; kjo datë u bë fillimi i kalendarit mysliman dhe fillimi i themelimit të shtetit të parë mysliman

në Medinë. Sikur të mos ishte hixhreti nuk do të ishte as Bedri, e sikur të mos ishte Bedri nuk do të ishte as tërë ai thesar mysliman në botë që ne njohim. Nga kjo datë numri i myslimanëve filloi të rritet, kur ushtria myslimane filloi të lëshojë shtat edhe jashtë Arabisë dhe të hedhë rrezet e para edhe në pjesën tjetër të botës. Hixhreti fillon më 1 muharrem 622, për të mos u ndalur deri në Ditën e Fundit, kur do të vazhdojë të jetojë vetëm Allahu i madhërishtëm.

## **MËSIMET NGA HIXHRETI**

Hixhreti ofron mësim të shumta, por disa janë të përgjithshme për të gjitha kohët dhe për të gjitha hapësirat. Disa janë:

- Myslimanët janë vëllezër qoftë si koncept shpirtëror qoftë si koncept historik.

- Solidariteti ndërmjet myslimanëve duhet të jetë i pakushtëzuar në baza racore, gjuhësore, territoriale etj., për hir të Allahut.

- Interesat e përgjithshme duhet të jenë prioritare kundrejt interesave individuale në të gjitha rastet dhe në të gjitha rrethanat.

- Mbështetja tek Allahu duhet të jetë e përhershme dhe e padiskutueshme. Kështu kanë vepruar myslimanët e parë. Kanë punuar ndershëm, me durim, kanë dhënë sakrificë të shumta, kanë ndihmuar nevojtarët, kanë luftuar të keqen dhe janë orvatur të jetojnë sipas parimeve të Kuranit dhe Sunetit, me mesazhin permanent: *"Nënshtroni Allahut dhe nënshtroni Pejgamberit"*.

## **THEMELIMI I KALENDARIT MYSLIMAN**

Në jetën e Muhamedit (a.s.) katër ngjarje do të mund të merreshin si rast për fillimin e erës islame. Këto ngjarje janë: Lindja e Muhamedit (a.s.), fillimi i shpalljes, hixhreti dhe ndërrimi i jetës së Muhamedit (a.s.)

Në mesin e shumë propozimeve, Aliu (r.a.) doli me propozimin që hixhreti të merret për fillim të erës islame. Arsyetimi i tij ishte: *"Hixhreti e ka ndarë të vërtetën nga gënjeshtria. Ai sollti që Islami të ndriçojë me shkëlqimin e plotë!"*

Ky propozim i pëlqeu Omerit (r.a.) dhe sahabëve të tjerë dhe propozimin të tij e pranuan menjëherë dhe e shndërruan në vendim.

Të gjithë popujt nga fillimi i botës e kanë shënuar historinë e tyre. Grekët e vjetër i numëronin ditët nga olimpiada e parë, romakët nga themelimi i Romës, hebraikët nga krijimi i botës, kristianët nga lindja e Isait (a.s.), kurse myslimanët nga hixhreti / migrimi i Muhamedit (a.s.) nga Meka në Medinë.

Bota myslimane sidomos kohëve të fundit ka filluar ta festojë Vitin e Ri hixhrij. Kjo është traditë e mirë, sepse është ndër ditët më të mëdha në historinë islame.

# ISLAMI DHE SHIJA ESTETIKE

*Alltan Murat Ynall*

**I**slami kërkon që jeta të konceptohet dhe të jetohet e plotë. Islami nuk e redukton fenë në xhami apo thjesht në ndjenjat individuale të personave, por paraqet botë-kuptimin e një mënyre jetese gjithpërfshirëse. Nëse shohim me vëmendje Kuranin dhe sunetin e Profetit tonë (a.s.), do të vëmë re se në to përfshihen të gjitha çështjet, që nga krijimi i universit e deri tek ndodhitë e thjeshta të jetës së përditshme. Civilizimi dhe arti islam, përfshin çdo fushë të jetës dhe kërkon që jeta të konceptohet me një botë-kuptim gjithpërfshirës.

Një nga rezultatet më të rëndësishme të botëkuptimit gjithpërfshirës dhe të plotë, është edhe shija estetike dhe marrëdhënia e kësaj shijeje me jetën e përditshme. Shija estetike është interesi i afërt që tregohet ndaj çdo gjëje të bukur. Në bazë të kësaj, shije estetike do të thotë të arrish të shohësh bukuritë e krijimit dhe të vlerësosh veprat e artit që dalin nga dora e njeriut.

Veçoria më e rëndësishme që vihet re në art, është zbulimi i bukurisë esenciale të gjërave dhe nxjerrja e tyre në dritë. Një nga emrat e Allahut es-Sani, është burimi i të gjitha koncepteve në lidhje me artin. Marrëdhënia midis artit dhe të vërtetave hyjnore është shumë e ngushtë. Nuk është e mundur të mos vërehet se në çdo vepër të krijuar nga Allahu ka një bukuri esenciale. Kur shohim gjuhën e përdorur në Kuran dhe moralin e Profetit tonë (a.s.), vëmë re se shija estetike zë vend në qendër të fesë.

Thjeshtësia dhe pastërtia e vendeve të adhurimit, ruajtja e qetësisë dhe e përqendrimin gjatë faljes së namazit, leximi melodik i Kuranit dhe i ezanit e shumë praktika të tjera, janë shembuj të cilët tregojnë se jeta e myslimanit bazohet në themele estetike.

Interesimi i njeriut për të bukurën, është një nga mirësitë më të mëdha që Allahu i ka falur atij. Për këtë arsye, çdo gjë që pasqyron bukurinë hyjnore, është një derë për tek Ai (Allahu). Myslimanët vunë re marrëdhënien e hyjnore dhe të së bukurës në personalitetin e Profetit (a.s.) dhe si pasojë, me shekuj të tërë i dhuruan njerëzimit vepra arti, që kanë lënë gjurmë të rëndësishme në histori. Ata zbuluan dhe ngjyrosën çdo fushë të jetës, që nga xhamitë, shtëpitë, rrugicat e deri tek letrat e shkrimit.

Ashtu si në adhurime, ku ekspozohen format estetike, është e domosdoshme që edhe jeta e përditshme të thuret përreth koncepteve të së bukurës dhe elegantes. Është një e vërtetë e pakundërshtueshme se arkitektura e xhamisë,

sistemi i ndriçimit dhe zbukurimet bëhen shkak që ritet e adhurimit të fitojnë dimensione të tjera. Prandaj, me qëllim që e njëjta gjendje shpirtërore të vazhdojë edhe jashtë xhamive, duhet që çdo vend të kthehet në qendër arti. Nëse shohim qytetet tradicionale islame, vëmë re se, jo vetëm xhamitë dhe shatërvanët, por edhe shtëpitë, rrugicat, spitalet dhe çarshitë janë të zbukuruar.

Për arsye se Islami synon unitetin e shpirtit të myslimanëve, kërkon që çdo fushë e jetës të zotërojë një shije dhe elegancë estetike. Prandaj, që nga qilimat, dyert e gdhendura, punimi i librave e deri tek arkitektura e shtëpive, prodhimet artistike, që janë vepra të civilizimit islam, zënë një vend konkret në jetën e përditshme të një bashkësie islame. Këto prodhime synojnë të zbukurojnë njeriun dhe rrethin ku ai jeton. Kështu arrihet të formohen bazat për unitetin e mendjes dhe shpirtit.

Dikush që sheh një vepër arti moderne, tërhiqet nga egoja e artistit, ndjenjat dhe bota e tij e brendshme. Ndërsa dikush që sheh veprat e artit islam, zhytet brenda vetes dhe fillon të kërkojë bukuritë e shpirtit të tij. Civilizimi islam ka ndërtuar një botë ku ka zbukuruar çdo fushë të jetës, që nga lugët, qilimat, dyert, urat e deri tek xhamitë. Ndërsa sot, për të parë diçka të bukur, jemi të detyruar të shkojmë nëpër muze e panairë kulturore. Veprat artistike janë vendosur pas xhamave, ndërsa estetikja dhe e bukura nuk janë më pjesë e nevojës, por pjesë e luksit. Prandaj askush nuk mund të pretendojë se kjo gjendje nuk ndikon negativisht në shpirtin e njeriut.

Me anë të artit, islami synon integritetin e jetës. Jeta e një myslimani duhet të jetë një vepër arti më vete. Prandaj, që nga marrëdhëniet me njerëzit, përgatitja e një gjelle, mënyra e uljes e deri tek mënyra e bisedës, myslimani duhet të veprojë me të njëjtin synim. Kur e gjithë jeta të thuret si një qilim, atëherë do të arrihet një botë ku të gjithë do të jenë të lumtur. Veprimet e shëmtuara, punët shkel e shko, mosvlerësimi i jetës dhe fjalët që thyejnë zemrat, sjellin vetëm hidhërim dhe mërzi.

Për shkak se islami përfshin të gjitha fushat e jetës, myslimani nuk duhet të zbukurojë vetëm namazin apo agjërimin e tij, por ai duhet të kontribuojë në zbukurimin e çdo gjëje që vepron, çdo vendi dhe çdo shoqërie ku jeton. Mjafton që çdo punë të realizohet me dashuri dhe aftësi, duke synuar kënaqësinë e Allahut. Vetëm atëherë do të jetë e mundur që jeta të shijohet me gjithë kuptimin e fjalës.

# Islami dhe laicizmi

Ma. Gilman Kazazi

**N**ë këtë kumtesë të shkurtër mbi një temë të gjerë, mund të bëhet vetëm një skicë e disa pikëpamjeve kryesore në lidhje me Islamin dhe Laicizmin.

1. Fjala laicizëm (lat. Laikos apo Laicus, fr. Laic apo Laïque) do të thotë: *ajo që i përket popullit, që rrjedh nga populli*. Për herë të parë fjala laicitet, në kontekstin e "ndarjes së shtetit nga feja dhe kisha" dhe "siguria e lirive fetare të qytetarëve" është përdorur në Francë, në kuadër të aktiviteteve civile, politike dhe parlamentare.

Laicizmi është një doktrinë apo ideologji që ka për qëllim të kufizojë fenë vetëm në sferën private dhe të lihet menjëherë në aferet publike. Por që në proces e sipër, kufizon jo vetëm rolin qendror të fesë në shoqëri, por në mënyrë të paevitueshme edhe ndërgjegjen fetare të njerëzve.

2. Laicizmi u shfaq në Europë si pasojë e *acarimit të hidhur midis shkencëtarëve perëndimorë dhe dominimit të fesë së asaj kohe dhe teorive të saja*, me të cilat po sundonte një kohë të gjatë. Mendimtarët shekullaristë të iluminizmit e sfiduan klerin, të justifikonin pretendimet e tyre për të vërtetën me anë të argumenteve racionale dhe jo thjesht me anë të përmendjes së autoritetit fetar.

Një shkak tjetër për shfaqjen e laicizmit ishte se *Euro-pa në mesjetë u përball me luftëra të përgjakshme fetare*. Kur autoriteti fetar digjte dhe vriste çdo kënd që nuk u nënshtrohej mësimave dhe predikimeve të tij, lindën reformatore evropiane, të cilët kërkuan marrjen e pushtetit nga dora e klerit. Kur në një numër vendesh, asnjë palë fetare nuk mund t'ia impononte të gjithë shoqërisë besimin e saj, uniteti i rendit shoqëror duhej bazuar mbi një themel të ndryshëm nga feja. Rrjedhimisht, në gjysmën e dytë të shekullit të shtatëmbëdhjetë, njerëzit e matur morën vendimin se për rivendosjen e paqes sociale, feja duhej vënë në kllapa. Mungesa e tolerancës ndërmjet sekteve, në periudhën pas-reformimit, ishte drejtpërdrejt përgjegjëse për lindjen e kulturës laike.

3. **Laiciteti në parim** plotëson pluralizmin demokra-

tik. Ai synon të afirmojë se në kufijtë e jetës civile nuk ka asnjë besim fetar apo ideologji politike që mund t'u imponohet të tjerëve si model nëpërmjet forcës, qoftë kjo verbale, fizike, psikologjike ose edhe me presion ekonomik.

Në laicizëm detyra e shtetit është vendosja e tolerancës, bashkëjetesës dhe miqësisë në mes besimeve fetare dhe jofetare. Laicizmi synon eliminimin e plotë të çfarëdo dhune. Laicizmi ndalon diskriminimin fetar, etnik dhe gjinor dhe diskriminimet mbizotëruese, në marrëdhëniet midis institucioneve të shoqërisë. Ai siguron barazinë ndaj ligjit, barazinë në arsim, në punësim dhe në shprehjen e bindjeve fetare, kombëtare, kulturore etj.

**Sa më e përhapur të jetë injoranca mbi Islamin, aq më i madh është paragjykimi ndaj myslimanëve.**

1. Kritikët myslimanë thonë se, edhe pse për botën evropiane laicizmi ka pasur efekte pozitive, pasi e shkëputi atë nga mesjeta dhe autoriteti absolut i klerit, që pengonte zhvillim social dhe shkencor, objektiva të tilla të laicizmit janë të huaja për Islamin. Islami nuk ka nevojë për to, pasi Islami obligon kërkimin e diturisë, motivon përhapjen e shkencave dhe vlerëson pozitën e dijetarit.

Mjeku francez, **Mauris Bacuille** (1920-1998), tregon se *në krahasim me librat e tjerë të shenjtë, vetëm Kurani nuk është në konflikt me njohuritë shkencore moderne*.

Kontradiktat midis Islamit dhe shkencës apo Islamit dhe logjikës, nuk kanë bazë dhe nuk shprehin një të vërtetë. Rrjedhojat dhe domethëniet duhet t'i kërkojmë në kontekstin evro-kristian. Sepse në kohën kur myslimanët praktikonin Islamin në jetën e tyre sociale dhe politike, udhëhoqën shkencat dhe sunduan qytetërimet shekuj me radhë. E kundërta e fenomenit evropian, në kohën kur u shkëputën nga kthetrat e fesë së tyre, u çliruan, u zhvilluan dhe morën jetë.

*Në mesjetë myslimanët ishin unikalë në shkencë, filozofi e art. Ata kishin përhapur artin e shkencën në çdo vend ku kishin arritur këmbët e tyre; prej tyre u përhapën nëpër*

Evropë dhe konsiderohen faktor i zhvillimit e përparimit të saj.

Sociologu francez, **Gustav le Bon** (1841-1931) thotë: "Sikur të mos dilnin arabët në skenën e historisë, zhvillimi i Evropës së re do të vonohej disa shekuj".

2. Islami nuk shpalo perde midis vlerave fetare dhe jetës së përditshme, pasi ai nuk i përket thjesht sferës shpirtërore të njeriut. Islami çliron njeriun dhe jep drejtësi për të gjithë dhe garanton liritë që kleri evropian i pengonte në mesjetë. Në Islam respektohen të drejtat e njeriut dhe predikohet barazia midis qenieve njerëzore; hidhet poshtë çdo formë e diskriminimit racial dhe bëhet thirrje për lirinë e të gjithëve.

Islami si një religjion me më ndikim sot në botë, për dallim nga religjionet e tjera, nuk ka kler me cilësinë e shenjtërisë, me sundim absolut, sikur të ishte hije e Zotit në tokë. Ai është një religjion ku shteti, jeta dhe struktura socio-ekonomike janë të pandashme, shoqëria islame nuk ia jep pushtetin klasës së klerikëve. Në islam udhëheqin dijetarët, mendimtarët, ulematë dhe rregullimi shoqëror është në konform me ligjet islame. E drejta islame nuk e kërkon në asnjë mënyrë teokracinë, në kuptimin e ngushtë të fjalës, gjegjësisht sundimin e klerikëve.

Islami si besim dhe civilizim, fe dhe kulturë, nuk mund të kuptohet pa të kuptuarit e jurisprudencës islame. Muhamedi (a.s.), ka kumtuar, në të njëjtën kohë, fe dhe shtet. Islami nuk është fe materialiste, mbi të cilën mund të aplikohen normat materialiste e as besim shpirtëror që ska lidhje me materializmin dhe jetën. Islami është besim që përqendrohet në materie dhe shpirt, në këtë botë dhe në ahiret; është trup dhe shpirt, shtet dhe fe.

Sistemi politik Islam dallohet nga sistemet e tjera njerëzore me parimet e mëposhtme: barazia, konsulenca, drejtësia dhe liria. Islami ofron vizionin e një jete civilizuese, të një jete shoqërore të ligjit, rendit, drejtësisë dhe autoritetit. Ai rregullon marrëdhëniet njeri-njeri, njeri-shoqëri, njeri-natyre dhe njeri-Krijues.

Sistemi ekonomik islam mbështetet në parime etike, nuk dëmton individin në interes të shtetit e as shoqërinë në interes të individit. Studiuesi francez, **Prof. Raymond Charlie** konfirmon se: *Islami ofron një rrugë të posaçme për përparimin e prodhimit. Islami lavdëron punën dhe i ndalon të gjitha format e manipulimit, ai -Islami- shfrytëzon dy rregulla për avancimin e punës: "Secilit i takon ajo që meriton" dhe "Secilit i takon aq sa punon".*

3. Laicizmi filozofik, i bazuar në racionalizëm të plotë, është mohues i fesë, i botës tjetër dhe i çdo ndjenje shpirtërore që buron nga feja. Ne, si ithtarë të Islamit, nuk mund ta pranojmë një laicizëm të tillë filozofik, sepse ai nënkupton përjashtimin e vetëdijshëm të fesë

nga jeta e përditshme e njeriut. Ky lloj laicizmi, po zë vendin e fesë dhe është një rival i pashpirt i saj. Islami nuk pajtohet me aplikimin e makiavelizmit, materializmit, nacionalizmit e shumë "izma" të tjerë që ushqejnë filozofinë laike.

Pjellë e laicizmit filozofik është edhe teoria e darvinizmit. Teori, e cila shprehet në gjuhën e laikut: "Evolucioni nuk është vërtetuar, por ne besojmë në këtë teori, ngase në të kundërtën, e vetmja alternativë për ne do të jetë besimi në krijimin hyjnor e as nuk mund të mendohet rreth kësaj çështjeje".

Islami refuzon laicizmin, i cili ndan hermetikisht botën e shpirtit nga bota e materies, si dhe formon rregulla dhe parime të marrëdhënieve shoqërore pa vlera shpirtërore. Kriza shpirtërore e qytetërimit perëndimor është pasojë e aplikimit të laicizmit, largimit nga vlerat metafizike. Humbja e vlerave, dyshimi mbi të vërtetën, mjerimi mbi shpresën, streset dhe depresionet, kaosi moral, shpërbërja e familjes e shumë dukuri të tjera shoqërore, janë publikuar dhe vërtetuar në jetën laike. Prezantimi i mësimëve tradicionale islame me gjuhën moderne, do të ishte kontribut i vyer në ballafaqimin e sfidave të modernizmit.

Diplomati austriak, **Leopold Weiss** (Muhammad Asad: 1900-1992) thotë: "Islami nuk është besim sufist e as filozofi, por është metodë e jetës sipas rregullave të natyrës që i ka nënshtruar Zoti për krijesat e Tij. Karakteristika e tij është harmonizimi i aspektit shpirtëror me aspektin material në jetën njerëzore".

Islami ndikon në shpirtitrat, ashtu siç e gjallëron jetën pranvera, ndryshon pozitivisht besimet, drejtimit dhe qëndrimet ndaj gjithësisë, natyrës dhe jetës. Ndryshon sjelljet kah e mira, e vërteta dhe e bukura. Bart brezat nga errësira në dritë, nga amoraliteti në jetën e disiplinës dhe i shndërron në mësues të botës, udhëheqës të rruzullit tokësor dhe zotërinj të ekzistencës.

4. Aktualisht roli i fesë islame në kuadrin e sistemit laik, është mjaft pozitiv. Pozitiviteti i saj rrit përmasat, sidomos atëherë kur ushqen tolerancë dhe vlera njerëzore. Në qoftë se legjislativi laik do të pyeste veten se cili është besimi më i mirë që ekziston, ai do të përgjigjej se besimi më i mirë është ai që ndihmon të formojë qytetarë të dobishëm për shoqërinë, të drejtë, tolerantë dhe të pajisur me virtyte të larta. **Dhe ky besim është padyshim Islami!**

Ju faleminderit !

Referat i mbajtur në seminarin me temë:  
"Islami sistem gjithpërfshirës"  
Shkodër, më, 05.12.2011.

# Të kamurit e kohës së KURANIT

*Prof. dr. Ibrahim Sarmësh*

**K**urani i përgatit njerëzit për Dynjanë dhe Ahiretin, duke i edukuar ata me dije dhe udhëzim. Pa u dhënë mundësinë e të zgjedhurit mes Dynjasë dhe Ahiretit, u mëson të thonë: **“Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit (të Xhehenemit)”** (Bekare, 201.)

Sipas botëkuptimit islam, Ahireti është vendi që duhet të ketë më shumë përparësi për një mysliman, për arsye se është vendi më i përsosur dhe më i qëndrueshëm.

Njerëzit që e kuptojnë drejt qasjen islame ndaj Dynjasë dhe Ahiretit, e dinë se kalimi i mbarë i Kësaj Bote dhe fitimi i Botës Tjetër, realizohet përmes veprës që bëhet në Dynja. Të gjitha mundësitë fitohen duke punuar shumë në këtë botë dhe duke vepruar sipas Islamit. Nuk bëhet fjalë të jenë lart ata që nuk kanë qenë lart në këtë botë. **“Ai, që në këtë botë ka qenë i verbër, do të jetë i verbër edhe në botën tjetër dhe më i humbur nga rruga e drejtë.”** (Isra, 72.)

Sikurse u mësoi njerëzve që më të lartit janë besimtarët e vërtetë, Islami i mësoi po ashtu, të jenë të fuqishëm edhe materialisht. Ashtu siç nuk aprovon jetesën e besimtarëve si jobesimtarë, po ashtu nuk aprovon jetesën e tyre si të varfër dhe të skamur. Përkundrazi, duke thënë: **“Në të vërtetë, fuqia është e Allahut, e të Dërguarit të Tij dhe e besimtarëve.”** (Munafikun, 8.), u mëson të jetojnë të nderuar me besimin e tyre në jetën shoqërore. Nëse besimtari punon shumë, me qëllim për

të jetuar mirë në këtë botë, kjo gjë nuk ka lidhje me të qenët i dhënë pas materies. Muhamed Gazali shprehet kështu, lidhur me këtë pikë:

“E di edhe unë, ashtu sikurse edhe të tjerët, se si u shkatërruan paraardhësit dhe pasardhësit e atyre që e deshën këtë botë, aq sa u bënë materialistë. E dimë se edhe pas çdo lloj faji që bëhet si pasojë e neglizhencës, ka një lloj idhujtarie të tillë. Këto faje, para se t’i bënte masa e gjerë, i kanë bërë intelektualët. Fillimisht i kanë bërë liderët, pastaj ithtarët e tyre. Para se ato faje t’i bënin të çmendurit, i kanë bërë të mençurit. Por shërimi i saktë i kësaj sëmundjeje bëhet duke zotëruar botën dhe duke përbuzur gjërat e pavlefshme të saj.

Bëj më shumë pasuri nga ç’kishte Karuni. Arrij më shumë pushtet nga ç’kishte Sulejmani. Mbaji nën kontroll këto, që, kur të ketë nevojë e vërteta, ta mbështesësh me to dhe, kur të të vijë vdekja, në çastet e sakrificës, t’i dorëzosh të gjitha për hir të Zotit.

Të jetosh në mënyrë të skamur, duke menduar se varfëria është rruga që të shpie në Xhenet, nuk është asgjë tjetër përveç marrëzisë.

Ndërkohë që i ligu, me mundësitë që ka, vazhdon pushtetin, kurse ti heq dorë nga mundësitë materiale që të kesh pushtet në tokë, ta dish që është gjynah më i rëndë edhe se prostitucioni dhe kamata.” (M. Gazali, es-Sunnetun-nebevijje, (përkth. turq.), fq. 114.)

Gazali ka shumë të drejtë, nëse duam ta kuptojmë siç duhet Islamit dhe realitetin. Nuk duhet harruar se Xheneti nuk është banesa e përtacëve, e të paaftëve, e atyre që kanë vënë pushtet duke ushtruar dhunë. Nuk është vendi i servilëve, i atyre që nuk kanë turp të jetojnë të varur nga ndihma dhe lëmosha e tjetrit. Nuk është vendi i atyre që shpërfillin madhësinë dhe nderin, lirinë dhe pavarësinë e Islamit. Nuk është vendi i atyre që neglizhojnë robërinë vetëm ndaj Allahut. Nuk është vendi për ata që kanë zgjedhur skamjen si praktikë të jetës. E as që mund të jetë vendi i atyre që nuk e kanë rrisht shpalljen hyjnore, etikën, virtytin, nderin, madhësinë, lirinë dhe pavarësinë. Nuk është vendi i atyre që jetojnë të kënaqur me atë çfarë ofron kundërshtari dhe të varur nga lëmoshat e rivalëve. E as që mund të jetë vendi i atyre që Islamit, etikën, virtytin dhe vlerat e tjera i formësojnë sipas kundërshtarit. Nuk ka sesi të jetë vendi i atyre që e hapin zemrën e mendjen ndaj arrogantëve dhe që presin lëmosha prej tyre. Shkurtimisht, Xheneti nuk është vendi i atyre që kërkojnë nderin dhe krenarinë nga dikush tjetër, përveç Allahut dhe që e mendojnë këtë si pjesë të përcaktimit të Zotit.

Nuk duhet të harrojmë se nderimi dhe poshtërimi janë në një ekuilibër në të dy botët. Ata që janë lart këtej edhe andej do të jenë lart. Ata që janë poshtë këtej edhe andej do të jenë poshtë. **“Ai, që në këtë botë ka qenë i verbër, do të jetë i verbër edhe në botën tjetër dhe më i humbur nga rruga e drejtë.”** (Isra, 72.) Lumturia dhe fatkeqësia në Ahiret, të qenët prej banorëve të Xhenetit apo prej atyre të Xhehenemit, kalon përmes mbrojtjes së vlerave që bëhet në këtë Botë dhe mënyrës së jetesës që keni zgjedhur. Thënë ndryshe, në Xhenet kalohet përmes asaj që të faturohet dhe mundit që ke shpenzuar.

Muslimanët, për të ruajtur ekzistencën e tyre, për t'u zgjeruar, forcuar dhe për të rivalizuar armiqtë, duhet të jenë të fortë, duke bërë investimet e duhura në fushat e duhura. Si rrathët e zinxhirit, edukimi, arsimit, shëndeti, transporti, komunikimi, bujqësia dhe industria, janë fushat ku duhet investuar me të gjitha format. Përndryshe, populli mysliman nuk mund të shpëtojë pa u bërë nevojtar dhe i varur nga popujt e tjerë. Ashtu sikurse sot popujt myslimanë, me një popullsi prej mbi një miliardë, janë të varur dhe të ndikuar nga trysnitë e popujve të tjerë në këto fusha. Ekonomia e tyre është e detyruar të varet nga kreditë me interes. Për të mbrojtur veten, kanë nevojën e armëve të tyre. Për të rregulluar popullin e tyre, kanë nevojë për sistemet e tyre qeverisëse dhe drejtësitë. Për të rregulluar anët e tjera të jetës, kanë nevojë për direktivat, produktet dhe mbështetjet e tyre. Në shkëmbim të arritjes së këtyre, e kemi vënë re të gjithë se si gjuhëzohen dhe varen nga dëshirat dhe kërkesat e popujve të tjerë edhe në çështjet më jetike, siç janë besimi, tradita, edukimi, arsimit dhe mbrojtja e popullit.

Natyrisht, investimi bëhet me para. Për të pasur para duhet të punosh dhe të fitosh. Ai që është bërë i pasur duke punuar dhe fituar, për të qëndruar në këmbë i duhet ta mbrojë e ta shtojë pasurinë, duke bërë kujdes edhe rivalitetin. Kjo gjë arrihet duke ndarë më shumë kohë dhe mund.

Dëshira për materien dhe për mirëqenien dhe trysnia e jetës sociale dhe e kushteve të tregut, të bëjnë që të punosh për t'u bërë i pasur. Allahu i Madhëruar, duke e bërë të ditur se brenda njeriut ekziston një dëshirë për këto gjëra, thotë: **“Burrave u është hijeshuar dashuria për gjërat e dëshiruara: për gratë, fëmijët, arin dhe argjendin e grumbulluar, kuajt e bukur, bagëtitë dhe arat e lëruara. Këto janë kënaqësitë e kësaj jete, por shumë më i mirë është kthimi tek Allahu.”** (Ali Imran, 14.) Krahas grave, fëmijëve dhe parave, mund të vendosim transportin, komunikimin dhe gjithçka tjetër.

Ata që janë të pasur, për arsye të kujdesit që kanë për të ruajtur apo për të shumëzuar pasurinë e tyre, e kanë në një dizekuilibër kohën që ndajnë për këto, me atë që ndajnë për Kuranin, për ta lexuar e jetuar atë. Madje, gjithnjë është në shuarje të plotë kjo kohë. Sepse tamahu për të mbrojtur dhe shtuar pasurinë, vazhdon të vjedhë nga koha për të zbatuar parimet islame. Kështu, nevoja për të mbrojtur pasurinë dhe tamahu për ta shtuar atë, në një farë mënyre i bën rob ose i bën të punojë si robërit e saj. Besimtarët që punojnë, fitojnë, bëhen të pasur dhe shtojnë pasurinë për t'i shërbyer rrugës së Allahut. Kur themi se duhet punuar shumë për të fituar këtë botë dhe tjetrën, nuk duhet të harrojmë realitetin e qëndrueshmërisë në këmbë në këtë bazament të rrëshqitshëm dhe të baltosur.

Për të evituar këtë, krahas përpjekjeve të punës dhe zgjerimit të myslimanëve të pasur, duhet të kenë përpjekje/programe ditore për të kuptuar Kuranin. Qoftë si grup nën udhëheqjen e ndonjërit, qoftë edhe në mënyrë individuale. Nëse kuptojnë



gjuhën origjinale, le ta lexojnë nga gjuha origjinale, nëse jo, le ta lexojnë në gjuhën që ata kuptojnë, por medeo- mos duhet ta lexojnë, duhet të rregullojnë botëkuptimin dhe mënyrën e jetesës sipas tij.

Është mjaft e rrallë dhe e vështirë ta kuptojnë nevojën e një praktike të tillë vetë të pasurit - kjo vlen edhe për kategoritë e tjera. Përgjegjësia kryesore për t'i korrigjuar ata, për t'i kapur për dore dhe për t'i drejtuar nga e drejta, është në dorën atyre të diturve që njohin Islamin. Njerëzit që lexojnë Kuranin, për ta kuptuar dhe për ta shpjeguar, ashtu siç janë të obliguar të interesohen për të tjerët dhe të bëhen udhëheqës të tyre, duhet të interesohen edhe për të pasurit, t'i takojnë ata me Kuranin dhe t'i ndihmojnë në programimin e ditës. Kështu krijohen të kamurit e kohës së Kuranit dhe vetëm kështu ngrihet në këmbë dhe fuqizohet populli mysliman. Islami nuk bie në kundërshtim me të qenët i pasur apo të qenët fetar, me të qenit i kamur. Ashtu siç duhet ta bëjnë këtë udhëheqje të diturit për të pasurit, po ashtu edhe të pasurit duhet të gjejnë njerëz që mund t'u shërbejnë dhe që mund t'i udhëheqin ata në këtë pikë. Kjo detyrë bie në mënyrë të barabartë mbi secilën palë.

Kjo është rruga e vetme e të pasurve për të ruajtur veten. Përndryshe do të largoheshin apo shkëputeshin nga feja, duke u rrëmbyer nga vorbulla e të mbrojturit dhe zgjeruarit të pasurisë. Një gjë e tillë është e detyruar të bëhet nga çdo mysliman, por veçanërisht myslimanët e kamur e kanë më të obliguar. Sepse rrallëherë mund të ndodhë të dalësh nga feja për arsye të skamjes. Kurse dalja nga feja për arsye të pasurisë është më e mundshme. Madje Kurani, nuk jep shembuj të atyre që dalin nga feja për arsye të varfërisë, por shembuj, sikurse ai i Karunit, që dalin nga feja për arsye të pasurisë, ka dhënë shumë. Kurani jep rastet se si të pasurit arrogantë ishin të parët që u kundërviheshin pejgamberëve, i mohonin ato çfarë thoshnin ata dhe ishin po ata që bëheshin shkak që ai popull të shkatërrohej nga dënimi i Zotit.

**“Në çdo vendbanim që Ne kemi nisur ndonjë të dërguar, ata që bënë jetë luksoze thoshnin: “Me të vërtetë, ne nuk besojmë në mesazhin që keni sjellë!” (Sebe', 34.)**



**Po ashtu, në çdo vend që Ne kemi dërguar para- lajmërues para teje, pasanikët e atij vendi thoshnin: “Ne i kemi gjetur etërit tanë në këtë fe dhe po ndjekim gjurmët e tyre”. (Çdo i dërguar) thoshte: “Po sikur unë t’ju kem sjellë (një fe) më të ndriçuar se ajo e të parëve tuaj?!” Ata thoshnin: “Ne e mohojmë mesazhin me të cilën jeni dërguar!” Atëherë, Ne hakmerreshim kundër atyre, prandaj shiko si ka qenë përfundimi i femohuesve. (Zuhruf, 23 - 25.)**

Kështu ka ndodhur dikur, por edhe në kohën e Profetit Muhamed (a.s.). Kurani e shpjegon në këtë mënyrë kundërvënien e njerit prej të pasurve arrogantë ndaj ftesës së Muhamedit (a.s.):

**“Më ler Vetëm (të merrem) me atë që e krijova dhe i dhashë pasuri të pamatë e djem pranë vetes! Unë ia bëra kamjen të lehtë e të shtruar, e, megjithatë, ai lakmon që t’i jap më tepër. Jo, kurrsesi! Vërtet, ai i mohoi me kryeneçësi shpalljet Tona, prandaj Unë do**

**ta ngarkoj atë me dëni- me të rënda. Ai mendoi dhe kurdisi (kundër Kuranit), - dhe qoftë mallkuar, si kurdisi! Dhe sërish qoftë mallkuar, si kurdisi! Pastaj vështroi rreth vetes, mblodhi vetullat e u vrenjt, pastaj u kthye i kapardisur dhe tha: “Ky (Kuran) nuk është gjë tjetër, veçse magji e trashëguar! Këto janë vetëm fjalë të një vdekatarit!” Do ta hedh**

**në Sekar (Xhehenem)! E si mund ta dish ti tamam se çfarë është Sekari (zjarri përvëlues)? Ai nuk lë gjë dhe nuk kursen asgjë, lëkurat i shkruan.” (Mudethir, 11-29.)**

Ndërkohë që Kurani nuk përmend ndonjë rast që të jetë shkatërruar ndonjë qytet, si pasojë e kundërvënies ndaj pejgamberëve e as nuk bën fjalë për ata që kanë dalë nga rruga e fesë për arsye të skamjes së tyre, por jep shembuj se si janë shkatërruar qytetet, si pasojë e kundërvënies së të pasurve arrogantë ndaj pejgamberëve:

**“Kur vendosim ta shkatërrojmë një qytet, Ne i urdhërojmë (për mirë) të pasurit e tij dhe, kur ata bëjnë mbropshti në të, atëherë përmbushet Vendimi (i dënimit) kundër tyre dhe Ne i shkatërrojmë gjer në themel.” (Isra, 16.)**



# Nëse puna s'i jepet ekspertit

Prof. dr. Ismail Lytfa Çakan

**T**ransmetohet sipas Ebu Hurejres, *radijallahu anhu*, se i Dërguari i Allahut, *salallahu alejhi ue selem*, ka thënë: "...Prit Kijametin në kohën kur puna t'i dorëzohet të paaftit."<sup>1</sup>

## SHKAKU I TRANSMETIMIT

Në një mbledhje, ndërkohë që i Dërguari i Allahut, *salallahu alejhi ue selem*, po u tregonte diçka sahabëve që ishin rreth tij, erdhi një beduin dhe e pyeti:

- Kur do të ndodhë Kiameti?

I Dërguari i Allahut, *salallahu alejhi ue selem*, nuk e ndërpreu fjalën dhe vazhdoi ligjëratën. "E dëgjoi nomadin, por nuk i pëlqeu pyetja." Dhe dikush tha: "Ndoshta nuk e ka dëgjuar." Pikërisht në atë kohë, i Dërguari i Allahut, *salallahu alejhi ue selem*, mbaroi fjalën dhe tha:

- Ku është ai që pyeti për Kijametin?

Beduini tha:

- Unë, O i Dërguari i Allahut, jam këtu! I Dërguari i Allahut, *salallahu alejhi ue selem*, iu përgjigj:

- Në kohën kur të humbasë amaneti (mirëbesimi), prit Kijametin!

- Nomadi tha:

- Si mund të humbasin amanetet?

I Dërguari i Allahut, *salallahu alejhi ue selem*, iu përgjigj:

- Kur puna t'i dorëzohet të paaftit, prit Kijametin!<sup>2</sup>

1. Buhari, Ilim 2.

2. Shiko Buhari, Ilim 2.

Mosdorëzimi i punës te eksperti i saj, vjen si pasojë e përhapjes së injorancës dhe e largimit të dijes nga mesi i njerëzve. Aty ku ka njerëz që e njohin thelbin e punës, nuk mund të mendohet që kjo punë t'u dorëzohej të paaftëve. Por, nëse injoranca është përhapur gjithandej, punët mbeten në dorën e atij që nuk është i aftë t'i kryejë.

## PROVA TË RËNDËSISHME

Në hadithin fisnik, na tërheqin vëmendjen tri pika dhe vendime të rëndësishme: mosdorëzimi i punëve te ata që nuk janë ekspertë, humbja e amanetit dhe koha e ndodhisë së Kijametit. Përveç kësaj, del në krye sjellja e Profetit, *salallahu alejhi ue selem*, që tregon se në ç'formë duhet të jenë marrëdhëniet mësues-nxënës dhe atij që jep fetva me atë që kërkon fetva. Por ne do të qëndrojmë në disa çështje të tjera, duke u mjaftuar me përmendjen e rëndësisë së kësaj sjelljeje.

Fjala *el-emr* që kalon në hadith, do të thotë çdo lloj pune që ka lidhje me fenë. Është një vendim që përfshin angazhimin te dikush si "punë" ose çdo gjë që nxirret në pah. Ajo përfshin të gjitha punët, që nga administrata shtetërore, deri te punët komunale, të cilat kërkojnë çdo lloj energjie, aftësie dhe kompetence. Prandaj, *el-emr*, siç e ka përkrahur edhe komentuesi Ajni, përfshin edhe *fetvatë*, krahas kalifatit dhe kadillëkut.

Nga aspekti gjithëpërfshirës, *fetva-ja* është një çështje konsulence shumë e rëndësishme që kërkon dinamizëm, pjekuri dhe përgjegjësi të madhe, të cilat sigurojnë një mbizotërim fetar në jetën e përditshme, madje një qëndrim në kuadër të parimeve fetare për çdo ecuri të ngjarjeve. Një hadith tjetër i nderuar na tërheq vëmend-

jen në këtë drejtim, duke thënë: *"Allahu i Lartësuar nuk ua heq dijen njerëzve, pasi t'ua ketë dhënë. Por, Ai merr nga mesi tyre dijetarët bashkë me dijen e tyre, dhe injorantët, njerëzit e paditur mbeten pas. Populli i qan hallet tek këta, ndërsa ata i përgjigjen sipas mendimit të tyre. Kështu që edhe popullin edhe veten e tyre e çojnë në humbje."*<sup>3</sup>

Kjo situatë, pa dyshim sjell përfundime të rrezikshme në strukturën e shoqërisë. Ose e çon shoqërinë në një anarki që ngjan me kijametin. Shkaku kryesor i këtij përfundimi fatal, është iniciativa që ndërmarrin njerëzit e paaftë dhe të pakualifikuar me dëshira dhe ambiciet veti, për të udhëhequr popullin në emër të fesë. Në fakt, vështrimet që bazohen në parimet fetare, si Kuran, sunet dhe ixhma' (mendimet unanime të dijetarëve), janë opinione dhe këndvështrime të lavdëruara dhe të mirëpritura.

Në mënyrë absolute, nuk është këndvështrimi dhe analogjia që nënçmohet, por nënçmohen këndvështrimet personale që janë larg nga mendimet që lidhen me argumentet bazë të fesë dhe që nuk përmbajnë një shqetësim të tillë. Kjo është më se e natyrshme. Sepse çdo sistem dhe çdo fe ka një parim të përgjithshëm dhe baza që ajo i çmon shumë. Mund të rrih në një ambient të tillë, përderisa në atë vend zbatohen këto parime. Përndryshe, nuk mund të flitet për një jetesë dhe ecuri në përputhje me parimet fetare, por për një shpërbërje dhe zhdukje totale.

Sipas parimeve që kemi mësuar nga hadithi i lartpërmendur, t'ia dorëzosh punën një të paafti, tregon qartë për humbjen e mirëbesimit. Kështu që, zhdukja e dijetarëve ka një lidhje të ngushtë me humbjen e amaneteve. Ndërsa mirëbesimi, është emri i përgjithshëm që u vendoset të gjitha vlerave shpirtërore-materiale dhe përgjegjësi. Kjo do të thotë se amaneti është mirëbesimi për shkak të diturisë. Nëse nuk ka mbetur më dije, do të thotë se ka humbur edhe mirëbesimi. Kurse treguesi i kësaj është se, ata që janë të paaftë kanë marrë përsipër punët e umetit.

### SHKAKU KRYESOR

Dorëzimi i punës te ai që është i paaftë ta kryejë, vjen si pasojë e përhapjes së injorancës dhe largimit të dijes nga mesi i njerëzve. Normalisht, nuk mund të mendohet se kjo punë do t'u dorëzohej të paaftëve, në një mjedis ku ka nga ata që njohin thelbin e punës. Por, nëse injoranca është përhapur gjithandej dhe punët janë kthyer së prapthi, punët mbeten tek ai i cili i rrëmben ato; pra, mbeten në dorën e atij që nuk është i aftë t'i

3. Buhari, l'tisam 7, Muslim, Ilim 14, Ahmed b. Hanbel II, 203. Përveç kësaj, për shprehje të ndryshme nga ky hadith shiko Buhari, Ilim 34; Muslim, Ilim 13; Tirmidhi, Ilim 5; Ibn Maxhe, Mukaddime 8; Darimi, Mukaddime 26.

kryejë. Në një farë mënyre, kjo do të thotë Kiameti i popujve. Po ta mendonim këtë situatë për Islamin, i cili është një fe hyjnore universale dhe për myslimanët, të cilët janë ithtarët e saj, do të shfaqej një katastrofë e lahtarshme. Siç dihet dituri, do të thotë zgjidhje. Pajtjetër që do të ketë një lehtësi në punë, përderisa dija të qëndrojë në këmbë dhe të përparojë. Shkaku kryesor i pazgjidhshmërisë dhe i shkatërrimit, është padituria, po të lëmë në njërin anë faktorët e jashtëm.

Në këtë çështje do të ishte me vend të përmendim ajetin: *"Mos iu qas asaj, për të cilën nuk ke njohuri..."*<sup>4</sup> ose *"... dhe për atë që nuk kishin kurrfarë dijeje, flisnit duke menduar se ajo ishte imtësi e parëndësishme..."*<sup>5</sup> Sepse një kuptim i këtyre ajeteve është: *"Mos jep opinionin dhe mendimin tënd pa kurrfarë dijeje!"*

Imam Shafi'u kundërshtoi ata që i kushtojnë rëndësi analogjisë ndaj revelatës (lajmit) me ajetin: **"Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtroni atë te Allahu (te Libri i Tij) dhe te i Dërguari, në qoftë se i besoni Allahut dhe ditës së fundit."**<sup>6</sup> dhe mbron

*Allahu i Lartësuar nuk ua heq dijen njerëzve, pasi t'ua ketë dhënë. Por, Ai merr nga mesi tyre dijetarët bashkë me dijen e tyre, dhe injorantët, njerëzit e paditur mbeten pas. Populli i qan hallet tek këta, ndërsa ata i përgjigjen sipas mendimit të tyre. Kështu që edhe popullin edhe veten e tyre e çojnë në humbje*

mendimin se ai ka këtë kuptim: *"Në raste mosmarrëveshesh kërkoni se çfarë ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe pasojini!"*

Bejhakui transmeton se Ibn Mes'udi, radijallahu anhu, ka thënë: *"Nuk bëhet fjalë se asnjë vit që vjen pas një viti tjetër nuk është më i keq se viti pasardhës. Me këtë nuk dua të them se viti i mëparshëm është më i begatë se viti që vjen pas tij ose udhëheqësi i mëparshëm është më i mirë se ai pasardhësi i tij. Unë po bëj fjalë për asgjësimin e dijetarëve. Saqë puna, më në fund, do t'u mbetet njerëzve, të cilët u paraqesin njerëzve vëzhgimet e tyre personale në çdo çështje dhe si rrjedhojë, Islami do të shkatërrohet."*<sup>7</sup>

4. el-Isra (17/37).

5. En-Nur (24/15).

6. en-Nisa(4/59).

7. Ibn Haxher, Fethu'l-Bari, XIII, 296.

Duhet të theksojmë menjëherë se, *largimi i dijes është zhdukja e dijetarëve*. Kjo situatë përcaktohet qartë në disa transmetime të tjera të hadithit, në të cilat thuhet: *“Asgjësimi i dijetarëve është largimi i dijes.”* Humbja e dijes, *raf’u’l-ilm-largimi i dijes*, paraqitet gjithnjë me dhehabu’l-ulema - largimin e dijetarëve.

Nga ana tjetër, sipar asaj që mësuam nga hadithi i lartpërmendur, në të cilën thuhet: *“Punët do t’u lihen në dorë të paaftëve”*, është një tregues i qartë për humbjen e mirëbesimit. Pra, ka një lidhje të ngushtë zhdukja e dijetarëve me humbjen e amaneteve. Ndërsa mirëbesimi, është emri i përgjithshëm që u vendoset të gjitha vlerave shpirtërore-materiale dhe përgjegjësi. Kjo do të thotë se amaneti është mirëbesimi për shkak të diturisë. Nëse nuk ka mbetur më dije, do të thotë se ka humbur edhe mirëbesimi. Treguesi i kësaj është se, ata që janë të paaftë, kanë marrë përsipër punët e umetit.

Ngritja e njerëzve të aftë, është xhihadi-përpjekja më e madhe në ditët tona dhe përbën kuptimin më të madh e të rëndësishëm për myslimanët.



## DIJETARI-INJORANTI

Nga shprehja e hadithit kuptohet se zhdukja e dijetarëve në përgjithësi, nuk do të thotë zhdukja e njerëzve me dije. Por do të thotë zhdukja e dijetarëve që dinë burimet kryesore të fesë, d.m.th. zhdukja e atyre që dinë Kuranin dhe Sunetin, të cilët në fillim u japin zgjidhje problemeve nga këto parime. Ndërsa të paditurit ose injorantët, nuk janë ata që nuk dinë asgjë, por janë ata që nuk dinë mënyrën dhe argumentet fetare për t’u dhënë një zgjidhje fetare problemeve; për këtë shkak japin gjykime sipas kokës së tyre, japin fetva sipas pikëpamjeve të tyre, pa ndierë nevojën për t’u përshtatur me ndonjë parametër shkencor. Shkurtimisht, janë ata të cilët e vendosin veten e tyre, me kuptimin e plotë të fjalës, në vend të Gjykuesit-Shari’ dhe që nuk njohin kufi.

Është e ndaluar të nxjerrësh përpara injorantë të tillë,

për shkak të dëmeve që do të shkaktojnë nëse u referohesh atyre. Madje, dijetari mëkatar vlerësohet në këtë pikë nga njerëzit e thjeshtë dhe injorantët, të cilët nuk e kalojnë kufirin dhe e preferojnë atë. Sepse ndershmëria dhe devocioni e pengojnë njeriun të flasë nga padituria dhe e shtynë atë të kontrollojë veten. Ndërsa mëkati, është shenjë dhe rezultat i kokfortësisë.

## GJITHNJË E NJËJTA ANKESË

**Nga ana tjetër, vihet re shpesh se shumica e dijetarëve shikojnë periudhat e tyre dhe deklarojnë e ankohen se koha e humbjes dhe e shkatërrimit që përmendet në hadith, po bëhet realitet, përballë mbizotërimit mbi popullin injorant. Shembujt më të përafërt që kanë të bëjnë me këtë çështje, na i jep përkthyesi dhe komentuesi i *Texhrid-i Sarih Kamil Miras Allahu e mëshiroftë* dhe *Ahmed Davudoglu, Allahu e mëshiroftë, i cili ka përkthyer dhe komentuar Sahihun e Muslimit.***

**Kamil Miras thotë:** *“Mendoj se ka ardhur koha e daljes nga rruga e drejtë, e cila përmendet në hadith. Sot, artikujt që flasin rreth çështjeve fetare, të cilat kalojnë në vargjet e gazetave, janë në një anarki totale.”*<sup>8</sup>

**Ndërsa A. Davudoglu, pasi transmeton fjalët e Kadi Ijaz-it dhe ankesat e Shejh Kutbuddin-it në lidhje me kohën e tij dhe veçanërisht fjalët e Ajnit, i cili thotë:** *“Qytetet kanë mbetur të zbrazur prej dijetarëve, ndërsa injorantët kanë kaluar në krye të postit të fetvave dhe të arsimit, në sajë të emërimit. Më në fund, ne lutemi për paqe e shëndet.”* Thotë: *“Ejani të shihni kohën tonë. Tashmë këto janë kthyer në modë. Sot u thuhet njerëz fetarë, intelektualë, atyre që japin fetva sipas mendjes së tyre.”*<sup>9</sup>

**Ne e ndiejmë të nevojshme të mbështesim faktet e këtyre dy dijetarëve, duke shtuar injorancën që transmetohet nga televizioni dhe veçanërisht mendjelehtësinë në çështjet fetare. Vëmë re se populli, madje të gjitha shtresat e tij, kanë nostalgji për islam-in dhe duan ta mësojnë atë. Shohim se gjendemi në përpjekjet dhe zhvillimet serioze shkencore. Kjo është për t’u shpresuar, madje në një farë mase, për t’u gëzuar dhe për më tej, mendojmë se do të na mjaftonte të jepnim përpjekjet tona në aspektin e zhvillimit të kësaj tendence.**

Ja pra, edukimi dhe ngritja e njerëzve të aftë, është xhihadi-përpjekja më e madhe në ditët tona dhe përbën kuptimin më të madh e të rëndësishëm për myslimanët. Realizimi i kësaj deri në një farë mase, do të bëjë të mundur që ndodhia e Kiametit të shtyhet. Tani është koha e angazhimit me problemet e islamit dhe të myslimanëve. Pra, është koha t’ia japim punën atij që është i kualifikuar për këtë.

8. Shiko *Përkthimi i Texhridi Sarih*, XII, 408.

9. Shiko *Përkthimi dhe Komentimi i Sahihi Muslim-it*, X, 665.



# Të mboash në këmbë DREJTËSINË

*M. Sami Ramazanogllu*

**N**ë Kuranin Fisnik urdhërohet:

***“O besimtarë! Bëhuni zbatues të palëkundur të drejtësisë, duke dëshmuar në emër të Allahut, qoftë edhe kundër jush ose kundër prindërve dhe të afërmve tuaj. Qoftë i pasur ose i varfër ai (për të cilin dëshmoni), Allahu është për ata vlerësuesi më i drejtë. Dhe mos shkoni pas epsheve tuaja e të shtrembëroni drejtësinë! Nëse ju ngatërroi dëshminë ose i shmangeni asaj, vërtet që Allahu e di se çfarë bëni ju.”*** (en-Nisa, 135)

Fjala “*kauuam*” e përdorur në këtë ajet fisnik, do të thotë të qëndrosh me këmbëngulje në një vendim apo punë. Ndërsa fjala “*kist*”, do të thotë drejtësi. Siç edhe kuptohet, Allahu Teala, në këtë ajet fisnik i urdhëron robërit e Tij të jenë këmbëngulës në drejtësi, të ruhen nga padrejtësia dhe të mos mbajnë anën e askujt nëse u duhet të dëshmojnë për diçka. Pra të dëshmojnë vetëm të vërtetën, qoftë ajo (e vërteta) edhe kundër vetes ose kundër prindërve të tyre.

Ndërsa në një ajet tjetër urdhërohet:

***“O besimtarë! Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat e Allahut dhe bëhuni dëshmuar me drejtësi! Le të mos ju nxisë urretja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë dhe frikësujni Allahut!***

ër këtë arsye u shkatërruan popujt para jush. Nëse dikush prej fisnikëve apo njerëzve me pozitë bënte vjedhje, e lëshonin, por nëse vidhte dikush që ishte i dobët e panjeri, ata menjëherë e dënonin. Betohe në Allahun se nëse bija e Muhamedit, Fatma do të vidhte, patjetër që edhe asaj do t'ia prisja dorën



**Pa dyshim, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë që bëni**". (el-Maide, 8)

Në një hadith të nderuar thuhet:

*"Në ditën kur nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së Arshit, Allahu Teala do t'i marrë nën hijen e Arshit të Vet shtatë kategori njerëzish. I pari i prej tyre është imami (prijësi) i drejtë. Pra prijësi, i cili çdo punë e kryen me drejtësi."* (Buhari, Ezan, 36, Zekat 16, Rikak, 24, Hudud, 19; Muvatta, 14; Tirmidhi, Zuhd, 53.)

Aishja (r.anha.), tregon: Kur një nga gratë e fisit Beni Mahzum kreu një vjedhje, në bazë të shariatit (ligjit islam), duhej t'i pritej dora. Me qëllim që asaj të mos i pritej dora, filluan të kërkonin dikë që të ndërhynte tek Profeti. Por askush nuk guxoi t'i thoshte Profetit ndonjë gjë për këtë çështje përveç Usame bin Zejdit. Ndërsa Profeti i Allahut i thotë:

*"A po ndërmjetëson që të mos zbatohet një nga dënimet që ka vendosur Allahu?"* Pastaj u ngrit në këmbë dhe iu drejtua njerëzve:

*"Për këtë arsye u shkatërruan popujt para jush. Nëse dikush prej fisnikëve apo njerëzve me pozitë bënte vjedhje, e lëshonin, por nëse vidhte dikush që ishte i dobët e panjeri, ata menjëherë e dënonin. Betohe në Allahun se nëse bija e Muhamedit, Fatma do të vidhte, patjetër që edhe asaj do t'ia prisja dorën"*. (Buhari, Enbija 54, Megazi 53, Hudud 11, 12; Muslim, Hudud 8, 9)

Ebu Bekri (r.a.), në hytben e tij të parë tha:

- Tek unë, i dobëti i drejtë është i fortë derisa ta marrë prej të tjerëve atë që i takon. Ndërsa i forti i padrejtë, është i dobët derisa të tjerët të marrin prej tij atë që u takon. Nëse unë i bindem Allahut dhe Profetit të Tij, edhe ju mu bindni dhe më ndihmoni.

Nëse gabo, më tregoni rrugën e drejtë. Nëse unë nuk i bindem Allahut dhe Profetit të Tij, atëherë edhe ju nuk duhet të më bindeni.

Sipas një transmetimi të Enesit (r.a.), i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

*"Ndhmoje vëllain tënd qoftë kur bën padrejtësi, qoftë kur i bëhet padrejtësi"*.

Ata që ishin aty e pyetën: - O i Dërguar i Allahut! Mirë, e ndihmojmë kur i bëhet padrejtësi, por si ta ndihmojmë kur ai bën padrejtësi?!

I Dërguari i Allahut thotë:

*"Duke e penguar atë që të mos bëjë padrejtësi."* (Buhari, Mezalim, 4 / 5.)

Sipas një transmetimi të Shehl ibën Muadhrit, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

*"Kush e ruan një besimtar prej munafikut (hipokritit), në ditën e kiametit, Allahu dërgon një melek që ta ruajë trupin e tij nga zjarri i xhehenemit."* (EbuDaud)

Ibën Abbasi (r.a.), transmeton një hadith kudsij ku i Dërguari i Allahut (a.s.), thotë:

*"Allahu Teala thotë: Betohe në fuqinë dhe madhësinë Time se herët a vonë do të marr hakun e atyre që u është bërë padrejtësi. Do të marr hak edhe kundër atyre që shohin të bëhet padrejtësi por për shkak të zemrave të tyre të ngurta nuk ndihmojnë edhe me aq sa kanë mundësi"*. (Tirmidhi, Daauat, 115.)

Padyshim, se tirani i cili i bën padrejtësi të dobët që është nën mbrojtjen e Allahut, nuk do t'ia dijë se ai (i dobëti) ndodhet nën mbrojtjen e Allahut. Ky është një gjynah shumë i madh. Prandaj ai meriton dënimin në bazë të padrejtësisë që ka bërë.

# RAPORTI I QYTETIT ME TEMPULLIN

Edison Çeraj

T ë vjetrit thoshnin se ka vetëm dy substanca: shpirti dhe materia, duke nënkuptuar me to dy botë, dy rende gjërash që kanë origjinë dhe natyrë të ndryshme, që nuk rrjedhin nga njëri-tjetri dhe nuk reduktohen te njëri-tjetri. Edhe prijësit më të mëdhenj shpirtërorë e mendorë të kësaj bote nuk kanë pasur mundësi t'i shmangen këtij dallimi, edhe pse qasjet në këtë drejtim kanë qenë të ndryshme. Këto dy botë mund t'i mendojmë si të ndryshme në kohë, dy botë, "të njëpasnjëshme" (e tashmja dhe e ardhmja?), ose mund t'i kundrojmë si të ndryshme për nga natyra e kuptimi, por edhe si dy botë të njëkohshme - kjo është më afër thelbit.

Dualizmi, - që në këtë rast e kemi marrë si qasje/metodologji edhe në këtë ese - është ndjenja më intime njerëzore, por, nga ana tjetër, jo se është filozofia më e lartë njerëzore. Përkundrazi, të gjitha drejtimet e mëdha filozofike kanë qenë moniste, me prirje të pashmangshme të njëkahshme.

Njerëzit jetojnë, ndjejnë dhe e pranojnë botën në mënyrë dualiste. Por monizmi gjendet në natyrën e çdo filozofie dhe të çdo mendimi. Filozofia nuk e duron dualizmin. Megjithatë, ky fakt nuk është i një rëndësie të parëdoshme, sepse mendimi s'mund ta gjykojë jetën që është më e lartë se ai.

Në të vërtetë, duke qenë njerëz, ne gjendemi vetvetiu në dy realitete. Ato dy botë mund t'i mohojmë e të mos i pranojmë, por nuk mund të dalim prej tyre.<sup>1</sup>

Jeta nuk varet nga fakti se sa e kuptojmë. Prandaj, çështja se a do të jetojmë njëkohësisht dy jetë (gjë që nuk ka sesi të jetë ndryshe), është e tepërt të parashtrahet, madje në një farë shkalle është ofenduese; por, a do t'i jetojmë këto dy botë me vullnet dhe duke qenë thellë të vetëdijshëm për këtë gjë,<sup>2</sup> kjo po që duhet medoemos të shtrohet.

Njeriu përpiket t'u qaset këtyre botëve, këtyre dy mënyrave që nuk e lënë asnjëherë rehat, duke e sfiduar me kërkesat e tyre, në forma nga më të larmishmet, ku nëpër shumë syresh ai kalon pa një vetëdije të mirëpërcaktuar, mungesa e të cilës e degdis atë për të besuar dhe përjetuar nevojën (që i vjen nga kushtet e qytetërimit, pra së jashtmi) e kalimit nga njëra gjendje në tjetrën ose nga përvoja në përvojë, përmes një justifikimi mbizotërues/masiv se përvojat janë të nevojshme dhe çojnë drejt pjekurisë dhe njohjes (!), justifikim i cili ka marrë statusin e një ligji ndërkombëtar arbitrar. Askush nga ithtarët e kësaj sajese (besimi po të doni) nuk ndalet pak për të menduar se çfarë kuptimi ka përfundimi se "përvojat duhen në jetë". Për

çfarë duhen këto përvoja? Cili është caku i synuar me to? Po nëse ato na kthehen në qëllim më vete? A na shërbejnë ato ne apo ne atyre (duke ushqyer me "përvojat" tona një *modus vivendi* që na imponohet nga rrethana të caktuara që zakonisht lidhen me prirjen sasiore të qytetërimit)?

Këto e disa pyetje të tjera kërkojnë një qëndrim, gjithnjë në kuadër të asaj vetëdijeje që përmendëm më lart.

Duke pasur në vëmendje sa më sipër, merr shkas edhe kjo ese, e cila bazohet mbi atë se çfarë përfaqëson tempulli<sup>3</sup> (pika e nisjes, marrja shkas, pajisja) dhe qyteti (realizimi, manifestimi, terreni asnjans që pret të lirohet/farkëtohet), dhe natyrisht edhe me raportin ndërmjet tyre.

Pohimi i Plutarkut, se nuk ka pasur dhe as nuk do të ketë ndonjëherë *qytet pa tempull*, tregon se është pikërisht tempulli ai që e lind dhe që e mban qytetin. Nga ana tjetër, ka pasur dhe do të ketë qytete pa teatër, muze, letërsi apo pa këtë a atë institucion ose veprimtari të sojtit njerëzor, por, nuk do gjejmë kurrë një qytet pa një tempull të caktuar (xhami, kishë, sinagogë etj.) që përfaqëson këtë apo të besim.

Tempulli ka qenë dhe mbetet gjithmonë qendra, shpirti dhe zemra e çdo qyteti, qytetërimi, feje, kulture dhe i çdo veprimtarie tjetër jetësore, shpirtërore e mendore që ka pasur dhe do të ketë njerëzimi.

Është tempulli ai që e krijon komunitetin, që e bën njeriun të mendojë dhe të ndiejë se ai merr pjesë në fatet e përbashkëta njerëzore; ai që i jep njerëzimit vlera universale,<sup>4</sup> që përmes tyre të kuptojë dhe të ndërtojë marrëdhënie me vlerat e përkohshme lokale, të cilat ia imponon pashmangshëm qyteti.

Ndërsa qyteti rritej rreth tempullit fizikisht, ai rritej gjithashtu rreth dhe nëpërmjet tij në mendim, kulturë dhe qytetërim.

Qytetërimi dhe kultura krijohen nga një mënyrë e të jetuarit, e cila ka filluar në tempull, është ushqyer nga ai dhe mbahet prej tij. Ndonëse në historinë e gjatë të njerëzimit ka pasur dhe tempuj të deformuar apo që janë deformuar gjatë rrjedhës së kohës, përsëri tempulli mbetet shtylla kryesore e një qytetërimi. Edhe kur ka pasur persona të korrumpuar në të, përsëri ai ka qenë i nevojshëm. Historia ka treguar se dëmi pa tempull është shumë herë më i madh.

Nuk mund të ngrihet një qytet apo shtet pa pasur një fi-

1. Izetbegović, A. (2000) "Islami ndërmjet Lindjes e Perëndimit", f. 12-13. Përkth.: Eqrem Kryeziu. Shkup: Furkan

2. Po aty, f. 13.

3. Me "tempull" këtu kuptohet qendra shpirtërore, kulturore dhe idore e çdo qytetërimi, kulture e vendi në përgjithësi; ndërsa me "qytet", i gjithë organizimi shoqëror për të arritur, përmbushur dhe përjetuar vlerat e dala nga tempulli, kuptim i cili nuk vlen në rastin e disa qyteteve tipike moderne, ku me një shikim të parë përballesh me një kaos të organizuar/sistemuar ngrehinash pa emër.

4. Joani, mitropoliti i Korçës (2000).



lozofi të jetës, pa pasur një ide dhe ai nuk mund të mbahet pa atë. Sepse një shoqëri njerëzore, nuk ka rëndësi sesa e zhvilluar është (zhvillimi mund të matet nga parametra të ndryshëm në qytetërimi të ndryshme). Pra nuk mund të mbahet pa pasur disa vlera (vlerat mund të jenë të ndryshme në kultura të ndryshme, por ka pasur gjithmonë disa vlera bazike të përbashkëta) dhe vlerat, askush nuk mund ta mohojë, kanë dalë nga tempulli. Vetë shoqëria ka lindur dhe është organizuar rreth këtyre vlerave dhe sa më të forta janë ato, aq më e fortë është ajo.

Çdo qytetërim ka nevojë për vlera shpirtërore. Ashtu si njeriu, i cili nuk mund të jetojë vetëm për të përmbushur nevojat e tij fizike, sepse një ekzistencë e tillë do të ishte një ekzistencë e gjymtuar, ashtu edhe çdo qytetërim nuk mund të ekzistojë pa pasur vlerat shpirtërore dhe kulturore. Dëmtimi i tyre do të sjellë gjithmonë edhe dëmtimin e vetë shoqërisë. Për aq sa janë ruajtur vlerat, po aq është ruajtur edhe organizimi shoqëror.

Sa herë që kemi pasur degradime ose rënie të tyre, kemi pasur edhe degradime ose rënie të shoqërive apo shteteve të organizuar rreth atyre vlerave.

Në qytetërimet e lashta tempulli shikohej si qendra shpirtërore dhe fizike e gjithë universit, si pika ku bashkoheshin qielli, toka dhe diç nga bota e përtejme; si vendi ku fillon dhe mbaron krijimi dhe ku realizohet qëllimi përfundimtar i ekzistencës.

Në traditat e lashta të popujve të ndryshëm krijimi kishte filluar në qendër të universit, pikërisht në vendin ku ata kishin tempullin. Sipas një tradite, Parajsa ishte në qendër të tokës, Adami/Ademi ishte krijuar po në qendër. Tradita të tilla të ngjashme gjenden në të gjitha fetë, kulturat dhe qytetërimet e të gjithë botës. Tempulli përfaqësonte parimin e parë dhe të fundit të të gjithë veprimtarisë njerëzore për të përmbushur qëllimin e ekzistencës. Pikërisht, duke u nisur nga ideja se tempulli ishte ikona e botës, ai filloi të ndërtohej si model i gjithë universit. Është interesante të vihet re se fillimi i ndërtimit të qytetit fillonte gjithmonë me qendrën e tij, domethënë, me tempullin. Qytetërimet e lashta ishin të vetëdijshme për këtë dhe, sa herë që themelohej një qytet, përsëritej rituali i krijimit të universit.<sup>5</sup>

Ideja ishte se nuk mund të krijohet dhe të ndërtohet pa pasur një qëllim; pa pasur një parim, një motiv të qenësishëm që transcendon kohën dhe hapësirën. Dhe jo vetëm qytetërimet e lashta, por edhe qytetërimet e mëvonshme dhe disa prej qytetërimeve moderne janë ndërtuar duke u mbështetur në vlerat e krijuara në shekuj nga tempulli.

Ne nuk do të ndalemi për ta shpjeguar këtë në detaje, sepse nuk është ky qëllimi i shkrimit, por vetëm për të

theksuar se qysh në fillimin e çdo kulture, të çdo qytetërimi dhe të çdo shoqërie të organizuar, në qendër të tyre ishte tempulli.

Qyteti, në kuptimin më të thellë të fjalës, nuk përcaktohet nga sasia e banesave dhe nuk është thjesht një grumbullim banesash. Ai përcaktohet nga prania e tempullit, nga prania e një parimi drejtues shpirtëror, nga prania e një mendimi.

Dhe pikërisht në këtë kontekst, mund të kuptohet edhe shqetësimi i Heidegger-it, që thotë se "shkenca sot nuk mendon". Sepse, ajo që shkaktoi iluminizmi, - copëtimi i dijes në vetëm ndoca dije të ngurta racionale, dhe mbi të gjitha shkëputja e tyre nga burimi - Zbulesa, që përfaqësohet dhe kumtohet nga tempulli - duke vënë në epiqendër mendjen si të tillë, të vetme, e shkëputën atë nga damarët që e ushqenin (tempulli) dhe, si rrjedhojë, ajo është si e vdekur, pra nuk mendon.

Nuk mund të ketë qytet pa pasur një komunitet dhe nuk mund të ketë komunitet pa pasur një qëllim të mbështetur në një mendim të përbashkët.

Historia e gjatë e njerëzimit ka dëshmuar se qytetet e mëdha nuk kanë qenë domosdoshmërisht qytetet më të mëdha në banesa, por në mendim. Me mendim, në kuptimin e thellë të fjalës, siç e prekëm disa rreshta më lart, nuk shprehet vetëm aktiviteti racional, por e tërë fuqia mendore e shpirtërore e njeriut për të qenë i ndërgjegjshëm për qenien e tij dhe për të komunikuar me realitetin jashtë tij. Kështu, mendimi nuk është thjesht një përlllogaritje/arsyetim rreth një objekti të jashtëm, por ai mund të shkojë më tej, në realitetin ku ai gjendet i përfshirë dhe të cilin ai e përjeton.

Në këtë kuptim të thellë të fjalës, mendimi është tempulli i njeriut. Ai e ndihmon atë për të përmbushur dhe për të kuptuar vetveten. Ai e bën atë të aftë për të ndërje se kufiri i perceptimit shqisror nuk është kufiri i fundit i ekzistencës së tij.

Mirëpo, ja që njeriu është një qenie që harron, që priret kah harresa, aq më tepër në kohët moderne, ku jeta sociale e qyteteve me realitetin e shumëfishtë në përgjithësi dhe me sytë e shtangur nga i ashtuquajtur "zhvillim teknologjik" në veçanti, sa vjen dhe e përhumbe vazhdueshëm qenien ndër shtjellat e harresës.

Pra, pikërisht sot, është njëmend thellësisht e nevojshme për t'i rikthyer seriozisht raportit të qytetit me tempullin, duke nisur nga përfaqësuesit fetarë dhe intelektualët që kanë në dorë ta shtjellojnë çështjen e të japin pikëpamjet e tyre e deri te sferat drejtuese në nivel lokal e qeveritar që kanë në dorë ta përkthejnë në realitet praktik këtë raport.

5. Po aty.





# Hasan Basriu

rahmetullahi alejh

*Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz*

Emri i tij është Hasan bin Ebi'l-Hasan el-Basri, ndërsa nofka është Ebu Muhamed dhe Ebu Said. Ai ishte kryeura e “Brezit të Artë”, që larrinte deri te “Shekulli i Lumturisë”. Ishte prej imamëve të brezit të tabiinëve dhe profesor në fikh e në tasavuf.

Përgjatë çlirimeve islame, babai i tij u soll si rob në Medinë nga Mejsani, i cili është një vend afër Basrës së Irakut dhe u lirua nga Zejd bin Thabit el-Ensari. Nëna e tij është zonja Hajra, që u lirua nga Umu Seleme, e cila ishte njëra prej bashkëshorteve të Pejgamberit, sallallahu alejhi ve sellem. Ai lindi në vitin 21 hixhri (642 p.e.s.), në kohën e hilafetit të Hazretit Umer, radijallahu anh. Kur lindi, e dërguan te Hazreti Umer për t’i vendosur emrin. Kur Hazreti Umer pa fytyrën e tij të bukur, tha: “Emri i tij le të jetë Hasan!”

Hasan Basriu u rrit në shtëpinë e nënës së besimtarëve, Umu Seleme. Ai fitoi dashurinë, interesimin dhe lutjet e saj.

Lidhja e tij është me Imam Aliun, radijallahu anh. Nga ai veshi pelerinën e misticizmit. Ai është takuar me rreth njëqind e tridhjetë sahabë, shtatëdhjetë prej të cilëve patën marrë pjesë në Luftën e Bedrit. Po ashtu, ka transmetuar hadithe nga sahabët e mëdhenj, si Imran bin Husejn, Themure bin Xhundeb, Ebu Hurejre, Ibn Umer dhe Ibn Abas.

Pasi përfundoi studimet shkencore dhe edukimin shpirtëror në Medinë, u vendos në Basra, që ishte vendi i babait të tij. Ai formoi një fushë të madhe ndikimi me karakterin e fortë, me asketizmin dhe devotshmërinë, me adhurimin dhe frikërespektin ndaj Allahut. U takua me personalitete të nderuara, si Ibn Shirin dhe Shabi. Në Basra u bë një xhemat i madh, që dëgjonte vazat e tij. Rabiatur'l-Adevije, Malik bin Dinar dhe Habib Axhemi, ishin prej mistikëve të mëdhenj që përfituan prej tij.

Ai u shkroi letra burrave të shtetit, si Imam Hasan bin Aliut, radijallahu anh, dhe Umer bin Abdulazizit, të cilat synonin predikimin. Me këto letra, ai konsiderohet prej mistikëve të parë që këshillonin njerëzit për në udhëzim. Duke shfaqur një trimëri të rrallë, ai i shkroi këto fjalë Umer bin Hubejre el-Fezarit, i cili ishte emëruar prefekt i Irakut dhe i Horosanit nga Jezid bin Abdulmeliku:

“O Ibn Hubejre! Ki frikë Allahun për Jezidin, por mos ki frikë Jezidin për Allahun! Sepse Allahu të

shpëton ty nga Jezidi, ndërsa Jezidi nuk mund të të shpëtojë ty nga Allahu. Allahu Teala të dërgon befasisht ëngjëllin e vdekjes dhe ti bie nga vila jote e bukur, drejt e në varrin e ngushtë. Aty asgjë nuk mund të të shpëtojë, përveç punës sate."

Me punën e tij, Hasan Basriu konsiderohet përfaqësues i tasavvufit, që mbështetej në frikë dhe brengë. Cilësia dalluese e jetës së tij askete ishte meditim, i cili e shpie njeriun te besimi dhe frika e brengosja që e pastrojnë veten, e bëjnë njeriun që të fitojë kënaqësinë e Allahut dhe e shpien atë te mirësitë e xhenetit. Baza e jetës së tij shpirtërore, ishte heqja dorë nga kjo botë, mosinteresimi mbi të ardhmen e botës, drejtimi nga Allahu dhe besimi ndaj tij.

Vishte rroba prej leshi dhe këtë e konsideronte si shenjë të modestisë. Ai thoshte:

**S**ikur t'i shihnit ata, do t'i pandehnit të çmendur. Sikur ata të shikonin të mirët tuaj, do të thoshnin: "Këta janë njerëz që nuk kanë pjesë nga e mira dhe mirësia". Ndërsa po të shikonin të këqijtë tuaj, do të pyesnin: "Edhe këta janë myslimanë?"

"Unë kam arritur rreth shtatëdhjetë sahabë që kanë marrë pjesë në Luftën e Bedrit. Asnjëherë nuk kam parë që këta të vishnin diçka tjetër përveç leshit." Përsëri thoshte: "Atij që vesh rroba të bardha për modesti, Allahu ia shton dritën e largpamësisë, por, nëse i vesh për shtirje dhe mburrje, e hedh në xhehenem."

Duke krahasuar brezin e mëvonshëm me sahabët, thoshte:

"Sikur t'i shihnit ata, do t'i pandehnit të çmendur. Sikur ata të shikonin të mirët tuaj, do të thoshnin: "Këta janë njerëz që nuk kanë pjesë nga e mira dhe mirësia". Ndërsa po të shikonin të këqijtë tuaj, do të pyesnin: "Edhe këta janë myslimanë?"

Ai ishte asket. Shkaku i të drejtuarit nga asketizimi, ishte shpëtimi nga një e keqe dhe arritja e një mirësie. Mirësia që dëshironte të arrinte, ishte sevapi i xhenetit, ndërsa e keqja prej së cilës dëshironte

të sigurohej, ishte ndëshkimi i xhehenemit. Sepse asketizmi i vërtetë, është mosvlerësimi i tepërt i kësaj bote.

Nuk është parë asnjë njeri që të gjejë ahiretin duke kërkuar këtë botë, por ka shumë prej atyre që e kanë gjetur këtë botë, duke kërkuar ahiretin. Kjo botë është vendi i punës. Ai që e shoqëron atë pa e dashur dhe heq dorë prej saj, arrin kënaqësinë nga kjo shoqëri dhe përfiton. Por ai që e shoqëron duke e dashur, bëhet fatkeq.

Një ditë, Malik bin Dinar pyeti Hasan Basriun:

- Cili është ndëshkimi më i rëndë në këtë botë?

- Është vdekja e zemrës së njeriut.

- Përse vdes zemra?

Hasan Basriu iu përgjigj:

- Për shkak se do këtë botë.

Sepse ai që e nderon interesin e kësaj bote, bie në poshtërim. Sado që të jetë e madhe, përsëri e përkohshmja nuk është e barabartë me të përherëshmen.

\*\*\*

Ai thotë:

"Vesvesi që vjen në zemër është nga shejtani. Nëse diçka dëshirohet vazhdimisht, ajo vjen nga vetja. Mënyra për të shpëtuar nga këto dëshira, është praktikimi i rrugës së rijazetit me agjërim dhe namaz."

Ai tregon:

Në Abadan ishte një njeri i zi, i cili jetonte në gërmadha. Një ditë, mora disa gjëra nga pazari dhe shkova ta vizitoja. Ai më pyeti:

- Çfarë janë këto?

Unë i thashë:

- Disa gjëra për të cilat mund të kesh nevojë. Pa thënë asgjë, me dorën e tij më tregoi murin dhe qeshi. Befas pashë, por çfarë të shikoja, muret e atyre gërmadhëve ishin komplet flori. U pendova për atë që bëra, menjëherë i lashë ato që kisha sjellë dhe u largova me



ëndërr, i tregon kështu:

“Një njeri, i cili kishte një pjatë në dorë, u afrua te unë. Në pjatë kishte mish derri. Më urdhëroi që të haja nga ai. I thashë: “Ai është mish derri dhe nuk mund ta ha”. Duke insistuar që ta haja, ma hapi nofullën dhe më futi me zor një kafshatë në gojë. Unë kisha frikë që ta nxirrja mishin nga goja dhe, po ashtu, kisha neveri ta gëlltisja. Në këtë gjendje u zgjova. Këtë erë e kam ndjerë tridhjetë ditë e tridhjetë net, në çdo gjë që kam ngrënë dhe kam pirë.”

ndi-  
kimin  
e asaj  
madhësh-  
tie.

\*\*\*

Ai ishte i devotshëm. Gjithmonë thoshte: “Një grimcë e devotshmërisë së sinqertë, është më e mirë se mijëra rekate namaz.” Një ditë në Mekë, pa njërin prej fëmijëve të Hazretit Ali, i cili po mbante vazë duke u mbështetur në murin e Qabes dhe e pyeti:

- Cila është baza e fesë?
- Devotshmëria!
- Cili është shkatërrimi i fesë?
- Tamahu!

Hasan Basriu u kënaq shumë nga kjo përgjigje dhe u bë njeri i devotshëm. Për devotshmërinë thoshte kështu:

“Devotshmëria ka tri shkallë:

E para: I devotshmi thotë vetëm të drejtën edhe kur është i zemëruar edhe kur është i qetë.

E dyta: I mbron gjymtyrët e tij nga sjelljet që i hapin rrugë zemërimit të Allahut.

E treta: Synon çështjet prej të cilave Allahu është i kënaqur.”

\*\*\*

Një herë, hyri në një xhami për të falur namazin e akshamit. Namazin po e falte Habib Axhemi. Ngaqë Habib Axhemi nuk ishte Arab, ai nuk e fali namazin pas tij, duke u shqetësuar se mos bënte ndonjë gabim në leximin e Kuranit. Atë natë në ëndërr, iu tha: “Përse nuk u fale pas tij? Sikur të ishe falur, do të të falëshin të gjitha mëkatet që ke bërë deri në atë çast.”

Një herë, u detyrua të dëgjonte një përgojim në kuvendin ku merrte pjesë. Gjërat që pa atë natë në

Edhe pse e dinte se ndëshkimi shpirtëror i imponimit për të dëgjuar përgojimin, qoftë edhe pa dashje, është shumë i rëndë, asnjëherë nuk zemërohej me ata që e përgojnin. Një ditë, dikush i tha:

- Filani të ka përgojuar.

Ai i dërgoi një pjatë ëmbëlsirë përgojuesit dhe i tha:

- Dëgjova se më ke dhuruar të mirat e tua. Edhe unë po të dhuroj këtë si kundërvlerë.

Jeta e tij askete ishte e mbushur plot me frikë dhe pendim ndaj Allahut të Madhëruar. Ishte i shqetësuar dhe i brengosur. Ai nuk flinte dhe nuk dinte ç’ishte dremitja. Ishte një adhurues, i cili i kishte përveshur mëngët për ibadet. Ata që e shikonin, kujtonin se mos i kishte ndodhur ndonjë fatkeqësi, për shkak të brengosjes që kishte në aparençë. Ai shprehej:

“Besimtarët zgjohen të shqetësuar dhe ngrysen të shqetësuar ndërmjet dy frikëve. Njëra është një mëkat i kaluar, i cili nuk dihet se si pritët nga Allahu. Ndërsa tjetra është një jetë, përgjatë së cilës nuk dihet se me çfarë rreziqesh do të përballësh.”

“Ai që e di se në fund do të vdesë, që beson se do të ngrihet në kiamet dhe që është i bindur se, kur të ringjallet do të dalë në audiencën e Allahut, duhet të jetojë me brengosje dhe shqetësim.”

Sipas konceptit të tij në frikërespekt ndaj Allahut, zemra ka nevojë për një frikë të përhershme.

Ai frikësohej aq shumë nga zjarri i xhehenemit, saqë pandehte se xhehenemi është krijuar vetëm për të. Kështu, kur dëgjoi hadithin fisnik, i cili thotë: “Njeriu i fundit që do të dalë nga xhehenemi, është një person i cili quhet Hunad”, qau dhe tha: “Ah sikur të isha unë Hunadi, sepse qoftë edhe në fund, ai ka një siguri se do të dalë nga xhehenemi. Ndërsa ne nuk e kemi një siguri të tillë.”

Ai thotë:

“Nëse lexon Kuran dhe i beson atij, le të kesh shumë brengosje e shumë frikë në këtë botë. Po ashtu, qaj shumë.”

A tyre që thoshnin se i trembte njerëzit me fjalë të tilla, u përgjigjej kështu:

“Të frikësohesh derisa të arrish sigurinë, është më mirë se të frikësohesh pasi të arrish sigurinë.”

\*\*\*

Një bedevi e pyeti se çdo të thotë sabër. Ai iu përgjigj:

- Sabri është dy llojesh: njëri është durimi ndaj belave e fatkeqësive dhe tjetri është durimi ndaj ndalesave hyjnore.

Kur bedeviu i tha:

- Unë nuk kam parë njeri më asket se ti.

Hasan Basriu iu përgjigj:

- Asketizmi im është plotësisht dëshirë. Durimi im është plotësisht qarje.

- Çdo të thotë kjo? A mund të ma shpjegosh pak? Më është ngatërruar koka fare.

- Durimi im në fatkeqësi e bindje, shpreh frikën time ndaj zjarrit të xhehenemit. Çfarë mund të jetë tjetër kjo, përveçse qarje? Ndërsa fakti që unë jam asket dhe nënvlerësues ndaj kësaj bote, çfarë mund të jetë tjetër përveçse dëshira ime për ahiretin? Lum për atë që duron vetëm për Allahun e jo për faktin se shqetësohet për xhenetin dhe xhehenemin!”

\*\*\*

Ai thotë:

“Ëmbëlsinë shpirtërore kërkojeni në këto tri gjëra: Në namaz, në dhikër dhe në leximin e Kuranit. Lum për ju, nëse e gjeni. Nëse nuk e gjeni, dijeni se ju është mbyllur dera e veprës, e ëmbëlsisë shpirtërore, për shkak të ashpërsisë së zemrës.”

Kur i thanë:

- O shejhu ynë i nderuar! Zemra po na fle. Ju lutemi na qortoni.

Ai u tha:

- Ah sikur të flinte zemra juaj, sepse është shumë

lehtë të që ta zgjosh atë që fle. Por zemra juaj është e vdekur, sepse u bënë shumë kohë që përpiqem ta vë në lëvizje, por nuk ia dal dot mbanë.

Ilmu'l-Batin, sipas Hasan Basriut:

“Është një mister hyjnor, të cilin Allahu e vendos në zemrën e robërve të tij dhe të cilin nuk e di asnjë prej krijesave”. Ajetin: “Pastro rrobat e tua!” e komenton në formën: “Zbukuro moralin tënd!” dhe thotë: “Gjuha e të urtit është e lidhur me zemrën e tij. Kur dëshiron të thotë diçka, konsultohet me zemrën dhe, nëse është e dobishme, e thotë, përndryshe hesht. Ndërsa zemra e injorantit është e lidhur me gjuhën e tij. Gjuha nuk ndjen nevojë për t’u konsultuar me zemrën, kështu që flet mbarë e prapë.”

“Njerëzit e devotshëm vazhdimisht zgjedhin hesh-tjen. Asnjëherë nuk flasin pa folur zemrat a tyre.”

Së fundi, burri i dijes dhe i veprës, murshidi i madh Hasan Basriu, i cili thotë: “Kur të duash t’i urdhërosh diçka dikujt, së pari bëje vetë!”, u bë shembull për popullin, duke i përjetuar në vetvete vazat dhe këshillat e tij.

Në vitin 110 hixhri (728 p.e.s.), kur ndërroi jetë, xhenazeja iu fal nga një kallaballëk i madh në vendin e tij, Basra. Madje, sipas një transmetimi, kur ai ndërroi jetë, disa miq të Allahut kanë parë se janë hapur dyert e qiellit dhe kanë dëgjuar një thirrës që thërriste kështu:

“Hasan Basriu ndërroi jetë, kur Allahu ishte i kënaqur prej tij.” 1-Keshfu'l-Hafa, 1/15. 2-el-Muddeththir, 4.

#### Shënimet:

Ibn Sa'd, Tabakat, VII, 156 vd.: Isfahani Hiljetu'l-evtija, II, 130 vd, Huxh-viri, Përktimi i Keshfu'l-mahxhub, 183, Sha'rani, Tabakall'i-kubra, I, 31 vd., ibn Hallikan, Vefejatu'l-a'yan, II, 69, Attar, Tezkiretu'l-evlija, 30 vd, en Nebhani, Xhami'u kiramatil-evlija, 21. Kushejri, Përktimi i Risales, 213. Kelabazi et-Ta'arrui; Munavi, el-Kevak Ibnu'd-durrijje, I, 17.





SHKODRA E PËRMBYTUR  
NGA UJI, 1933

# FOTOJA E MUAJIT



# 20 vjet MEDRESE

Medreseja është 20-vjeçe, një 20-vjeçar është plot ëndrra, e tillë është medreseja sot.

**PRESIDENTI BAMIR TOPI I AKORDON MEDRESESË "HAXHI SHEH SHAMIA", SHKODËR  
URDHRIN "NAIM FRASHËRI" I ARTË**

Medreseja "Haxhi Sheh Shamia", shkollë me tradita fetare-kytëtare e kulturore në rrugëtimin e saj prej 20 vitesh rriti, edukoi dhe arsimoi breza të tërë, të cilët sot ndihen krenar për shkollimin e tyre.

Në kuadrin e javës së 20 vjetorit të Medresesë, u zhvilluan aktivitete të shumta si: sesione shkencore, fotoekspozita, mbrëmje solemne.

Sesioni shkencor "Islami, sistem gjithpërfshirës", i mbajtur në sallën e aktiviteteve të Medresesë së djemve trajtoi tema të tilla si: "Mbi botëkuptimin islam", Edison Çeraj; "Islami dhe demokracia", Arben Halluni; "Postmodernizmi dhe Islami", Ardian Muhja; "Islami dhe laicizmi", Gilman Kazazi; "Moraliteti islam dhe edukata shkollë", Zamira Bushati.

Sesioni u mbyll me "Hutben e lamtumirës", interpretuar nga medresisti, Suad Dushi.

Fotoekspozita në ambjentet e bibliotekës "Marin Barleti" u ingurua, më 8 dhjetor dhe qëndroi e hapur për tri ditë. Në këtë ekspozitë fotografike ishte paraqitur një ekspozitë e gjerë e veprimtarisë 20-vjeçare të Medresesë "Haxhi Sheh Shamia" si një nga institucionet më të rëndësishme arsimore në rrethin tonë. Të binte në sy një larmi e gjerë stendash fotografike në titujt: "Medresetë e vjetra", "Medreseja u hap në lagjen Dudas në vitin 1991", "Medreseja e vajzave", "Medreseja e djemve", "Drejtues të shoqatës V.H.K. "Istanbul", "Procese mësimore" etj. Ekspozita shoqërohej edhe me një dokumentar të përgatitur enaks për këtë eveniment.

Mbrëmja solemne me rastin e 20 vjetorit të Medresesë u zhvillua më 12 dhjetor, në teatrin "Migjeni", ku koncerti festiv u gërshetua me përshëndetje dhe dhënie titujsh nga institucionet e shtetit. Të ftuar ishin ish-drejtues dhe

drejtues të medresesë, deputetë, përfaqësues të KMSH-së, përfaqësues të pushtetit vendor e lokal, mësues dhe ish-mësues të Medresesë etj.

Programi nisi me himnin e flamurit, duke vijuar me këndimin e një pjese kuranore nga medresisti Zejd Buraniqi. Prezantuesit, ish-medresistet Freskida Miloti dhe Saimira Halili dhe medresistet Suad Dushi dhe Arlind Molla paraqitën historikun e medresesë, rrugëtimin dhe arritjet e saj sot.

Gjatë këtij aktiviteti u përkujtu mësuesit e parë të shkollës, drejtuesit dhe mbështetësit e saj në këtë rrugëtim 20 vjeçar.

Drejtori i shkollës, z. Kujtim Dervishi mbajti fjalën e hapjes, duke paraqitur rrugëtimin e Medresesë që në fillimet e saj, në lagjen Dudas deri sot. Ai e quajti 12 dhjetorin e vitit 1991, moment historik, ku nga dy klasa me 51 nxënës, sot janë 38 klasa me 1000 nxënës. Medreseja e Shkodrës -vijoi ai, trashëgon traditën e medreseve të vjetra, ku punuan personalitete të shquara. Në fjalën e tij ai theksoi se *Medreseja është 20-vjeçe, një 20-vjeçar është plot ëndrra, e tillë është medreseja sot.*

Më pas në emër të shoqatës V.H.K. "Istanbul", përshëndeti z. Ridvan Seferaj, sekretar i përgjithshëm i shoqatës V.H.K. "Istanbul" dhe koordinator i medresesë së vajzave. Në fjalën e tij ai shprehu falënderimet për themeluesit e parë, si për të ndjerin Haxhi Faik Hoxha, si dhe për të gjithë mësuesit e parë që i dhanë aq shumë shkollës. Ai falënderoi pushtetin lokal dhe popullin e Shkodrës, shoqatën "Islamic Relief" për zhvillimin në hapat e parë të kësaj shkolle. Në fjalën e tij përshëndetëse, ai gjithashtu falënderoi z. Osman Nuri Topbash, si edhe z. Rafet Bilaç si një urë e palëkundur mes Stambollit dhe Shqipërisë, si dhe Kryetarin e shoqatës z. Arif Qerozi.



Programi vazhdoi me një mesazh drejtuar qytetarëve të Shkodrës nga z. Osman Nuri Topbash: *“Kjo medrese e Shkodrës do të edukojë breza intelektualësh të rinj me shumë vlera që do të shërbejnë më së miri për një të ardhme të ndritur të Shqipërisë. Ashtu siç ka lindur dielli i Islamit për Shqipërinë nga Shkodra, si qyteti Islam pesë shekullor, ashtu edhe ky shërbim i vlefshëm që po bëhet sot do të plotësojë hallkën e shërbimeve në emër të fesë të vëllezërve tanë shkodranë.”*

Me propozim të Myftinisë Shkodër, Këshilli i Bashkisë Shkodër ka vlerësuar me titullin: *“Mirënjohja e Qytetit”*, katër drejtorët e kësaj medreseje, si dhe grupin e 20 mësuesve të parë që dhanë mësim në këtë medrese:

1. **Ahmet Osja**, me motivacionin: *“Drejtor i Medresesë “Haxhi Sheh Shamia” në vitet 1991-1995. Për kontributin e dhënë në rimëkëmbjen e Medresesë së Shkodrës në vitet e para të saj. Për përpjekjet në rrugën e forcimit të kësaj shkolle, ruajtjen e traditave kombëtare e fetare dhe nxitjen e përparimit shkencor”.*

2. **Islam Dizdari**, me motivacionin: *“Drejtor i Medresesë “Haxhi Sheh Shamia” në vitet 1995-1999. Për kontributin e dhënë në forcimin e procesit mësimor dhe edukativ, nxitjen e frymës krijuese ndër nxënës dhe arritjet e larta në nivel lokal”.*

3. **Hiqmet Bekteshi**, me motivacionin: *“Drejtor i Medresesë “Haxhi Sheh Shamia” në vitet 1999-2005. Për kontributin e dhënë në ruajtjen e ecurisë pozitive të Medresesë dhe nxënësve të saj. Për organizimin e aktiviteteve të shumta shkollore në dobi të komunitetit, me qëllim ruajtjen dhe forcimin e frymës së harmonisë qytetare në Shkodër dhe përtej saj”.*

4. **Kujtim Dervishi**, me motivacionin: *“Drejtor i Medresesë “Haxhi Sheh Shamia” nga viti 2005 e në vijim. Për kontributin e madh në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe arritjen e rezultateve të larta të medresistëve në rang lokal dhe kombëtar. Për afirmimin e Medresesë në rangun e gjimnazeve më elitare në Shkodër dhe përtej saj”.*

5. **Grupi i mësuesve nismëtar për hapjen e Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”**, me motivacionin: *“Për kontributin e madh në rimëkëmbjen e Medresesë së parë në Shkodër pas rënies së komunizmit. Për vlerat e larta qytetare, në përpjekjen e dëshmuar në kontributin e vazhdueshëm për imazhin e lartë të Medresesë. Për kontributin e madh vull-*

netar në zhvillimin e proceseve mësimore me një cilësi të dëshmuar dhe më një përkushtim qytetar e plot besim”.

Me rastin e këtij përvjetori jubilar Komuniteti Mysliman i Shqipërisë e ka dekoruar Medresenë “Haxhi Sheh Shamia” me çmimin **“Pishtar i dijes dhe arsimit islam”**. Këtë titull e mori drejtori i medresesë së vajzave në emër të stafit, z. Astrit Dervishi, i cili duke falënderuar pjesëmarrësit, shprehu se medreseja do të jetë përjetësisht dhe të mos ndërpritet siç u ndërpre.

Më pas përshëndeti, Drejtoresha e Arsimit, znj. Atrida Ferketi, e cila theksoi se *Medreseja është një shkollë konkurruese dhe bashkëkohore, e cila po nxjerr gjithnjë breza të përgatitur.*

Aktiviteti u përshëndet edhe nga katër ish-medresitë, të cilët në rrugëtimin e tyre, pas diplomimit, sot janë në profesione të ndryshme. z. Muhamed Sytari, Myfti i Shkodrës, Albana Kullolli, Ermira Xhaka, mjeke dhe Mirjon Rexha, Drejtor i PTT-së.

Momenti më emocionues dhe vlerësues për Medresenë ishte akordimi i urdhërit **“Naim Frashëri” i Artë** me motivacionin **“Për kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e arsimit kombëtar, për edukimin dhe përgatitjen e nxënësve me dashuri për atdheun dhe besimin Islam, të aftë të përballojnë sfidat e kohës, në shërbim të përparimit dhe zhvillimit të shoqërisë.”**

Ky titull, i cili iu dha drejtorit të medresesë z. Kujtim Dervishi nga Këshilltari i presidentit Bamir Topi, z. Fatlum Nurja dëshmon për një vlerësim të madh, për një mirënjohje pakufi për të gjithë ata që punuan e punojnë për të edukuar breza me formim fetar, kulturor dhe shkencor.

Programi u shoqërua me ilahi shqiptare dhe turke kënduar nga Adnan Bala, Hajro Pepa, Alban Kali, Resmi Lika.

Emocion përcollën tek të ftuarit kënga “Medreseja ime” kënduar nga Rezarta Smaja dhe “Mësues i parë” kënduar nga medresistët Selma Bekteshi dhe Suad Dushi.

Libreti u përgatit nga Xhahid Bushati, skenografia nga Silvera Nikshiqi dhe regjia nga Merita Smaja.

Medreseja “Haxhi Sheh Shamia” do vazhdojë rrugëtimin e saj për të edukuar breza gjithnjë e më të devotshëm.



# Nga duhet të fillojmë që ta lexojmë dhe mësojmë islamin?

Mustafa Erish

**L**eximin dhe mësimin e islamit apo formimin e konceptit për të, duhet ta fillojmë nga Kurani, sepse Kurani është libri që ka zbritur Allahu, nuk ka asnjë shtrembërim dhe me të i ka bërë përgjegjës njerëzit. Allahu i Madhëruar thotë:

**“Rrugën e drejtë e tregon Allahu.”** (16 Nahl/9.) **“Falënderimi i takon Allahut që ia zbriti robit të tij librin, i cili nuk ka asnjë shtrembërim.”** (18 Kehf/1.) **“Sigurisht se Kurani udhëzon në rrugën më të vërtetë.”** (17 Isra/9.)

**I Madhëruar është Ai që ia shpalli Furkanin** (Kurani, dallues të së vërtetës nga e pavërteta) **robit të tij** (Muhamedit), **që të bëhet këshillues për botët. Atij i takon sundimi i qiejve dhe i tokës, Ai nuk ka as fëmijë dhe as shok në sundimin e Tij. Ai krijoi çdo gjë, duke e përsosur në mënyrë të qartë e të matur.”** (25 Furkan/1-2.)

**“Përmbajuni rrugës sime të vërtetë dhe mos ndiqni rrugë të tjera që ju ndajnë nga rruga e Tij. Allahu ju porositi, në mënyrë që të ruheni.”** (6 En’am/153.)

Për të mësuar islamin, në periudhat e para u ndoq kjo radhë: së pari Kurani, pastaj suneti, shkencat teologjike dhe islami i shoqërisë. Kjo radhë me kalimin e kohës u prish dhe mësimi i islamit u bë në këtë mënyrë: së pari islami i shoqërisë, pastaj shkencat teologjike, hadithi dhe në fund Kurani.

Kështu, shumë herë Kuranin ia kanë përshtatur atyre gjërave që thuhet, qoftë në islamin shoqëror, qoftë në degët e shkencave teologjike apo në

transmetime. Ndërkohë që, për saktësinë dhe vlefshmërinë e atyre që thuhet dhe që bëhen si fe, mund të flitet vetëm duke iu përshtatur Kuranit.

Kur të formohet koncepti i fesë duke filluar nga Kurani dhe rruga të nisë nga ai, në mendjen e njeriut formohet një masë dhe një këndvështrim që e ka formuar Kurani. Ky koncept dhe kjo masë që ka formuar Kurani është siratu’l-mustekim, pra rruga e drejtë. Tashmë, kur të vlerësohen ato që lexohen dhe ato që thuhet, të gjitha vlerësohen me këtë masë, me këtë rrugë dhe me këtë këndvështrim.

Në këtë mënyrë nxirret në pah nëse i përshtaten apo jo Kuranit, sa i përshtaten atij dhe janë apo jo në kundërshtim me të. Kështu, Kurani bëhet pika qendrore e nisjes, drita që ndriçon rrugën; sovran dhe masë mbi të gjitha gjërat që thuhet/shkruhen në emër të islamit, sepse Kurani është hidajet/udhëzim, nur/dritë, furkan/ndarës i së drejtës nga e gabuara dhe delil/argument.

Ky konceptim ndërmjet umetit, siç ka ndodhur në periudhën e parë të islamit, sjell një konceptim të përbashkët, një perspektivë të përbashkët, një identitet të përbashkët, një ideal të përbashkët dhe një strategji të përbashkët.

Në këtë mënyrë zbriten në minimum konceptimet kontradiktore me Kuranin ndërmjet njerëzve dhe myslimanët nuk bëhen si popujt e mëparshëm që **“u përçanë grupe- grupe në fetë e tyre dhe secili grup kënaqej me atë që kishte...”** (30 er-Rum/32)

Kështu zbritet në minimum lindja e fraksioneve dhe e grupeve, të cilët formohen duke u nisur nga gjërat që thonë njerëzit në degët e ndryshme shkencore fetare dhe sociale. Divergjencat pakësohen, por, nëse përsëri lind ndonjë kontradiktë, zgjidhet duke ia lënë çështjen Allahut dhe të Dërguarit të tij, ashtu siç shprehet në ajetin fisnik:

**“O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i**

**bukur.”** (4 en-Nisa, 59.)

Rigjallërimi i shoqërisë në fillimin e islamit u realizua në këtë mënyrë, kështu që edhe në shekullin tonë dhe në çdo periudhë tjetër mund të realizohet vetëm në këtë mënyrë.

Kjo injorancë, erozion, prishje, shthurje dhe rënie që ka lindur nga largimi prej Kuranit, krahas shenjtërimit që ka apo, siç thotë një shkrimtar, me qefinosjen e Kuranit, duke e vendosur atë në këllëfe apo duke e kthyer në një libër vajtimi për të vdekurit, mund të kthehet në të kundërt, ashtu siç ndodhi në provën e parë që në fillim të islamit, pra me kthim te Kurani duke e bërë atë pikënisje qendrore, masë, motor dhe hartë rruge, me dije dhe konceptim, që do të nxirrte në pah faktin që atë e kemi bërë një burim, i cili jep jetë dhe duke i dalë për zot synimit e idealit që shfaq ai.

Në të kundërt, lëvizjet moderne, si shirat e pranverës, nuk mund të kalojnë përtej faktit të të qenit lëvizje të ndërthurura, popullore, fraksionale dhe lokale. Është provuar pothuajse në të gjitha krahinat e gjeografisë islame se nuk është e mjaftueshme që thjesht të bashkohen dy skajet e umetit.

Edhe sot është joproductive, sepse toni, ngjyra, dimensionimi, kapaciteti dhe perspektiva e çdo lëvizjeje moderne, që nuk zhvillohet dhe nuk realizohet duke pasur si bosht qendror Kuranin, janë të ndryshme dhe nuk mund të kalojnë përtej faktit të të qenit lëvizje lokale apo popullore, madje fraksionale dhe të ndërthurura.

Kjo u hap rrugë formimit të ishujve të vegjël që shqiptimin dhe mekanizmin e kanë të ndryshëm dhe humbjes së ndërjegjes së përbashkët në gjeografinë islame. Argumenti më i qartë që e faktin këtë, është se çdo krahinë e gjeografisë islame shfaq një konceptim dhe jetesë islame karakteristike me ngjyra të ndryshme si sexhadeja e grave me dyzet arna.

Ky ndryshim po arrin në përmasa të atilla, sa që klasat myslimane me konceptimet popullore dhe fraksionale që formon islami shoqëror, bashkëpunojnë me armiqtë e përbashkët ose mbajnë një qëndrim prej të verbëri, shurdhi dhe memeci kundrejt sulmeve armike.

Siç ka ndodhur në të kaluarën edhe sot, me shqetësimet që lindin prej konceptimeve dominuese politike, popullore dhe fraksionale, një klasë e myslimanëve bashkëpunon me imperialistët pushtues kundrejt klasës tjetër apo bën sehir ndaj pushtimeve dhe masakrave të tyre.

Kjo nuk ka lidhje me faktin se ndryshimet janë norma-

le dhe me ngritjen e zërit të mendimeve të ndryshme, sepse kjo shumëllojshmëri e ngjyrave dhe këta shumë zëra, nuk janë një shumëllojshmëri që del në pah brenda kornizave të Kuranit si ushqimet e ndryshme në një sofër, por është një shumëllojshmëri e të qenit të huaj ndaj Kuranit, humbje e kufijve të tij, rënie ters me të dhe ecje në lugina të tjera.

Me një thënie tjetër, këto janë gjëra vrasëse si helmi, i cili hahet ose pihet me nijet ushqimi bashkë me gjellërat e tjera në sofër. Fakti që secili prej autoriteteve shoqërore apo prijësve fetarë u bie telave të ndryshëm kundrejt problemeve dhe ngjarjeve jetike që u interesojnë të gjithë myslimanëve, sjellja prej të huaji ndaj njëri-tjetrit, shfaqja e mendimeve dhe sjelljeve kontradiktore dhe më e keqja, ngritja e zërit të mendimeve që nuk përputhen me Kuranin, është shenjë e kësaj.

Këta shumë zëra dhe kjo shumëllojshmëri që formon largimi nga Kurani dhe kundërshtimi i tij, janë prej pengesave më të mëdha përpara myslimanëve në shkallë vendi dhe vështirësia më e madhe e gjeografisë islame në shkallë globale.

Siç shfaqën sjellje kontradiktore ndaj Kuranit dhe të dëmshme ndaj njëri-tjetrit, myslimanët që aprovuan pushtimin e Palestinës në Kombet e Bashkuara dhe që mbështetën Francën kundër pavarësisë së Algjerisë, duke i parë ngjarjet më shumë nga perspektiva etnike, fraksionale, krahinore, politike dhe ekonomike edhe sot shfaqin sjellje kontradiktore dhe kundërshtuese ndaj Kuranit, duke e parë nga perspektiva më shumë etnike, fraksionale, krahi-

nore, politike dhe ekonomike pushtimin që imperializmi, krahas Palestinës i ka bërë edhe Çeçenisë, Afganistanit dhe Irakut.

Madje nuk hezitojnë të bashkëpunojnë me imperialistët kundër myslimanëve, për hir të një kolltuku apo privilegji.

Shkaku më i madh i kësaj është fakti se mendimet dhe konceptimet e popujve myslimanë, në vend që të formoheshin me Kuranin në qendër dhe që të gjithë të kishin një konceptim dhe mendim të përbashkët, u formuan me lëvizje që vinin nga dijet dhe kulturat bazë, që ishin formuar dhe popullarizuar si të turbulluara me kalimin e kohës dhe këtë e bënë masë sovraane për-caktuese.

Përderisa islami i njerëzve të ngelë në këtë fazë që formojnë konceptimet islame, duke filluar nga kultura shoqërore të cilën e quajmë islami i shoqërisë, është e pamundur që t'i përshtatet islamit të Kuranit, sepse këta njerëz, në vend që ta marrin e ta mësojnë islamit nga



dora e parë apo nga burimi i parë dhe t'i formojnë dijet, këndvështrimet, gjykimet dhe kriteret e vlerave sipas tij, marrin dhe mësojnë nga konceptimet e ndyra që formohen në shoqëri, duke filluar nga fundi dhe, sipas saj, formojnë gjykimet, masat dhe kriteret e vlerave.

Përderisa këtë proces mësimi dhe kuptimi të mos e nxjerrin deri te Kurani, i cili është shkalla e parë, përderisa masat të mos i marrin nga ai, përderisa gjykimet e vlerave të mos i formojnë sipas tij dhe, përderisa dijet e tyre të mos i testojnë me të, dashje pa dashje ngjarjet do t'i analizojnë me shabllone, perspektiva dhe masa që ka formuar në kokat e tyre islami i shoqërisë apo kultura shoqërore dhe me këtë kulturë do të vlerësojnë vërtetësinë apo pasaktësinë e tij.

Për të kuptuar shumë gjëra që thotë Kurani, shkojnë në rrugën e shpifjes me komentime, duke ia përshtatur Kuranin shablloneve të tyre.

Shembuj për këtë ka shumë. Një miku ynë, duke treguar një anekdotë në lidhje me këtë, thotë:

"Një ditë më erdhi një shoku im me një libërth në dorë me titull "Virtytet e Sures Jasin". Ai e ka formuar besimin e tij sipas kulturës tradicionale, është fetar dhe mjaftohet duke falur namaz nga xhumaja në xhuma. Më tregoi librin, më tha se kish-te një pyetje dhe kërkoi që t'i jepja përgjigje. Ai u shpreh:

Kam lexuar përkthimin e sures Jasin. Për herë të parë kam lexuar diçka nga përkthimi i Kuranit Fisnik, por ai që e ka përkthyer, ka shkruar budallallëqe dhe se një budallallëk i tillë nuk ka vend në Kuranin e Lartë. Pastaj e ofendoj përkthyesin: "Burrë i poshtër dhe i pandershëm! Si mund të thotë/shkruajë një gjë të tillë?"

Shoku im, pasi tha shumë gjëra të ngjashme me këto dhe pasi e ofendoj shumë rëndë atë që e kishte përkthyer, pyeti mendimin tim me një shprehje fytyre, i sigurt se qëndrimi që mbajti ishte i drejtë. Sipas tij, u soll në këtë mënyrë me synimin për të ruajtur madhështinë e Kuranit. Po, ai e ofendoj rëndë përkthyesin e libërthit në emër të mbrojtjes së Kuranit, sepse të mbrosh librin që beson, është një domosdoshmëri e besimit dhe ai këtë po bënte.

Nuk mund të kishte gjendje më të dhimbshme se kjo. Shoku im, në jetën e tij kishte lexuar për herë të parë përkthimin e sures Jasin dhe ajo që kishte lexuar, ishte dukur një budallallëk. Gjëja që atij i dukej budallallëk

nuk ishte origjinali i sures, por përkthimi i saj, sepse ai ishte një njeri që i besonte Kuranit.

Shpjegimet, të cilat sipas tij ishin budallallëqe, i shikonte si gjëra që nuk i kanë hije Kuranit, përkundrazi ato i pranonte si një fyerje të madhe. Sipas tij, këto budallallëqe nuk mund të ishin Kuran. Kurani është manipuluar. Këto budallallëqe janë shpifjet e atij burri të poshtër dhe tradhëtar që ka bërë përkthimin.

"Fjala e Allahut, që është një libër i shenjtë dhe i lartë, që përfshin brenda tij dijen e çdo gjëje që ekziston në këtë botë, që shpjegon çdo gjë, që është burim i shkencës dhe i teknologjisë, që çdo fjalë në të ka me mijëra kuptime nuk mund të ketë gjëra të zakonata dhe budallallëqe. Ai është një libër që bën mrekullira dhe askush nuk mund ta shpjegojë me kuptimin e vërtetë të tij."

Po, ky ishte konceptimi i Kuranit që kishte në kokë shoku im. Ai e ofendoj shumë Kuranin në emër të mbrojtjes së Kuranit, sepse gjëja që kishte lexuar dhe që po e fyente, me të vërtetë ishte përkthimi i sures Jasin dhe ky përkthim nuk kishte asnjë ndryshim me përkthimet e tjera, por shokun tim e penguan shumë të dhënat dhe informacionet e pasakta që kishte dëgjuar me vite nga të mëdhenjtë e tij, nga haxhilerët, nga hoxhallarët e tjerë.

Së pari u mundova t'ia shpjegoja se çfarë është Kurani dhe përse është dërguar. Pastaj e lexuam përsëri suren Jasin së bashku, duke u për-

pjekur për ta kuptuar. Kur mbaroi sureja, shoku im nuk e fshehu dot habinë e tij. Kundër asaj që tha pak më parë, tashmë i pëlqeu shumë përkthimi që lexuam. Pastaj më pyeti:

A më fal Allahu për atë që bëra? Çfarë duhet të bëj, që të më falë? Unë i thashë se duhet të pendohej. Kur u nda nga unë, duke u pikëlluar se si e bëri një budallallëk të tillë, mallkoi duke thënë:

"Allahu i shkatërroftë ata që më kanë mësuar kaq shumë gjëra gabim për Kuranin Fisnik, që prej vitesh e deri më tani." (Shënim: Erhan Aktaş, Hangi İslam, 68-70, Anlam Yayınları, 2003, Ankara).

Nëse është e nevojshme që të japim një shembull në lidhje me faktin se si të shpie në kuptim të gabuar shikimi i Kuranit nga dritarja e islamit shoqëror apo islamit kulturor, mjafton për këtë ajeti i 195-të i sures el-Bakara. Allahu i Madhëruar thotë:

*Shpenzoheni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit.*

**“Shpenzojeni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit.”** (el-Bakara, 195.)

Ajeti i 195-të i sures el-Bakara, i cili thotë se myslimanët duhet të japin nga pasuria për të luftuar në rrugë të Allahut, përndryshe do ta hedhin veten në rrezik me duart e tyre, duke u shprehur qartë:

**“Shpenzojeni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit.”**, e thotë këtë gjë duke u shkëputur dhe duke e kthyer plotësisht në të kundërt metodën nga njerëzit, vaizët dhe ligjëruesit ndër popull, të cilët i kanë formuar konceptimet fetare dhe shabllonet shkencore nga kultura bazë.

Prej këtyre njerëzve, ky ajet shpjegohet kështu: Të mos e hedhin veten në rrezik duke u përzier në këtë apo atë ngjarje, duke qëndruar me këta apo me ata, duke hyrë ndërmjet këtyre e atyre, duke mos iu përshtatur rregullave të trafikut, duke reaguar kundër imponimeve që bien ndesh me të drejtat dhe liritë e njeriut, duke kundërshtuar padrejtësitë dhe ligësitë, duke mos pasur kujdes ndaj pastrimit dhe shëndetit, duke dhënë shumë nga pasuria, kur të jetë e nevojshme dhe në punë të tjera të ngjashme me këto.

Sepse konceptimi fetar dhe psikologjia e formuar me këto gjëra që i janë thënë shoqërisë që në të kaluarën, i ka drejtuar ata që ta kuptojnë, ta shpjegojnë dhe ta kushtëzojnë ajetin në këtë mënyrë.

Në vend që të kuptohet për të bërë patjetër punët e domosdoshme për paqjen e shoqërisë si: të predikosh islamin, të urdhërosh të mirën, të luftosh me të këqijat, të ftosh në të mirë, të reagosh apo të kundërshtosh padrejtësitë dhe imponimet, të ndash ata që zihen, të dëshmosh për parandalimin e padrejtësisë, të ndihmosh të tjerët në punë nga aspekti financiar dhe fizik, të qortosh ata që shqetësojnë njerëzit në rrugë dhe në lagje, ajeti është kuptuar si: të mos prekësh ujin e sapunin, të mos përzihesh te gjërat me mish e me qumësht, të qëndrosh në qoshe, që të jesh i qetë, të mos marrësh përsipër përgjegjësi dhe të mos e hedhësh veten në rrezik me duart e tua. Kështu që, kuptimi i ajetit është devijuar në këtë drejtim.

Ndërkohë, ajeti nuk ka lidhje me gjërat që thuhën dhe me punët e tjera që duhet apo jo të bëhen. Përkundrazi, konteksti i ajetit është konteksti i luftës kundër armikut dhe thotë se njerëzit e hedhin veten në rrezik me duart e tyre, nëse nuk japin në rrugë të Allahut, sepse, kur të mos jepet nga pasuria e cila duhet dhënë dhe, kur

të mos përgatitet e të mos armatoset ushtria që do të luftojë kundër armikut, populli nuk do të ketë mundësi që të mbrohet dhe çdo gjë e shoqërisë myslimane do të shkatërrohet nga okupatori. Kështu, populli që nuk jep, e hedh veten plotësisht në rrezik me duart e tij.

Le të mendojmë, si do ta mbronin veten myslimanët kundër armiqve, nëse nuk do të jepnin në rrugë të Allahut nga pasuria, pjesën e duhur për t’u përgatitur dhe për të formuar ushtri kundër okupatorëve në luftën e Bedrit, Uhudit, Hendekut, Tebukut, Mu’tes, Hunejnit, Hajberit, Beni Nadirit, Beni Kurejdhes etj., që ndodhën në një kohë të shkurtër, pasi myslimanët fituan pavarësinë në Medinë dhe pasi Islami u bë shtet?

Sikur të mos e bënin këtë, a nuk do ta hidhnin veten në rrezik me duart e tyre? Kjo është hedhja e vetes në rrezik me dorën tënde për të cilën bën fjalë ajeti. Këtë tregon edhe konteksti brenda grupit të ajeteve të mëposhtme. Allahu i Madhëruar thotë:

**“Luftoni në rrugën e Allahut ndaj atyre që luftojnë kundër jush, por mos e kaloni kufirin, se Allahu nuk i do ata që e kalojnë kufirin.”**

**“Vritini ata, kudo që t’i gjeni dhe dëbojini prej vendeve, ashtu siç ju dëbuan ata ju. Përçarja është më e rëndë se vrasja. Mos luftoni me ta pranë Xhamisë së Shenjtë (Qabesë), përveç rastit kur ata ju sulmojnë aty brenda! E, nëse ata luftojnë me ju aty, atëherë vritini ata! I këtillë është ndëshkimi për jobesimtarët.”**

**“Por, në qoftë se ata heqin dorë, falini! Me të vërtetë, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”**

**“Luftojini ata derisa të zhduket mosbesimi dhe derisa të mbretërojë besimi vetëm për Allahun! Por, në qoftë se ata heqin dorë nga lufta kundër jush, atëherë s’ka armiqësi, përveçse kundër keqbërësve.”**

**“Shkelja e muajit të shenjtë do të shpaguehet me shkelje të muajit të shenjtë, por dhe shkelja e të shenjtave do të ndëshkohet në të njëjtën mënyrë. Pra, kushdo që ju sulmon, edhe ju keni të drejtë ta sulmoni atë, ashtu siç ju sulmoi ju! Frikësojuni Allahut dhe dijeni se Allahu është me ata që ruhen nga të këqijat.”**

**“Shpenzojeni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit.”** (el-Bakara, 190-195.) (Për të dhëna më të gjera dhe për shembuj të tjerë shik: Ibrahim Sarmësh, Hz.Muhamed’i Doğru Anlamak, I-II, Ekin Yayınları, Stamboll, 2007, Botimi i tretë).

vijon...





# Vlera dhe dëshmi nga një libër që nxit respekt

*Imam Muhamed Sytari*  
*Myfti i Zonës Shkodër*

**D**alja me vonesë në qarkullim e librit “The-melet e një Medreseje”, me autorë mësuesit e mi të medresesë, Eljaz Kraja dhe Ahmet Osja, më gëzoi pa masë dhe më mbushi me emocione, nostalgji dhe kujtime, si ato të viteve të para, kur nisi rrugëtimin e saj të begatë Medreseja e Shkodrës, “Haxhi Sheh Shamia”.

Këtë libër e kam shfletuar shumë herë para se të shihte dritën e botimit, për faktin se autori Eljaz Kraja më kërkoi të isha redaktor. Disa herë jam takuar me dy autorët e, në veçanti, me zotni Eljazin, njeriun serioz, të urtë, dëgjuesin e vëmendshëm, bashkëbiseduesin e dashur, studiuesin shterrues të dokumenteve, arkivit dhe historisë së viteve të para të Medresesë, për të cilën dha shumë nga energjitë e tij, dashurinë, vullnetin dhe dëshirën për ta parë mbi çdo gjë tjetër!

Realisht, ky libër, ku është pasqyruar një pjesë e rëndësishme e jetës së Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, u ka munguar bibliotekave tona dhe brezave që do të pasojnë, për disa arsye:

1. Në rreshtat e tij lexohet pastër një histori e thjeshtë, por shumë reale e përpjekjeve, peripe-

cive, shpirtit të sakrificës dhe vullnetit qytetar e besimtar për të ngritur në këmbë një institucion të vërtetë arsimor të tipit *medrese*, në vite të veshitura e pa përkrahje, si ato të postkomunizmit në Shkodër e Shqipëri.

2. Aty lexohet qartas, mrekullia e Zotit në këtë vend e në bijtë e tij, që, edhe pse ia sollën shpinën duke bërë titur me zë të lartë kundër Tij, Allahu bëri të mundur që nga mesi i tyre të ringjallej shpresa e vijimit në rrugën e baballarëve, brezave të nderuar të këtij qyteti që jetuan, punuan dhe u larguan nga kjo botë me besimin e patundur në Njësinë e Allahut!

3. Aty qëndrojnë dukshëm përpjekjet dhe rropatjet për të ndërtuar një shkollë vlerash, me duar shqiptare, plot besim, kulturë dhe dije! Ndoshta sot, më shumë se kurrë, duhet të kthejmë kokën pas dhe të kuptojmë se sekretin e mbarësisë dhe i suksesit të kësaj shkolle, që vazhdoi të shumëzohej vit pas viti, qëndronte në thjeshtësinë dhe sinqeritetin e atyre dhjetra burrave e grave, që morën mbi supë një mision sa të vështirë, aq edhe të shenjtë: **dritësimin e së ardhmes**

## **shqiptare për bijtë e kësaj toke besimtare dhe thellësisht islame!**

4. Medreseja e Shkodrës tërhoqi vëmendjen e mësuesve më elitare të qytetit, të cilët nuk kursyen dije dhe përkushtim nga përvoja e tyre, për t'i dhënë forcë, qëndrueshmëri, shpirt dije dhe besim shkollës më të re me shpirt islam në qytetin e vjetër të minareve, hoxhallarëve të nderuar dhe çallmave të bardha!

5. Shumë shpejt Medreseja "Haxhi Sheh Shamia", nisi të kthehej në një qendër të mirëfilltë për edukimin e mendimit shkencor e fetar, gjë që solli edhe frutet e veta, ndoshta të papritura edhe për vetë mësuesit dhe drejtuesit e medresesë. Në harkun kohor të dy viteve, **tre nxënës të medresesë botuan katër libra**. Me të drejtë autorët tërheqin vëmendjen e lexuesit: "Pyesim: Tre nxënës të cilës shkollë kanë botuar katër libra në dy vite?" - (fq. 154).

Shkrimtari Xhahid Bushati, duke referuar në promovimin e njërit prej këtyre librave thekson: "(Autorja) zgjedh varg të butë e njerëzor, jo varg rebel. Ajo ka gjetur balsamin për t'ua gëzuar shpirtin lexuesve" - (fq. 158), gjë që të bën të mendosh për origjinën e edukimit të autores së re në medrese.

Studiuesi Alfred Çapaliku, pjesëmarrës në një nga aktivitetet promovuese të librave të medresistëve të rinj, theksonte se: "Kjo shkollë i ka të gjitha premisat për të nxjerrë talente të reja, që krahasohen me autorë të mëdhenj. Ai shprehu habi për nivelin e lartë të referatit mbi tekstin dhe nëntekstin dhe për analizat dhe mendimet që u dhanë nga nxënës të vitit të tretë të medresesë. Këto mësimë, tha ai, zhvillohen në vitin e tretë të universitetit" - (fq. 158).

6. Praktika fetare është një veprimtari shumë e rëndësishme që u ndërmor në vitet e para të Medresesë "Haxhi Sheh Shamia". Natyrshëm, vitet e para të postkomunizmit e gjetën Shkodrën

shumë të varfër në drejtim të kuadrove fetare. Përveç ndonjë ish-medresisti të kohëve të largëta a ndonjë individ që kishte thyer gjunjët për dekada para hoxhallarëve të vjetër të Shkodrës, por i anatemuar në një qoshk të parëndësishëm, kuadro kompetentë e specialistë të fesë islame nuk kishte! Medreseja nisi të bënte detyrën e zbutësit të kësaj varfërie, kuptohet, me nxënës fillestarë, që gjithsesi, nuk mund të pretendohet prej tyre as më pak e as më shumë nga ajo që mund të jepnin. Por ishte një shenjë e rëndësishme jetel! Më lejoni të citoj një dëshmi nga libri, në lidhje me këtë fakt: "Le të shënojmë vlerësimin që iu bë në veçanti, një vit më vonë, në mars 1994, nxënësit të klasës VII, Ditmar Faja, atëherë jo më i madh se 13 vjeç, që drejtoi disa herë, si imam mjaft i pëlqyer, namazin e teravisë e të jacisë në sallën e faljes së medresesë në lagjen Dudas" - (fq. 166).



7. Unë jam krenar të pohoj sot se nga brumi i medresesë së Shkodrës morën nxitjen për të ecur përpara në rrugën e specializimit në shkencat teologjike, shkencore e sociale me dhjetra djem e vajza, të cilët vazhdojnë të gëzojnë edhe sot pozita drejtuese në institucione të ndryshme të Shkodrës dhe përtej saj.

Uroj që ky libër mos të ngelet jetim, pasi do të ishte një padrejtësi intelektuale, në hak të një shkolle që nisi me shumë vështirësi dhe pengesa, por që rrugëtoi me maturi drejt sukseseve dhe tashmë lulëzon, si një ndër gjimnazet më të mira të Shqipërisë, më i madhi në Shkodër.

Rahmete mbi shpirtin e mësuesit tim Eljaz Kraja, mbarësi biologut Ahmet Osja, nderim dhe përlujtje për krejt mësuesit dhe drejtuesit e nderuar që ujitën me përkushtim e besim në Zotin (dhe akoma vazhdojnë), pemën e begatë të besimit në Allahun, dijes, kulturës dhe shkencës: **Medreseja "Haxhi Sheh Shamia"**.



# Një Ajet

*Me emrin e Allahut,  
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!*

***“Elif Lám Râ. Ky është një Libër, vargjet e të cilit janë radhitur mrekullisht dhe janë parashtruar me hollësi nga ana e Një të Urti të Gjithëdijshtëm.”*** (Hud, 11)

Nën hijen e Kuranit, njeriu mëson të përsiatet mbi natyrën, të thellohet në ndjenja dhe mendime, të jetojë me fisnikëri. Jeta kosiderohet si rasti më i vlefshëm, prej të cilit duhet përfituar. Sepse rruga e lumturisë dhe bukurisë kalon nëpër këtë jetë. Njeriu zhvillon një perspektivë të re dhe një botëkuptim të bazuar në tevhid. Kjo perspektivë e re sjell një ndryshim rrënjësor në mënyrën e vlerësimit të marrdhënieve midis njeriut dhe mjedisit përreth. Në hijen e Kuranit koncepte të tilla si fitimi-humbja marrin një kuptim tjetër, kështu që kriteret që përcaktojnë fitimin apo humbjen ndryshojnë. Fitimi në këtë botë nuk shikohet gjithmonë si fitim dhe humbja në këtë botë nuk shikohet gjithmonë si humbje. Nuk janë të pakta rastet, kur shumë vetë në planin tokësor duket sikur janë duke fituar, por që në të vërtetë janë duke humbur dhe anasjelltas. Fitimi i vërtetë nuk i përket kësaj bote, por ahiretit. Për rrjedhojë, jeta në të gjitha aspektet e saj, duke filluar nga jeta individuale, në jetën familjare, nga jeta profesionale në jetën sociale, shndërrohet në një transaksion shpirtëror. Nëpërmjet Kuranit, njeriu fiton edhe në këtë botë edhe në botën tjetër. Kurse qytetërimi i sotëm ndoshta siguron fitim në këtë botë, por në botën tjetër humbja është e sigurt, sepse nuk ka krijuar një ekulibër midis materiale dhe shpirtërore. Sipas Kuranit, njeriu nuk është thjesht një qenie materiale, por një qenie ku shpirti dhe materia janë të ndërthurura ngushtë me njëra-tjetrën. Vlerat shpirtërore janë thelbësore, përcaktuese në jetën e njeriut. Kurani i mëson njeriut se shpirtërorja është thelbësore dhe e përhershme, kurse materialja është e përkohshme. Kështu, njeriu bëhet dëshmitar se të mirat e kësaj bote janë të përkohshme dhe të pavlefshme në krahasim me mirësitë e botës tjetër.

Nën hijen e Kuranit, çdo ajet që lexojmë përçon një kuptim të ri në botën tonë shpirtërore.

Kurani i vjen në ndihmë njeriut në momentet kur mendon se jeta e ka humbur kuptimin. Kurani e ngushëllon dhe e lidh përsëri me jetën. Duke u dhënë drejtim mendimeve, sjell gëzim dhe lumturi në zemrën e njeriut. Ai kupton nën hijen e Kuranit se çdo gjë vepron sipas përcaktimit absolut hyjnor. Atë që e ndihmon Allahu, nuk ka kush e poshtëron dhe, kë poshtëron Allahu, nuk ka kush e ndihmon. Në këtë mënyrë, njeriu kupton se krenaria dhe nderi vijnë nga Allahu dhe jo nga pozitat e kësaj bote.

# Një Hadith

*Umer ibn Katabi (r.a.)*

*transmeton se Resulullahi (s.a.o.s.) ka thënë:*



*“Allahu nëpërmjet Kuranit, disa popuj i lartëson, kurse disa të tjerë i poshtëron.”*

## **Rreth transmetuesit**

Umeri (r.a.), e përmend hathin në një dialog të zhvilluar me mëkëmbësin e Mekës, Nafi ibn Abdulharis, ku ky i fundit, kishte emëruar një skllav të liruar si përfaqësuesin e tij në Mekë.

Nëpërmjet Kuranit lartësohen ata që e besojnë, veprojnë sipas tij dhe gjithë jetën e tyre e rregullojnë sipas direktivave të tij. Dhe për këtë nderim që i bëjnë Kuranit, Allahu i lartëson në këtë botë, duke u dhuruar një jetë të lumtur dhe në botën tjetër, duke i shpërblyer me xhenet. Kurse ata që nuk e respektojnë Kuranin, Allahu i poshtëron në këtë botë dhe në botën tjetër i pret një poshtërim më i ulët. Siç e konfirmon këtë fakt edhe vetë Kurani: **“Nëpërmjet tij, Ai shumëkënd e lë në humbje e shumëkujt ia ndriçon rrugën e drejtë.”** (El-Bekare, 26) Në shumë ajete të Kuranit jepen shembuj se si janë ndikuar njerëzit prej tij. Allahu në një ajet thotë: **“Ne shpallim nga Kurani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët e që mohuesve keqbërës u shkakton vetëm humbje.”**

Si përfundim, Allahu lartëson atë që e lexon Kuranin dhe me sinqeritet vepron sipas tij, ndërsa atë që e lexon Kuranin për hipokrizi dhe nuk e praktikon, Ai e poshtëron.

Përmendja e këtij hadithi nga Umeri (r.a.), në fund të dialogut përmban një mesazh të rëndësishëm për të gjithë. Shembulli sublim i drejtësisë, Umeri (r.a.), ka dashur të përçonte mendimin se, përmes lidhjes së sinqertë me Kuranin, një person që, deri para pak kohësh ishte një skllav i rëndomtë dhe i pavlerësuar në syrin e njerëzve, arriti pozita mjaft të larta, deri sa të udhëhiqte një popull të tërë. Dhe këtë pozitë e meritojnë të gjithë ata besimtarë, që janë të lidhur fort pas librit të Allahut.

## **Mësimet që nxjerrim nga hadithi:**

1. Çdo përpjekje për të mësuar Kuranin është virtyt.
2. Kush lexon Kuranin dhe e rregullon jetën sipas porosive të tij, Allahu e lartëson.



# Nga lulishita e zemrës

Osman Nuri Topbash



Nga morali shembullor i të dashurve të Allahut

## EDUKATA DHE MIRËSJELLJA

Edukata është një element që e dallon njeriun nga krijesat e tjera. Njeriu fiton vlerë tek Allahu me edukatën, mirësjelljen, delikatesën dhe devotshmërinë e tij. Për këtë arsye, ndër cilësitë e të dashurve të Allahut, edukata dhe mirësjellja gëzojnë një vend të veçantë. Prandaj dhe mistikët e mëdhenj e kanë përkufizuar tasavufin si “moral të bukur dhe edukatë”.

Shah Nakshibendiu (Allahu e mëshiroftë!), i cili u formua me edukatë dhe mirësjellje të veçantë nën kujdesin shpirtëror të të nderuarit Emir Kulal, në vitet e para të mësimeve, për të thyer krenarinë dhe mendjemadhësinë e neftit (egos) të tij dhe për të arritur gjendjen e “hiç”-it përpara Allahut, u ngarkua me detyrën e shërbimit ndaj njerëzve të sëmurë, kafshëve të plagosura dhe me pastrimin e rrugëve. Për gjendjen e tij në atë kohë, ai tregon:

“Shërbeva për një kohë të gjatë në rrugën që më urdhëroi mësuesi im. Egoja ime u bë e atillë, sa që duke ecur, ndaloja në vend përpara çdo krijese të Allahut dhe vazhdoja rrugën vetëm pasi kishte kaluar ajo. Shërbimi im vazhdoi shtatë vjet rresht. Si rezultat i kësaj, fillova të dëgjoja edhe zërat e trishtuar të krijesave që luteshin dhe kërkonin strehim tek Allahu”.

Ja pra, për shpirtat e ndriçuar me urtësi, çdo gjë në univers shfaq dhe tregon fuqinë dhe madhësinë hyjnore. Për të arritur këtë gjendje, është kusht që shpirti të fitojë butësi dhe delikatesë me anë të edukimit shpirtëror dhe të marrë mësim prej shfaqjeve hyjnore, duke u thelluar në urtësi. Kjo, sepse shumë të fshehta nuk mund të konceptohen me mendje, por vetëm me urtësi. Të fshehtat shpirtërore nuk bëhen të qarta pa u thelluar në urtësi.

Edukata është kapitali më i çmuar i një udhëtari që ndodhet në rrugë të Allahut. Njeriu nuk mund të jetë edhe fetar, edhe i paedukuar, sepse thelbi i shpirtit islam në besim, është teuhidi, ndërsa në vepra është

edukata dhe mëshira. Prandaj mund të thuhet se feja islame me të gjitha parimet e veta, fund e krye përbëhet nga mirësjellja, delikatesa dhe pastërtia. Pra, nga “edukata e bukur”. I nderuari Mevlana Xhelaledin Rumi thotë:

“Hapi sytë dhe shih fjalët e Allahut! I gjithë Kurani, ajet për ajet, është mësim edukatë!”

Të dashurit e Allahut i kanë arritur gradat vetëm me edukatën e tyre të lartë. Imam Rabbani thotë:

“Ai që nuk respekton edukatën, nuk mund të përparojë në rrugë të Allahut, pra nuk mund të bëhet mik i Tij. Rruga e të mëdhenjve të fesë, është e gjitha edukatë”.

Edukata më e rëndësishme, është ajo ndaj Allahut Teala, i Cili na ka krijuar.

Nuk duhet të harrojmë se shejtani i mallkuar, nuk u dëbua prej mëshirës së Allahut, për shkak të mungesës së diturisë apo punës, por për shkak të mungesës së edukatës. Pra, shejtanin e shkatërroi virtyti më i mirë, edukata. Mevlana shprehet:

“Kur iblisi kundërshtoi urdhrin e Allahut, duke mos i bërë sexhde Ademit (a.s.), tha:

- Unë jam prej zjarrit, ndërsa ai prej baltës. A i shkon atij që është më lart, t’i bëjë sexhde atij që është më poshtë?”

Ja pra, iblisi u dëbua nga mëshira e Allahut dhe u mallkua, për shkak se iu përgjigj Allahut në një mënyrë të paedukatë. Mbi të gjitha, debatoi me Krijuesin e tij me arrogancë. (Fihi ma fih, faq. 159)

Ebu Ali ed-Dekak (Allahu e mëshiroftë!), thotë:

“Braktisja e edukatës, meriton dëbimin prej mëshirës së Allahut. Kush tregohet i paedukatë para sulltanit, nxirret tek dera e, kush tregohet i paedukatë tek dera, nxirret në ahur”.

Të moçmit thoshnin: "Edukatën mësoje prej të paedukuarit". Kjo është një këshillë, që ne të marrim mësim prej përfundimit të atyre që nuk e respektojnë edukatën. Prandaj edhe ne duhet të marrim mësimin e duhur prej gjendjes në të cilën ra shejtani.

Robi, i cili tregon edukatën e duhur ndaj Allahut Teala, ruhet nga sjelljet e pakontrolluara dhe si rezultat, arrin të vërë re mangësitë dhe gabimet që mund të bëjë në adhurimet dhe veprat e tij. Gjithashtu, atë nuk e kap sëmundja e besimit të tepërt në punët e veta.

Të mos harrojmë se, sado të shumta të jenë punët tona të mira, ato janë vetëm sa një kovë ujë e hedhur në oqean. Prandaj, adhurimet dhe punët tona duhet t'i shohim të pakta përpara mirësive që na ka falur Allahu i Madhëruar. Devotshmërinë tonë nuk duhet ta matim me nivelin më të ulët të shoqërisë, por me nivelin e sahabëve dhe të dashurve të Allahut, sepse Allahu i Madhëruar i ka bërë Ensarët dhe Muhaxhirët shembull për ne.

Ata që e jetojnë edukatën e devotshmërisë në mënyrën e duhur, janë të vetëdijshëm se **të gjitha mirësitë janë prej Allahut, ndërsa të gjitha mangësitë burojnë prej vetes së tyre.**



*"Kapu pas edukatës haptas apo fshehtas qofsh, sepse, nëse dikush tregon mungesë edukate kur është i hapur, merr një dënim të hapur. Por, nëse tregon mungesë edukate kur është në fshehtësi, merr një dënim të fshehtë. Kush humbet edukatën, është larg Allahut, edhe nëse ai kujton se është afër. Gjithashtu, edhe në kujton se është i pranuar, ai është i refuzuar."*

rojë me edukatë ndaj Allahut edhe në shoqëri edhe në vetmi. Mistikët e mëdhenj kanë thënë:

*"Kapu pas edukatës haptas apo fshehtas qofsh, sepse, nëse dikush tregon mungesë edukate kur është i hapur,*

Thënia e dikujt që braktis adhurimet dhe futet në rrugë të keqe **"Ç'të bëj, kë-shtu qenka thënë!"**, është shprehje injorance e nxitur nga shejtani. Ai që dëshiron të falë namaz, Allahu Teala ia bën të mundur të gjitha shkaqet që ai të falet. E nëse nuk dëshiron të falet, pasi t'i jetë bërë e ditur e vërteta, Allahu nuk e pengon atë në zgjedhjen e tij të lirë.

Të shfajësojmë veten tonë për gjynahet që bëjmë, është "shpifje ndaj kaderit (caktimit)", që tregon mendjelehtësi dhe mungesë edukate ndaj Allahut Teala. Kjo është pika ku i rrëshqiti këmba edhe shejtanit, i cili tregoi mungesë edukate ndaj Allahut. Prandaj dhe ajo që e çmend më së tepërmi shejtanin, është pika në të cilën gaboi vetë. Bindja, pranimi dhe dorëzimi që tregon besimtari ndaj Allahut, është **"edukata e besimit"**.

Një nga qëllimet kryesore të tasavufit, është ta ndërgjegjësojë njeriun për "ndjenjën e mirësisë". Ta ndërgjegjësojë atë se është gjithmonë në prezencën e Allahut dhe ta bëjë të vep-

merr një dënim të hapur. Por, nëse tregon mungesë edukate kur është në fshehtësi, merr një dënim të fshehtë. Kush humbet edukatën, është larg Allahut, edhe nëse ai kujton se është afër. Gjithashtu, edhe në kujton se është i pranuar, ai është i refuzuar.” (Ruhu'lBejan, X, 401.)

Prandaj, në vend që të debatohet si shejtani për gjërat që Zoti ynë ka dëshiruar për ne, të ulim kokën menjëherë, të pranojmë, të dorëzohemi dhe të jemi të bindur se ajo është gjëja më e mirë për ne. Kjo është më e rëndësishmja e edukatës së fshehtë.

Një ditë, një prej dijetarëve të hadithit, u kënaq shumë kur pa djaloshin e ri Bejazid Bistamin dhe për t'i matur botëkuptimin dhe zgjuarsinë e pyeti:

-Djalë i mbarë! A di ta falësh namazin?

Bejazid Bistami tha:

-Po, mundem me lejen e Allahut.

-Si?- e pyeti ai.

Bejazid Bistami vazhdoi:

-Them: Urdhëro o Allah. Po qëndroj para teje për të zbatuar urdhrin tënd dhe bëj tek-bir. Lexoj Kuranin në mënyrë të qartë dhe ulem me madhësi në ruku. Ulem me modesti në sexhde dhe përshëndes duke dhënë selam.

Dijetari i mahnitur e pyeti:

-O djalë i zgjuar! Me gjithë këtë botëkuptim të thellë që ke, përse i lejon njerëzit të të përkëdhelin kokën? (Dijetari mendonte se lëvdatat dhe komplimentet do ta çonin në mburrje dhe se ai nuk duhej t'i lejonte këto gjëra.)

Bejazid Bistami iu përgjigj me një urtësi të madhe:

-Ata nuk më përkëdhelin mua, por bukurinë me të cilën më ka zbukuruar Allahu Teala. Si mund t'i pengoj të prekin diçka që nuk më përket?

Ja pra, një pjesë tjetër prej edukatës së devotshmërisë, është të qenët i ndërjegjshëm se të gjitha bukuritë janë prej Allahut dhe të mos ia atribuosh vetes.

Edukata më e madhe është madhështia që tregohet ndaj Allahut Teala. Shfaqja më e bukur e kësaj tregohet gjatë adhurimeve. Të dashurit e Allahut kanë thënë:

“Adhurimet e çojnë njeriun në xhenet. Ndërsa edu-

kata dhe madhështia që tregohet gjatë adhurimeve, e çojnë atë tek Allahu dhe e bëjnë mik me Të.”

Enes bin Malik (r.a.), ka thënë:

“Edukata në vepra, është tregues se ajo vepër është pranuar”.

Hidri (a.s.), ka këshilluar që të bëjmë këtë dua:

“O Allah! Më fal edukatë të bukur, që të jem i devotshëm ndaj Teje”

Të dashurit e Allahut, përveç se zotëronin këtë edukatë të fshehtë, ata gjithmonë kanë jetuar me vetëdijen se ndodhen në prezencën e Allahut. Prandaj, ata i kanë dhënë shumë rëndësi edukatës në shoqëri. Kjo mund të shprehet duke ruajtur të njëjtën gjendje nënshtrimi dhe edukate që tregohet gjatë adhurimeve dhe jashtë tyre. Allahu i Madhëruar ka urdhëruar:

“...e që janë të vazhdueshëm në faljet e tyre” (el-Me'arixh, 23)

“...e që i falin namazet rregullisht.” (el-Me'arixh, 34)

Mevlana i nderuar, duke komentuar këto ajete, thotë:

“Robi e ruan gjendjen e namazit edhe pas tij. Kështu që, e gjithë jeta e tij kalon me nënshtrim dhe edukatë. Gjithashtu, gjuha dhe zemra e tij janë të ruajtura. Kjo është gjendja e të dashuruarve të vërtetë, pra e miqve të Allahut...”

Qëllimi i edukimit shpirtëror është që ta bëjë njeriun të vetëdijshëm se ndodhet gjithmonë nën vëzhgimin e kamerave hyjnore. Në sajë të kësaj vetëdijeje, do të mundësohet që virtytet e larta të njeriut, si mirësjellja, delikatesa, edukata dhe turpi, të bëhen themel i natyrës njerëzore.

I nderuari Davud-i Tai tregon:

“Kam qëndruar njëzet vjet me Ebu Hanifen. Gjatë gjithë kësaj kohe kam vënë re se ai edhe kur ishte vetëm, edhe kur ishte në prezencë të dikujt tjetër, nuk ka qëndruar kurrë me kokë të zbuluar dhe asnjëherë nuk i ka zgjatur këmbët, qoftë edhe për t'i çlodhur. Njëherë e pyeta:

- Ç'të keq ka nëse i zgjat këmbët, kur je i vetmuar?

I nderuari Davud-i Tai tregon:

“Kam qëndruar njëzet vjet me Ebu Hanifen. Gjatë gjithë kësaj kohe kam vënë re se ai edhe kur ishte vetëm, edhe kur ishte në prezencë të dikujt tjetër, nuk ka qëndruar kurrë me kokë të zbuluar dhe asnjëherë nuk i ka zgjatur këmbët, qoftë edhe për t'i çlodhur. Njëherë e pyeta:

- Ç'të keq ka nëse i zgjat këmbët, kur je i vetmuar?



Ai më tha:

- Të tregosh edukatë përpara Allahut të Madhëruar është më e virtytshme.

Edhe i nderuari Mahmud Sami Ramazanoglu nuk është parë kurrë të jetë ulur duke zgjatur këmbët ose të ketë ngrënë, duke qenë i mbështetur diku. Sami Efendi (Allahu e mëshiroftë!), në bisedat e tij shpesh përsëriste këtë bejthe:

### EDUKATA ËSHTË NJË KURORË PREJ DRITËS HYJNORE

Vendose atë kurorë dhe sigurohu nga çdo bela...

Edhe i nderuari Hysejn Efendi prej Samsunit, kaloi një jetë plot edukatë dhe mirësjellje. Vëllai ynë Mustafa Okutan, i cili përgatiti xhenazen e Hysejn Efendiut, tregon një ndodhi që e ka jetuar vetë:

"Kur isha duke larë trupin e Hysejn Efendisë, këmba e djathë i ishte mbështetur në kraharor dhe nuk mundëm t'ia hapnim. Por kur e vendosëm në varr, papritur u kthye në të djathtë".

Padyshim që kjo ishte një ndodhi që na kujton faktin se "Njeriu do të vdesë ashtu siç ka jetuar dhe do të ringjallet ashtu siç ka vdekur". (Munavi, Fejzu'lKadir, V,663.) Allahu i Madhëruar, i shfaq disa të fshehta, në mënyrë të atillë që prej tyre të merret mësim.

Edhe ata që ndodhen në prezencën e një të dashuri të Allahut, nuk sillen të shkujdesur siç sillen kur janë në ndonjë vend apo kohë tjetër. Miqtë e Allahut janë të vetëdijshëm se ndodhen gjithmonë në prezencën e Allahut dhe zotërojnë shpirta të ndriçuar edhe pa pasur nevojë për prova. Pra, ata jetojnë gjithmonë me vetëdijen se ndodhen çdo çast me Allahun: "... **Ai është me ju kudo që të gjendeni...**" (el-Hadid, 4.) Për këtë arsye, edukata e tyre u jep formë të gjitha sjelljeve të tyre.

Kjo është edhe arsyeja që të dashurit e Allahut janë gjithmonë të edukuar, madje edhe kur ndodhen larg syve të njerëzve. Mbulimi i kokës në namaz shpreh respekt për Allahun. Por të dashurit e Allahut, që jetojnë çdo çast në atmosferën e adhurimit, e respektojnë këtë element edhe jashtë namazit.

Kur një prej sahabëve e pyeti Profetin e Allahut (a.s.), se a mund të sillej lirisht në lidhje me veshjen, kur ishte larg syve të njerëzve, i Dërguari i Allahut iu përgjigj:

"Allahu e meriton më shumë se njerëzit që të kihet turp

prej Tij." (Ebu Daud, Hammam, 2/4017.)

Edhe të parët tanë, shpirtat e të cilëve u brumosën me edukatën islame, kanë shfaqur një nivel të lartë edukate, me të cilën kanë mahnitur gjithë botën. Prifti protestant Salomon Schweigger, i cili ishte një fanatik i madh, në sejahatnamen (ditarin e udhëtimit) e tij, kur flet për myslimanët, tregon:

"Myslimanët mbulohen edhe kur hyjnë në hamam. Sa njerëz të edukuar! Edukatën dhe namusin duhet ta mësojmë prej këtyre njerëzve, të cilët i quajmë barbarë." (I. Ortayli, *Osmanliyi Yeniden Kesfetmek*, s. 88.)

Mbulesa është diçka që mund të diskutohet vetëm për njeriun. Për krijesat e tjera as që mund të zihet në gojë. Mbulesa është një edukatë e lindur e devotshmërisë. Ademi (a.s.) dhe gruaja e tij Havaja, u turpëruan nga lakuriqësia e tyre, edhe pse në xhenet nuk kishte njerëz të tjerë. Kjo do të thotë se mbulesa

dhe motivuesit shpirtërorë të saj, edukata dhe turpi, janë prej cilësive rrënjësore që gjenden në natyrën e njeriut.

Edukata që duhet të tregohet në prezencë të Allahut, duhet të tregohet edhe ndaj të gjitha krijesave të tjera, sipas radhës së afërsisë me Të. Pra, pas edukatës që tregohet ndaj Allahut, në radhë të dytë vjen edukata ndaj të Dërguarit të Tij (a.s.).

### EDUKATA NDAJ TË DËRGUARIT TË ALLAHUT (A.S.)

Sahabët e nderuar kanë shfaqur ndjenjën më të lartë të edukatës dhe respektit që duhet treguar ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.). Këtë gjë ata e kanë shprehur në mënyrën më të bukur, duke thënë:

"Sikur mbi kokat tona kishte ndonjë zog dhe, nëse lëviznim, do të ikte". (Shih: EbuDaud, Sunnet, 23-24/4753; Ibn-i Maxhe, Xhenaiz, 37.)

Edukata që tregonin sahabët ndaj Profetit (a.s.), ishte e tillë, saqë (në të shumtën e rasteve) e quanin guxim t'i bëje pyetje (Profetit). Edhe pse ndonjëherë tek Profeti vinte ndonjë bedevi (endacak shkretëtire) dhe bëhej shkak për bisedë, sahabët prisnin gjithmonë me padurim që të përfitonin nga bisedat e Profetit (a.s.).

Edhe ata që gjendeshin vazhdimisht bashkë me Profetin (a.s.), prej edukatës dhe respektit që kishin për të, shumë rrallë e kanë parë fytyrën e tij lirshëm dhe për një kohë të gjatë. Madje, gjatë bisedave që

zhvillonin me Profetin (a.s.), përveç Ebu Bekrit dhe Omerit (radijallahu anhuma), të cilët mund të shkëmbenin shikime me Profetin (a.s.), të gjithë sahabët e tjerë shikonin përballë vetes. (Tirmidhi, Menakib, 16/3668.). Këtë fakt e ka treguar më vonë në fundin e jetës së tij Amr bin As (r.a.), i cili ka kaluar në histori si çlirimtari i Egjiptit:

“Kam qëndruar një kohë të gjatë me Profetin. Mirëpo, për shkak të respektit dhe turpit që kisha ndaj tij, s’kam mundur ta ngre kokën dhe ta shoh fytyrën e tij të ndritur, aq sa të ngopem. Nëse sot do të më kërkonin ta përshkruaja atë, më besoni se nuk do të mundesha.” (Muslim, Iman, 192.)

Edhe ne kërkojmë falje e strehohemi në oqeanin e mëshirës së Allahut ndaj mangësive që mund të tregojmë padashur gjatë përshkrimit të Profetit tonë të dashur (a.s.), me fjalët tona të kufizuara dhe të pamjaftueshme.

Gjithashtu edhe thënia e salavateve, kur përmendet emri i të Dërguarit të Allahut, Muhamedit (a.s.), është prej edukatës së bukur. Në një ajet fisnik, Allahu i Madhëruar urdhëron:

**“Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për të. O besimtarë, lutuni për atë dhe përshëndeteni me “selam!””** (el-Ahzab, 56.)

Megjithëse në Kuranin Kerim profetët e tjerë përmenden me emrat e tyre, Profeti ynë (a.s.), në asnjë ajet nuk është thirrur me emër, p.sh., O Muhamed. Për të gjithmonë është përdorur “O Nebi, O Resul”. Prandaj dhe Allahu i fton të gjithë besimtarët në një edukatë të tillë:

**“Mos ia drejtoni thirrjen të Dërguarit, njësoj si thirrjen që ia bëni njëri-tjetrit!...”** (en-Nur, 63.)

Ibën Abbasi (radijallahu anhuma), në lidhje me ajetin e mësipërm thotë:

“Njerëzit e thërrisnin Profetin (a.s.), “Ja Muhamed ose ej Ebu’lKasëm”. Por Allahu Teala, për të ngritur nderin e të Dërguarit të Tij, i ndaloi ata nga këto thënie. Që nga ajo kohë, njerëzit e thërrisnin Profetin; “Ja Nebijallah ose ja Rasulallah”” (Ebu Nuajm, Delail, I, 46.)

Prandaj, përmendja e Profetit tonë (a.s.), vetëm me emër, bie ndesh me parimet e të qenit umet i tij. Bashkë me emrin e tij, duhet të përmendim edhe cilësi dhe virtyte të larta. Gjithashtu, duhet të tregojmë respekt dhe mirësjellje edhe ndaj çdo gjëje që ka afërsi me Profetin (a.s.).

Javuz Selim Hani, është një prej sulltanëve Osmanllinj, që e ka dashur shumë Profetin (a.s.). Në vitin 1517 çliroi Egjiptin dhe iu la amanet detyra e halifes. Në hutben që u mbajt në xhaminë Melik Muejjed, ditën e xhuma, më 20 shkurt, hatibi, duke folur për Javuz Selim Hanin, tha: **“Hakimu’l-Haramejni’sh-Sherifejn”** (Sundimtari i dy qyteteve të bekuara Meke dhe Medine). Sulltani ndërhyri, duke e ndërprerë hatibin dhe me sy të përлотur, tha:

**“Jo, jo! Hadimu’l-Haramejni’sh-Sherifejn”** (Shërbyesi i dy qyteteve të bekuara).

Më pas, ngriti tapetin dhe, duke bërë sexhde në tokë, falënderoi Allahun. Pastaj, për të shprehur qartë se ishte shërbyesi i dy qyteteve të bekuara, vendosi në çallmën e tij një kreshtë që ngjante si fshesë.

Respekt të madh ndaj qytetit të Profetit (a.s.), ka treguar edhe sulltani dëshmor, Abdulaziz Hani.

Një ditë, kur ishte i shtrirë në shtratin e tij, i sëmure dhe i pafuqishëm, iu tha:

- Ka ardhur një kërkesë prej popullit të Medine-i Muneveres.

Abdulaziz Hani u tha ndihmësve të tij:

- Më ngrini menjëherë! Kërkesat që vijnë prej Haramejnit dua t’i dëgjoj në këmbë! Kërkesat e fqinjëve të Resulullahut nuk dëgjohehen duke zgjatur këmbët

kështu, në mënyrë të paedukatë...

Sa herë që vinte postë prej Medine-i Muneveres, merrte abdest, i puthte letrat, i vinte në ballë dhe thoshte: “Këto kanë pluhur të Medine-i Muneveres!”, pastaj ia zgjaste sekretarit të parë dhe i thoshte: “Hape dhe lexoje!”

## EDUKATA NDAJ MIQVE TË ALLAHUT

Ebu’l -Lejsi (Allahu e mëshiroftë!), pas komentimit të ajetit **“Mos ia drejtoni thirrjen të Dërguarit, njësoj si thirrjen që ia bëni njëri-tjetrit!...”** (en-Nur, 63.), thotë:

“Gjithashtu, nga ky ajet kuptojmë se edhe mësuesit e sinqertë që mësojnë të tjerët me dituri të dobishme, duhen respektuar. Pra, në këtë ajet nënkuptohet se edhe mësuesit dhe njerëzit e virtytshëm duhen respektuar.

Prandaj, kur përmenden njerëzit e dashur të Allahut, duhen përdorur fjalë që tregojnë respekt, në çfarëdo gjuhe qofshin. Kjo, sepse ne jemi të urdhëruar që të mos i thërrasim në emër as baballarët tanë biologjikë.

**“Mos ia drejtoni thirrjen të Dërguarit, njësoj si thirrjen që ia bëni njëri-tjetrit!...”**

Pra, mendoni se sa mungesë edukate do të ishte, nëse do t'i thërrisnim në emër baballarët tanë shpirtërorë!" (Ruhu'l Bejan, VII, 447.)

Për përparimin në rrugën shpirtërore, duhet qëndruar me edukatë e modesti pranë dijetarëve, që njëkohësisht, janë edhe trashëgimtarët e profetëve dhe të të dashurve të Allahut duke ndjekur dhe praktikuar këshillat e tyre. Qëndrimin pranë të dashurve të Allahut dhe marrjen e edukatës prej tyre, duhet t'i shohim si një mirësi e madhe, sepse kush shkon tek ata me edukatë, përfiton shumë prej tyre.

Profeti ynë i dashur (a.s.), thotë:

*"Ruhuni nga urtësia e besimtarit, sepse ai sheh me dritën e Allahut!"* (Tirmidhi, Tefsir, 15.). Paralajmërimi i hadithit, që shprehet me fjalën "Ruhuni!", nënkupton; "Mos shkoni tek besimtarët e përsosur me synime të fshehta dhe me zemër të turbullt! Ata, me një urtësi të veçantë, shohin edhe ato që ju mundoheni t'i fshihni". Për këtë arsye, është thënë: "Pranë dijetarit ruaj gjuhën, pranë evlijasë ruaj zemrën!".

Prandaj duhet treguar një respekt i madh dhe i veçantë ndaj të dashurve të Allahut, të cilët gëzojnë një vend të veçantë në mëshirën e Allahut Teala. Është normë edukate, që në prezencë të tyre të mos flasësh, të mos ulesh dhe ngrihesh pa leje. Të tregosh mungesë edukate, sa të pri-shësh atmosferën shpirtërore, mund të nxisë edhe hidhërimin e Allahut të Madhëruar.

Sulltani i zemrave, Javuz Selim Hani, kur hynte tek ndonjë veli (i dashur i Allahut), tregonte edukatë dhe nuk fliste asnjë fjalë pa qenë nevoja. Njëherë, kur shkoi për vizitë tek i nderuari Muhamed Bedahshi, një nga velitë e mëdhenj të Shamit, nuk foli asnjë fjalë, por vetëm dëgjoi dhe po në atë mënyrë u nda prej tij. Shoqëruesit e tij, shumë të habitur nga kjo gjë, e pyetën:

- O sulltan! Ju vetëm dëgjuat dhe nuk folët asnjë fjalë. Ku qëndron urtësia?

Javuz Selim Hani u përgjigj:

- Nuk është e përshtatshme të flasësh në mexhlisin e të dashurve të Allahut, kur ata janë duke folur, qofsh edhe sundimtar i botës. Edhe pse jemi sulltanë, gjithmonë jemi nevojtarë për urtësitë e këtyre sulltanëve

shpirtërorë. Nëse do ishte nevoja të flisja, ata do të ma kërkonin vetë këtë gjë.

Ja pra, kjo ishte edukata dhe respekti që tregonte Javuz Selim Hani ndaj njerëzve të zemrës. Respektin që ndjente për ta, ai e ka shprehur edhe në një poezi të tijën:

*Të jesh padishahu i gjithë botës,  
diçka pa kuptim,  
Të lidhesh pas një veliu  
më mirë se çdo rrugëtim...*

Edhe pashallarët edhe populli, kanë treguar respekt të veçantë për njerëzit e dashur të Allahut. Kapitenët dhe udhëtarët që udhëtonin me anije përgjatë ngushticës së Bosforit, deri në periudhën e fundit të perandorisë Osmane, këndonin "Fatiha"-në, sa herë

që kalonin pranë varreve të Aziz Mahmud Hudait (Allahu e mëshiroftë!) në Yskydar, Jahja Efendisë në Beshiktash dhe pranë Jushës (a.s.), në Bejkoz. Ky ishte respekti që tregonte njëherë e një kohë populli i Stambollit ndaj velive të mëdhenj që prehen në qytetin e tyre.

Shkurtimisht, edukata është një element që islami ua mëson njerëzve dhe i jep një rëndësi të veçantë. Kjo ndjenjë tregohet ndaj Allahut, Profetit, të dashurve të Allahut, prindërve, besimtarëve dhe të gjitha krijesave me radhë. Pasuria e arit dhe argjendit shkon, por pasuria e edukatës ngelet përgjith-

monë. Prandaj, ne si besimtarë, duhet të mësojmë rregullat e edukatës, duhet t'i mbajmë të gjalla dhe të mundohemi që, duke u bërë shembull, t'ua mësojmë edhe të tjerëve. Për këtë, duhet të lexojmë librat e rregullave të edukatës dhe të mësojmë se si mund ta përmirësojmë veten tonë. Por më e rëndësishme është të shoqërohemi me besimtarë të edukuar e të singertë, që janë si libra të gjallë dhe të përfitojmë prej tyre.

**Allahu na mundësoftë të edukohemi me edukatën e Resulullahut (a.s.), të cilin Vetë Allahu e ka edukuar me edukatën hyjnore! Allahu na bëftë besimtarë të edukuar e të sjellshëm, të cilët përfitojnë prej dijetarëve dhe të dashurve të Allahut.**

**Amin!..**



# KRIZA FINANCIARE GLOBALE: A MUND TË OFROJË NDIHMË FINANCA ISLAME NË ZGJIDHJEN E SAJ?

*Idlir Bekteshi M. B. A.*

## SHKAKU KRYESOR I KRIZËS

Është e pamundur të projektohet një sistem i ri pa u përcaktuar fillimisht shkaku kryesor i krizës. Dihet përgjithësisht se shkaku kryesor i pothuajse të gjitha krizave ka qenë kreditimi masiv dhe i pakujdesshëm nga ana e bankave<sup>1</sup>. Kjo ngre pyetjen: Çfarë i shtyn bankat drejt praktikave të tilla të dëmshme, jo vetëm për sistemin financiar në tërësi, por edhe për interesin e tyre afatgjatë? Tre janë faktorët që e mundësojnë këtë:

1. Mënyra e gabuar e funksionimit të tregut, ku mungon ndarja e fitimit dhe e humbjes mes kredimarrësit e kredidhënësit.

2. Ekspansioni i instrumenteve derivativë veçanërisht i CDS (CDS janë inicialet për Credit Default Swaps, të cilat funksionojnë në këtë formë: një agjenci hyn në marrëveshje me një bankë kundrejt një primi që merr nga kjo e fundit, që në rast të mospagesës së kredive të rimburojës humbjet që banka pëson në raste të tilla).

2. Koncepti "Shumë i madh sa e pamundur për të dështuar", i cili u "garanton" bankave të mëdha që Banka Qendrore do t'u vijë në ndihmë duke i shmangur nga dështimi.

Ndjenja e gënjeshtërt e imunitetit që japin të tre këta faktorë së bashku, ka stimuluar një mënyrë të gabuar veprimi, duke i bërë bankat

<sup>1</sup>. Banka Për rregullime Ndërkombëtare, raporti vjetor 2008

të mos shqyrtojnë me kujdes kërkesat për kredi. Kjo ka çuar në një ekspansion të tepruar të kreditit, ngritje të paarsyeshme të çmimeve të mallrave të ndryshëm dhe një stili jetese përtej asaj çka lejonin mundësitë reale të individëve. Ngopja e tregut që pason këtë fazë, bën që kërkesa për këto mallra të bjerë, duke çuar kështu drejt uljes së shpejtë të çmimeve dhe krizave të borxhit. Jean Claude Trichet, President i Bankës Qendrore Europiane, ka theksuar me të drejtë që "një flluskë është më e mundshme të shpërthejë, kur investohen fonde të marra borxh".

## KRIZA E KREDIVE HIPOTEKORE

Kriza e kredive hipotekore është një shembull tipik i kreditimit të tepruar dhe të pakujdesshëm. Rol të rëndësishëm këtu luajtën "Obligacionet e kolateralizuara me kredi hipotekore". Obligacioni në vetvete është një instrument borxhi, i cili emetohet nga bankat apo institucione të tjera dhe funksionon si vijon: Institucioni që ka nevojë për hua nga publiku, nxjerr në shitje obligacionet, të cilat kanë një vlerë të caktuar të shtypur në një vend të dukshëm që përfaqëson shumën që do t'i paguhet blerësit në datën e maturimit të obligacionit, që quhet vlera nominale. Personat e interesuar

i blejnë obligacionet, duke paguar një çmim më të ulët se vlera nominale dhe në datën e maturimit blerësi paraqitet me obligacionin përkatës për të marrë shumën e barabartë me këtë vlerë. Diferenca mes vlerës nominale dhe çmimit të blerjes së obligacionit përbën fitimin e blerësit të tij. "Obligacionet e kolateralizuara me kredi hipotekore" janë borxhe që banka i merr duke vënë si kolateral kreditë hipotekore të dhëna klientëve. Pra, kolaterali në këtë rast nuk ishte një pasuri reale, por një detyrim i të tretëve, që do të thotë në rast se banka nuk e shlyente obligacionin, debitorët nuk ishin më të detyruar ndaj saj, por ndaj blerësit të këtij obligacioni. Kështu ky i fundit ishte përsëri në situatë pasigurie, pasi edhe probabiliteti i shlyerjes së kredive nuk është 100%. Por në

këto kredi që bankat ofronin si kolateral përfshiheshin edhe kredi, ku probabiliteti i shlyerjes ishte i ulët. Kështu, risku i këtyre kredive kalonte nga banka tek blerësi i obligacioneve dhe, si rezultat i kësaj, bankat filluan t'i japin rëndësi më tepër sasisë sesa cilësisë së kreditimit. Sipas Ben Bernanke, Governor i Rezervës Federale (Bankës Qendrore) të SHBA: "Një pjesë e mirë e kredive gjatë viteve të fundit, është dhënë pa përgjegjësi<sup>2</sup>". Rezultati është që disa banka në SHBA, Britaninë e Madhe, Europë dhe kontinente të tjera falimentuan ose qeveritë përkatëse u detyruan t'i shtetëzojnë apo t'u japin subvencione.

## SISTEMI FINANCIAR ISLAM

Një nga objektivat më të rëndësishme të islamit është vendosja e drejtësisë në shoqërinë njerëzore. Sistemi financiar mund të jetë në gjendje të kontribuojë në këtë aspekt, nëse përveç të qenit i fuqishëm dhe stabil, plotëson edhe dy kushte të tjera që janë:

1. Institucioni financiar duhet të ndajë riskun me debitorin në mënyrë që, në rast dështimi, humbja të mos bjerë e gjitha në kurriz të këtij të fundit. Në këtë kontekst, një nga parimet kryesore të financës islame

është "Pa risk nuk ka fitim". Kjo duhet të stimulojë një disiplinë më të fortë në sistemin financiar, duke i bërë institucionet financiare të vlerësojnë më me kujdes riskun dhe të monitorojnë më efektivisht përdorimin e fondeve nga ana e kredimarrësit. Vlerësimi i dyfishtë i riskut, si nga ana e institucionit financiar, ashtu edhe nga ana e kredimarrësit, injekton më tepër disiplinë në sistem dhe parandalon ekspansionin e tepërt të kredidhënies.

2. Një pjesë e burimeve të institucioneve financiare duhet të vihen në dispozicion të shtresave në nevojë, për të ndihmuar në eliminimin e varfërisë, rritjen e mundësive për punësim dhe vetpunësim, duke zvogëluar kështu hendekun që shkaktohet nga pabarazia në shpërndarjen e të ardhurave. Në këtë kontekst, duhet të merret në konsideratë ajo shtresë e shoqërisë e cila, për shkak të të ardhurave të pamjaftueshme e ka të dyshimtë aftësinë për shlyerje të kredisë. Kjo kategori, e cila përgjithësisht quhet "subprime", rrezikon që për shkaqet e përmendura më sipër, të mbetet pa realizuar synimin e të pasurit të një shtëpie të vetën apo hapjes së një biznesi të vogël.

Një numër vendesh kanë themeluar institucione të veçanta për t'u dhënë kredi sipërmarrësve që vijnë nga shtresat e varfra e të mesme. Megjithëse në shumë raste institucione të tilla kanë qenë mjaft të dobishme, një problem serioz janë normat shumë të larta të financimit që aplikojnë, të cilat arrijnë nivele deri 30% në vit. Kjo u shkakton kredimarrësve vështirësi serioze në shlyerjen e borxhit. Në këtë mënyrë, është e nevojshme që ndaj këtyre shtresave të aplikohet huaja "Qard Hasan", e cila është kredi pa interes ku kredimarrësi paguan përveç kryegjësë, vetëm tarifën e

shërbimit, e cila mbulon shpenzimet administrative që kanë të bëjnë me analizën, përpunimin e të dhënave të kredimarrësit e aspekte të tjera që lidhen me kredinë dhe nuk varet nga shuma dhe afati i shlyerjes së saj.

Për shtresat më të pasura, sugjerohet modeli islam i ndarjes së fitimit ose humbjes mes kredidhënësit dhe debitorit, i cili imponon një monitorim më të kujdesshëm të aktivitetit të këtij të fundit, me qëllim shmangien e përdorimit të kredisë për konsum personal.

Për më tepër, praktika e operacioneve financiare islame eliminon diskriminimin e shtresave që nuk disponojnë prona që të mund të lënë si kolateral. Në vazhdim të kësaj, kredidhënia ndaj personave të arsimuar, megjithëse financiarisht jo të pasur, mund të ketë më tepër përfitim, si për shoqërinë edhe për rritjen ekonomike afatgjatë të një vendi.

Në këtë mënyrë, bankat islame janë, për vetë natyrën e vet, më të ndikuara nga performanca e bizneseve të klientëve të tyre nëpërmjet procesit të ndarjes së fitimit dhe humbjes. Promovimi i këtyre bizneseve do të ishte më i suksesshëm, nëse mbështjetja financiare do të shoqërohej me asistencë teknike dhe konsulencë manaxheriale. Ky bashkëpunim reciprok mes institucioneve financiare islame dhe ndërmarrjeve, do të rriste jo vetëm ndikimin e këtyre institucioneve, por edhe do të stimulonte integrimin e sa më shumë shtresave të shoqërisë, si klasat e varfra e të pasura, prodhuesit e vegjël e të mëdhenj dhe sektorët urbanë e ruralë.

## BIBLIOGRAFI

**Banka për Rregullime Ndërkombëtare (BIS) 2008.** Raporti Vjetor.

**Qendra për Kërkime mbi Ekonominë Islame,** Çështje të krizës financiare ndërkombëtare, të para nga këndvështrimi islam.

[www.blueplanet.eu](http://www.blueplanet.eu)

2. [www.blueplanet.eu](http://www.blueplanet.eu)





Doç. dr. Fahredin Jëlldëz

**I**slami, i cili i shpie njerëzit te e vërteta dhe te e drejta në besim e te mirësia në sjellje është feja e Allahut që e ka predikuar Pejgamberi i fundit, salla-llahu alejhi ve sellem. Kjo fe së cilës i shikohen rezultatet praktike në çdo vend ku praktikohet dhe e cila i drejton njerëzit për te Allahu në mendime e sjellje, "Besimin ndaj Allahut" e pranon si rregullin bazë të jetës. Është shumë e qartë se për të fituar vlerë punët që bëhen, duhet të jenë të lidhura me këtë bazë themelore.

Islami, i cili është një sistem besimi aktiv, siç nuk i shikon të përshtatshme që besimi të ngelë i ngrirë dhe jofunksional, po ashtu nuk pranon edhe veprat, të cilat nuk mbështeten në bazën e besimit. Islami e pranon si detyrë "Bindjen ndaj Allahut" duke synuar sigurimin e shfaqjes së besimit dhe të gjithë lumturinë e ka lidhur me kryerjen e kësaj detyrë në formën më të mirë. Tani le të mundohemi që të kuptojmë konceptin "Bindje" të cilin mund ta quajmë fruti i pemës së besimit që ka hedhur rrënjë në thellësitë e zemrës.

### KUPTIMET DHE PËRKUFIZIMI I FJALËS

Koncepti bindje që në fjalor do të thotë "të nënshtrohesh, të dëgjosh dhe t'i bindesh urdhrat të marrë, në Islam më shumë përdoret në kuptimin që "të zbatosh urdhrat e Allahut".

Ndërsa si një term fetar, bindje do të thotë që "të bësh një punë sipas udhëzimeve të Kuranit e të Sunetit e cila në fund ka sevap". Siç kuptohet edhe nga përkufizimi, bindja shpreh "besimin që do të thotë Tevhid e Islam dhe veprat që duhet të bëhen si domosdoshmëri e këtij besimi".

### FORMA DHE KUFIRI I BINDJES

Kurani urdhëron bindje ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij.<sup>2</sup> Kurani, i cili urdhëron bindjen edhe ndaj "Ulul Emrit" të cilët i dinë, i pranojnë dhe i praktikojnë dispozitat e Islamit, i ka pranuar si bindje kryerjen e veprave që nuk bien ndesh me fenë e Allahut dhe me sunetin e të Dërguarit të Tij. Ndërsa e ka ndaluar kryerjen e veprave që nuk i përshtaten Islamit. Në Kuran dhe sunet është shprehur qartë se njeriu nuk mund ta arrijë botën e lumturisë që përbëhet nga hallallet duke bërë vepra që sipas Islamit janë të ndaluara në mënyrë të qartë. Zoti i Madhëruar e ka shprehur formën dhe masën e bindjes duke thënë: "**Kini frikë nga Allahu dhe bindmuni mua! Mos iu bindni urdhërit të atyre që e teprojnë!**" (Shuara, 150-151) Veçanërisht edhe ky hadith i të Dërguarit të Allahut e shpjegon mjaftueshëm këtë temë.

I Dërguari i Allahut (a.s.) emëroi prijës njërin prej ensarëve në krye të një njësie ushtarake të cilën e kishte dërguar. Komandanti që kryesonte njësinë

ushtarake i urdhëroi ushtarët që të mblidhnin dru, të ndiznin zjarre dhe pastaj të hidheshin në to. Ata i thanë se nuk mund të ketë bindje për një urdhër të tillë dhe për këtë njoftuan të Dërguarin e Allahut. I Dërguari i Allahut (s.a.v.) sipas urdhrit për të cilin u njoftua, tha:

*“Sikur të kishit hyrë në atë zjarr nuk do të dilni më kurrë prej aty. Bindja është vetëm në çështjen e mirësisë.”<sup>4</sup>* Për shkak se bindja është një shprehje reale e dashurisë ndaj Allahut, e fitimit të kënaqësisë dhe e ruajtjes nga zemërimi i Tij siç e pamë edhe më sipër, veprat të cilat nuk e mbartin këtë veçori sipas Islamit nuk pranohen si bindje por si mëkat. Përsëri i Dërguari i Allahut ka theksuar se bindja duhet të jetë për Allahun duke thënë: *“Nuk ka bindje ndaj asnjë krijese në mëkat ndaj Krijuesit.”<sup>5</sup>*

### **BINDJE DO TË THOTË TË JETOSH SIPAS KURANIT DHE SUNETIT**

Sigurimi i një jete të begatë e të privilegjuar me Islamin mund të arrihet duke i menduar fjalët e Kuranit e të sunetit dhe duke i përjetuar ato. Kështu është bërë e qartë se synimi i Allahut nga fjala “Habl” që do të thotë “litar” e që kalon në urdhrin hyjnor **“O ju që keni besuar! Kapuni pas litarit të Allahut dhe mos u përçani!”<sup>6</sup>** është Kurani dhe Suneti.<sup>7</sup> Për këtë arsye Kurani dhe Suneti janë shkaku i udhëzimit dhe i lumturisë njerëzore. Edhe emri i dëgjimit të këtyre urdhrave që transmetohen në këto dy burime dhe i sjelljeve sipas tyre është bindje. Faktikisht dija nga Kurani dhe Suneti kanë si qëllim kryerjen e veprave sipas Kuranit e Sunetit. Islami i pranon si një fantezi teorie mendimet të cilat nuk kthehen në vepra dhe si një shfaqje e pakuptimit punët të cilat nuk mbështeten në besim dhe në Kuran. Kështu, për të fituar një jetesë të qetë duke iu bindur Allahut duhet ta dërgojmë jetën te Islami. Urdhri i mëposhtëm i Kuranit shpreh bukurinë e dërgimit të jetës te Islami dhe se kjo mund të arrihet vetëm me bindje ndaj Allahut dhe ndaj të Dërguarit të Tij:

**“O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe prijësve tuaj. Nëse nuk pajtoheni në donjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo është më e**

**mirë për ju dhe shpjegim më i bukur.”** (en-Nisa, 59)

### **I DËRGUARI I ALLAHUT ËSHTË SHEMBULLI I BINDJES**

Komentimi dhe praktikimi më i saktë i shpalljes është bërë me sunetin e Pejgamberit tonë të dashur për shkak se mësimet e marra nga ai janë ligje hyjnore të Allahut. Ky mësuës i fundit e i vetëm i kësaj bote i ka mbajtur bashkë Librin dhe urtësinë në mësimet e tij. Mësimet e tij që përfshijnë të gjithë jetën duke ndikuar nëpër zemra, mbështetet në faktin “të bësh ato që thua dhe të qëndrosh i lidhur realisht me ato që u mëson të tjerëve”. Ai, me këtë gjendje u bë vetë shembulli i bindjes ndaj Allahut.

I Dërguari i Allahut nuk ishte vetëm një pejgamber që u shpallte njerëzve urdhrat e Allahut, por në të njëjtën kohë ai ishte një udhëzues i përsosur që u mësonte atyre Librin dhe urtësinë, që u shpjegonte ligjet hyjnore, që i përsoste të mangurit dhe që i ftonte në rrugën e bindjes mëkatarët... Ai ishte i Dërguari i Allahut që u kthente shikimin të verbërve dhe që u hapte rrugët e ndriçimit zemrave të errësuar...



Ai është Pejgamberi ynë i cili na shpjegoi ajetet dhe i cili na tregoi se çfarë rëndësie kanë ato në jetën tonë. Ai është njeriu i parë që jetoi sipas Kuranit dhe që tregoi në mënyrë të qartë formën e praktikimit të këtij libri hyjnor... Domethënë se është e pamundur që ta

kuptojmë dhe jetojmë Islamin pa e kthyer vëmendjen tonë drejt sunetit të tij. Vendosja në fushën e praktikimit të një jete e cila parashikohet në Kuran, është e lidhur me ndjekjen e rrugës së Pejgamberit. Ja, Kurani është komentuar dhe praktikuar në një formë të plotë me sunetin ashtu që të veprohet me këtë të vërtetë deri në kiamet.

Së fundi, mund të themi se bindja është një aksion i tillë i mbushur me tevhid dhe sinqeritet i njeriut besimtar. Ajo është përjetim i Islamit sipas parimeve që ka vendosur Kurani dhe i ka shpjeguar suneti.

**Shënimet: 1)** el-Mu'xhemu'l Vasid, (T.V.A')Md. **2)** Al-i Imran, 32, Enfal, 20, Nisa, 59. **3)** Nisa, 59. **4)** Ibn Kethir, Tefsiru'l Kuran'il Adhim, II, 324. **5)** Kurtubi, el-Xhami' li-Ahkami'l Kuran, V, 260. **6)** Al-i Imran, 103. **7)** Texhrid-i Sarih, XII, 401.



# Refleksione rreth krijimtarisë së shkrimtarit

## Teufik Gjylit

### në gjininë e përrallës

# 2

Xhahid Bushati

#### 1.

Libri "Vjollca e kujtimit" shquhet për veçantitë e mënyrës së të rrëfyerit të Teufik Gjylit. Një rrëfim që bart emocion e lirizëm. I strukturuar në shumicën e rasteve mbi modele e skema, të cilat i gjejmë në përrallat tona popullore. Konstatojmë se autori i njeh mirë ato, veçanërisht larminë ndërtimore të tyre, që ka reflektuar pozitivisht në krijimtarinë e tij.

Në aspektet e modelimeve të njëlljohta me përrallat popullore, te krijimet e këtij libri gjejmë **formulat hyrëse**, të cilat "... kanë rolin e sinjaleve të veçanta që tregojnë se nga të folurit e zakonshëm kalohet në rrëfim të organizuar artistik. Sinjalet e tilla kanë funksionin e kapërcyejve (bartësve). Kapërcyesit sinjalizojnë se ekziston nevoja për kalim nga rrafshi i përshkrimit gjuhësor në rrafshin artistik".<sup>1</sup>

Sipas studiuesit Val Cordum, formula "**Ka qenë një herë...**" shënon ekzistencën e një sistemi tradicional..." Një dukuri e tillë lë shenjë jo vetëm në këtë libër, por në krijimtarinë e shkrimtarit.

Disa prej tyre, në mënyrën e vet shprehin marrëdhëniet e komunikimit, praninë e kohës shpeshherë si një nocion abstrakt e pa dimension kohor të zhvillimit të ngjarjes, si:

\*"Jetonte në kohë shumë të vjetra një mbret". ("Përdredhsa")

\*"Rriteshin ndër ato kohë të lashta - si i thonë të vjetrit - gjithë këto lule vathe tejet krenare mbi bisqe të vjetra...". ("Lulevathe")

1. Mustafa, Dr. Myzafer: "Përralla shqiptare" - poetika dhe mitikja, pj - sa: 2. "Formulat hyrëse, formulat e mesit dhe formulat përmblylëse", (Formulat hyrëse) f. 248- 249., Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2003.

\*"Një herë - ndër kohë shumë të lashta - ...". (Lulekur-pna")

\*"Na ishte njëherë një pasanik, i cili kishte shtatë djem e një vajzë të vetme". ("Lavanda")

\*"Na ishte njëherë një shpirt i keq". ("Vjollca e kujtimit")

\*"Motit - në një krahinë - jetonte një vajzë shumë e hieshme". ("Lulesansa")

Studiuesja Dr. M. Mustafa, përveçse flet për modelimet e formulave iniciale, të cilat i gjejmë si më të përdorshme nga autori në përrallat e tij, ajo paraqet hasjen edhe të kësaj tipologjie formulash, si: "Qenka mos na qenka" ose "ishte mos na ishte", të cilat sinjalizojnë për natyrën e artit të përrallës dhe rolin e imagjinatives në të<sup>2</sup>, të cilat janë të pranishme, por më pak të përdorshme nga ana e përrallëtarit.

Po kjo studiuese, flet edhe për katër segmentet që përbëjnë formulat hyrëse, të cilat sipas saj, janë: "koha, hapësira, personazhet dhe të folurit e huaj".<sup>3</sup> Në qoftë se do të ndalemi në funksionin e secilit segment, mendojmë që dukuritë që ata përcjellin, gjejnë vend brenda ligjeve të përcaktuara që ka struktura e përrallës së Gjylit. Kështu: "Koha, ka qenë një herë; hapësira: në një mbretëri ose në një vend; personazhet: Një mbret që kishte tre djem..., etj. Kapërcyesit pra, krijojnë vetëdijen për kohën e largët dhe të pacaktuar dhe personazhet e tipizuara".<sup>4</sup>

Ndërsa te novela-përrallë "Kacimicri" (1954), heroi kryesor i veprës simbolizon njeriun e punës dhe të vullnetit,

2. Po aty, f. 249.

3. Po aty, f. 249.

4. Po aty, f. 249.

njeriun e sakrificës dhe të mirëbërësit. Ai i frymëzon fëmijët për ndërmarrje fisnike, i bën të vegjlit të jenë të fortë, guximtarë, trima, luftëtarë të paepur për çështjen e së drejtës dhe të së mirës.

Te ky krijim poliforma hyrëse ruan të njëjtat tipare dhe funksione si te përrallat popullore, pra kemi të bëjmë me këtë veçori: "Sikurse funksionet që janë elemente konstante të përrallës edhe formulat janë përbërës konstantë që janë të lidhur dhe të kushtëzuar nga teksti i përrallës. Nëse formula hyrëse prezanton personazhin që ka lindur në mënyrë të mrekullishme, atëherë do të pasojë funksioni shkuarja, si pasojë e shkeljes së tabusë"<sup>5</sup>. Mendojmë se kjo lidhje e ky kushtëzim që gjen shprehje në lindjen, prezantimin dhe zhvillimin e figurës së Kacimicrrit përmes bëmave dhe historive të tij, ka të bëjë me elemente të tradicionales që i ruan në vetvete përralla popullore dhe s'mund të bëjë pa to, si dhe zbulohet një nga mënyrat e shumta të komunikimit të saj me lexuesin e vogël. Po sjellim si shembuj: \* "Na ishte njëherë një plak e një plakë". (Kështu fillon vepra e shkrimtarit Teufik Gjyli). Kurse te përralla: "Dhëlpna e argjantë"<sup>6</sup>, "diktojmë": \* "Na ishte një herë një gjuetar."<sup>7</sup>, \* "Një ditë prej ditësh..."<sup>8</sup>.

Disa nga këto modele formulash hyrëse që paraqita më lart e shumë të tjera që gjenden në përrallat e shkrimtarit, janë "shenja" që na tregojnë se kështu fillojnë përrallat tona popullore. Krahas këtij elementi njohës, te Gjyli në të shumtën e rasteve kanë dhe funksionin e mënyrës së prezantimit të personazheve e të rolit që luajnë në përrallë.

Kjo dukuri nuk është vetëm te Gjyli, por te të gjithë shkrimtarët e plejadës së tij, që lëvrojnë gjininë e përrallës e që gjejnë frymëzim e mbështetje te thesari ynë popullor. Kjo është një dukuri që shfaqet në këtë periudhë kohore. Siç thotë studiuesi Rexhep Qosja: "Dukuritë në fjalë, natyrisht në tërësi, mund të mbulohen dhe të shpjegohen me nocionet - pasqyrimi, ideologjizimi, heroizmi..., (ne do të ndalemi) te folklorizimi..."<sup>9</sup>.

## 2.

Novela-përrallë "Dhëlpna e argjentë", në përkatësinë e vlerave që mbart, mendojmë që nuk ka shqyrtimin e duhur nga kritika letrare për fëmijë e të rinj. Ia vlen për të diskutuar edhe një mendim të shprehur në këtë mënyrë: "Në mjaft vepra për fëmijë përrallat nuk shfrytëzohen drejt dhe nuk i përgjigjen aktualitetit. Nuk është aspak aktual ribotimi i përrallës nga "Dhëlpna e argjentë" e Teufik Gjylit, ku na paraqitet një mbret i mirë, por me një vezir të keq. Mbreti që i mirë dhe s'kishte asnjë faj për vuajtjet

5. Po aty, f. 250.

6. Gjyli, Teufik: "Dhëlpna e argjentë" (përrallë), botuar në Almanakun "Shkodra" (Viti I, 1961, Nr.1) f. 119 - 130.

7. Po aty, f. 119.

8. Po aty, f. 119.

9. Qosja, Rexhep: "Tri mënyra të shkrimit shqip", Botimet Toena, Tir - në, 2005, *Hyrje Letërsia shqipe në perspektivën kombëtare*. f. 9.

e popullit. Fajtor për të gjitha që veziri. Me zhdukjen e tij, çdo gjë filloi të shkonte sa më mirë në këtë mbretëri. Ky është morali i fabulës. Me këtë moral nuk mund të jesh dakord. Ai është i dëmshëm për fëmijët tanë. Nuk i mëson të urrejnë deri në fund klasat shfrytëzuese. Po aq të panevojshme janë edhe ato legjendat, të cilat fshehin në vetvete veshjen mistike, jo shkencore, si vihet re kjo p.sh. te "Sheboja" e po këtij autori, e botuar, ashtu si e para, në librin "Tregime të zgjedhura". ... Por shkrimtarët që shkruajnë për fëmijë duhet të kenë shumë kujdes në zgjedhjen e përrallave dhe në përpunimin e tyre. Në radhë të parë duhet parë se sa ato tingëllojnë aktuale, se sa ato i përgjigjen kërkesave aktuale të edukimit të fëmijëve tanë"<sup>10</sup>.

Nuk është e vështirë të kuptosh qëndrimin e studiuesit ndaj këtyre dy krijimeve. Më parë se marrëdhënie me letërsinë, ai (V. K.) ka vendosur marrëdhënie me sistemin e kohës soc-realiste përmes nocionit që studiuesi Rexhep Qosja e emërtonte: **ideologjizmi**<sup>11</sup>. Mbi bazën e kësaj filozofie gjykon, interpreton vlerat dhe moralin e këtyre dy krijimeve.

Në mënyrë sintetike po japim edhe një herë argumentet që shtron studiuesi V. K.:

\*Krijimet nuk i përgjigjen stadi dhe zhvillimit aktual të realitetit.

\*Nuk është aspak aktual ribotimi i këtyre dy krijimeve.

\*Moralin e fabulës "Dhëlpna e argjentë" nuk i përshtatet moralit të realitetit ekzistues.

\*Përralla "Sheboja" ka veshje mistike, jo shkencore.

\*Duhet t'i zgjedhim përrallat popullore dhe mënyrën e përpunimit të tyre.

Në argumentin përfundimtar studiuesi arrin të shprehet kështu: "Nuk i mëson të urrejnë (fëmijët, - nënvizim i im) deri në fund klasat shfrytëzuese." (!?)

Mendojmë se, studiuesi V. K. nuk njeh cilësitë, veçoritë dhe tiparet e këtyre përrallave të shkrimtarit Teufik Gjyli, karakteristikat e kësaj përralle të kultivuar dhe marrëdhëniet e saj me përrallën popullore, në ç'raporte është përkimi dhe përpunimi përrallor.

Tani po zbërthejmë disa tipareve të këtyre dy krijimeve të "gjykuara dhe të analizuar më parë nga studiuesi V. K."

Personazhi kryesor i novelës-përrallë "Dhëlpna e argjentë" është Ko-ko-ja. Për këtë personazh ka një përkujdesje dashurie prej shkrimtari. Një të tillë përkujdesje e pati edhe për Kacamicrrin. Po i përmend, se këto dy personazhe kanë pothuajse të njëjtat plane konceptimi

10. V. K. : "Aktualiteti dhe letërsia për fëmijë dhe të rinj", "Zëri i Rinisë", 22.02. 1967.

11. Qosja, Rexhep: *Tri mënyra të shkrimit shqip*, Botimet Toena, Tir - në, 2005, *Hyrje Letërsia shqipe në perspektivën kombëtare*. f. 9.

e krijimi, si: në ndërtimin arkitekturor të përrallës, në ecejaket çudibërëse të aventurës e bëmave, të skalitjeve të personazheve, etj. Te ky krijim ngjarjet zhvillohet në një largësi më të madhe kohore sesa te "Kacamicrri".

Edhe Ko-ko-ja është një model personazhi i nxjerrë nga visaret e popullit, nga urtësia, zgjuarsia e mençuria e tij. Me të njëjtin imazh është konceptuar e shkruar dhe përkushtimi. Autori thotë që në fillim të krijimit të tij: "Unë kam një shok. Emnin e ka Ko - Ko."

Nocioni i së "moçmes" në përrallë, gjithashtu, është në natyrën krijuese të autorit. Autori-përrallëtar thotë: "...gjyshi i tij ka jetue shumë dhe ka vdekë 103 vjeç. Ko - Ko ka qenë 10 vjeç kur e ka pasë ndëgjue këte përrallë nga gjyshi i tij. Një natë dimni ai ma tregoi mue dhe unë sot po jua rrëfej ashtu si e kam ndëgjue prej goje së tij..."

Teoria e "shtegtimit në brezni" të përrallës, pra brenda një qerthulli, si subjekt, mesazh e personazh, gjithashtu zë vend në krijimtarinë e autorit dhe në rastin konkret, është një refleks nga vetë subjekti i përrallës "Dhëlpna e argjantë", në të cilën gjuetari (babai) vdes që në fillim të ngjarjes, duke i dhënë mundësi të birit "t'i marr hakun", duke realizuar kështu amanetin e, njëkohësisht, duke e bërë protagonist e hero të përrallës, triumfues të së mirës. Nga pikëpamja kohore dhe e viteve të përrallës, prania e djalit si personazh afron kohën dhe vitet (ik nga koha dhe vitet e babait), i bën më të perceptueshme dhe më realiste. Rugën plot peripeci e aventura e shoqëron si një bashkudhëtar edhe përshkrimi, që mendojmë se shërben si "parathënie" dhe "mantel" për personazhet që veprojnë në këtë përrallë të gjatë, e cila edhe kjo nuk përjashtohet nga "injektimi" nga "tharmi" i përrallave tona popullore, ku struktura, mesazhi dhe filozofia nuk janë vështirë të mos duken.

Duke iu sjellë edhe një herë sintagmës që përmend studiuesi: "... **ku na paraqitet një mbret i mirë, por me një vezir të keq**", novela-përrallë nuk i ka këto dy personazhe protagonistë dhe ngjarjet nuk sillen rreth tyre.

Këto personazhe, për mënyrën se si zënë vend në këtë krijim, si zërthehen e shtjellohen artistikisht, përcjellin një moral të shëndoshë, i cili lidhet me konceptet estetike dhe formimin kulturor të shkrimtarit Teufik Gjyli.

Ndërsa përralla "Sheboja" nuk ka veshje mistike. Fund e krye është një keqinterpretim i studiuesit V.K. Kjo përrallë zë vend si motrat e saj tek zhanri i përrallës floreale, ku autori i këtyre radhëve ka folur gjatë në këtë shkrim dhe i ka bërë një analizë të plotë.

### 3.

Një veçori e krijimtarisë fabulistike të Teufik Gjylit është edhe lëvrimi i përrallës floreale, i cili përqendrohet brenda një fushe veprimi dhe i përgjigjet një personazhi-lule. Brenda kësaj fushe mësojmë ndodhinë apo historinë e këtij personazhi-lule.

Historitë magjepsëse të luleve, të mbledhura në simbolikën e gjetur të librit e, që aq bukur i rrëfen autori janë të lidhura drejtpërsëdrejti me personazhet, të cilët, për ngarkesën që mbartin në përrallë dhe mënyrën si e mbartin atë, krijojnë disa funksione sipas këtij klasifikimi, që nga ana tipologjike i mbart dhe përralla popullore.

\*Funksioni i dhënësit të lajmit ose të parashikuesit.

\*Funksioni dëshmues ose i dëshmitarit.

\*Funksioni i bartësit total ose të pjesshëm të ngjarjes.

\*Funksioni përjetësues.

Funksioni i dhënësit të lajmit ose të parashikuesit në legjendën "Përdredhsa" realizohet nëpërmjet personazhit të ndërmjetëm, siç është plaka. Ajo është nyja lidhëse në mes historisë tragjike të çiftit mbretëror që nuk kishte fëmijë, me ndodhinë përfundimtare, por tragjike të vajzës që erdhi në jetë e që vdiq pas shtatë vjetësh. Momenti i fundit është perceptuar me ngjyra legjendare e tone lirike. Ky rrafsh ruhet edhe kur shfaqet në mënyrë të papritur shpirtëzimi i lule përdredhses. Në këtë rast ajo mbart edhe funksionin e përjetësisë në historinë e vajzës së vogël. Po i njëjti perceptim ndodh respektivisht te Lulemullaga e te Lule Kalthi. Te e para, ajo lind nga lotët përvëluese të nënës, e cila humb birin e saj; te e dyta, ajo lind kur nëna ndjen rahanë e bijve të saj. Zakonisht në këto legjenda e në disa të tjera, funksioni i përjetësisë shërben si kurorë përmbyllëse e krijimit. Këto krijime kanë të përbashkët edhe të njëjtin ndërtim kompozicional.

Në qoftë se te "Përdredhsa" plaka (personazhi i ndërmjetëm) rrit intrigën në fabul, te "Lulezana" kaprolli bëhet "çelës" për zhvillimin e mëtejshëm të ngjarjes. Po te kjo përrallë, Zana e më pas Lulezana (shfaqje të elementit mitologjik) si personazh kryesor mbart ngjarjen e vetvetes, që zhvillohet në një qytet nënujor. Personazhi (Zana) shndërrohet nga një krijesë reale në ireale (lulezanë), por pa humbur njësinë e vendndodhjes si element real: një lule që rritet pranë bregut të liqenit. Ndryshe ndodh me figurën e floçkës te "Zojëmirana". Gjatë gjithë rrëfimit të ngjarjes, edhe atëherë kur humb emrin e vërtetë, autori procedon që nga fillimi deri në fund duke ruajtur një plan: atë ireal. Në këtë rast, aroma e legjendës është më e ndjeshme dhe dukuria e saj është më e pranishme. Mjafton të kujtojmë këtë copëz pasazhi: "Kur ai zbriti në vendin tek i cili pa të amen, s'e gjeti ma, pse motrat, trupin e saj të vdekun e kishin marrë me vete për ta varrosë në fund të detit. Vetëm një bimë me gjethe të vegjël mbiu aty dhe Urani i shkretë, në të, ndiente erën e së amës.

Në atë çast mandej, që gjindja u mblodhën për të pa, se ç'që ajo britëm, gjetën djalin që kishte rrokë lulen me gjethe të vegjël e me lulza të imta e të bardha e qante gjithnjë tue thirrë të amen. Më mbrapa, atë lule e thirrën: Zojëmiranë".

Në disa legjenda dhe përralla, autori zgjedh një mënyrë tjetër për të komunikuar me lexuesin. Që në hyrje e njeh me personazhin. Karakteri i tij zërthehet gjatë rrjedhës së ngjarjeve, e njëkohësisht është bartës i saj. E vërejmë

me zanën te "Lulezana", me vajzën te "Lavanda". Këto personazhe shquhen edhe për një veçori tjetër. Ata nuk janë të vetmit bartës të ngjarjes: në këtë rrjedhë lëvizin edhe personazhe të tjerë që, me veprimet e tyre janë në funksion të personazhit kryesor. Kështu ndodh me vëllain e vogël që mposht rreziqet që i kanosen, vetëm që të realizojë dëshirën e qëllimin e motrës.

Personazheve-lule shkrimtari Teufik Gjyli u ka dhënë edhe fusha të tjera veprimi. Ato nuk kanë funksionin dëshmues, por janë pjesë aktive në zgjidhjen e shumë momenteve të vështira, që u paraqiten personazheve të tjerë. Kështu Lulekumbona u vjen në ndihmë dy vajzave të vogla për të gjetur udhën, të cilën e kanë humbur. Ndërsa Lulengishtëza i vjen në ndihmë Miços, që të punojë e të mos jetë dembel në jetë.

Një veçori tjetër është se, legjendat dhe gojëdhënat, me ngjarjet që trajtojnë, me mënyrën se si zgjidhen, karakteristika e stilit me të cilin shkruhen, na kujtojnë baladat popullore, imazhin dhe parafytyrën e tyre.

Lule borziloku bëhet simbol shpëtimi. Ajo ndihmon djalin për të mos rënë në fund të greminës. Kurse Lule jasmina me bukuritë e saj, bëhet urë pajtimi mes zemrave të qytetit të Kështjellës së Bardhë. Te këto dy krijime, ndërtimi dhe ngjyrimi figurativ përkon me natyrën e baladës, më konkretisht të Baladës së rinjohjes.

Personazhet-lule, që përgjithësisht mbartin ngjarjen kryesore, brenda fushës së veprimit, ballafaqohen dhe ndeshen me figurën e shtrigës, simbol i së keqes.

Kjo figurë, e ka një mënyrë se si vjen në përrallën e Teufik Gjylit. Një e folur dhe lëvizje dredharake, po me këtë status dialogon edhe me personazhet e tjerë. Arsytimi, fjalori i përzgjedhur, mendësia, atmosfera që e rrethon, etj., e bëjnë këtë figurë të jetë krijim larg traditacional, që jemi mësuar ta vizatojmë e ta shikojmë. Por gjithsesi, autori nuk mund t'i largohet ngjyrimin të portretit të jashtëm, të cilin pothuajse të njëjtë e kanë të theksuar ato përralla popullore, ku shtriga është personazh i pranishëm. Mjafton të kujtojmë këtë fragment: "...një grue me një fytyrë të verdhë porsë të vdekuarve e të shemtueme, me flokë të lëshueme e të ngatruem, që dilte prej një çufre". ("Lulekrupna")

Te kjo përrallë, pikësnyimi dhe qëllimi i Shtrigës është të eliminojë zanën. Këtu, brenda fushës së veprimit që ka përralla, autori i jep më shumë fushëveprimi dhuratë-dhënësit, që është zana. Për të shprehur triumfin e zanës, autori me mjeshtëri e fuqizon atë si personazh, nëpërmjet ngarkesës që depoziton te ajo mjete dhe fuqia mitike. Teufik Gjyli në këtë përrallë thotë: "...kishte me vete të drejtën e fuqinë e një hyjneshe, që për të kishte qenë shërbëtorja ruajtëse e feminisë".

Për rrjedhojë, zana triumfon mbi shtrigën, dhe autori përsërit, si në shumë përralla të tij, modulën: E mira mund të keqen. Autori në fund të përrallës rikonfirmon triumfin në këtë mënyrë: "E tash, sa herë që boçet e lulekrupnës

janë në lulëzim e sipër, gjithnji shihen tue u përkundë në ajri zylyfet e shtrigës smirëzezë".

Këtu vëmë re edhe dy elementë të tjerë, me të cilët operon autori: \*) lënia e personazhit pa emër dhe \*) ndërtimi i sintagmës me një plotëri e thellësi të së keqes edhe si kategori estetike: shtrigë smirëzezë!

Në këtë përrallë (e në shumë të tjera) shohim të realizuar dukurinë që ka vërejtur në këtë gjini studiuesja Dr. Myzaferre Mustafa, e cila thotë: "E mira dhe e keqja mishërohen në personazhe të caktuara dhe në veprimet e tyre, ashtu siç janë të pranishëm e mira dhe e keqja çdo herë në jetë, ndërsa paradispozitat për njëërën dhe tjetërën janë të pranishme në secilin njeri"<sup>12</sup>.

Në legjendat, përrallat e kallëzimet e tij, (ku ka edhe motive me qendëzim magjik e mitologjik), Teufik Gjyli shfaqet një krijues lirik. Lulet-personazhe me historinë e tyre që rrëfyen, mbeten një tufë "vjollcash kujtimi" në kujtesën e lexuesve të vegjël. Dhe kjo është meritë e shkrimtarit Teufik Gjyli, që "... përrallat... (të) ruajnë bukurinë, që u jep gjuha e krehur dhe përshkrimet tërheqëse"<sup>13</sup>.

Prof. Vehbi Bala thekson: "Proza tregimtare e shkrimtarit Teufik Gjyli dallohet për stilin e rrjedhshëm, për paraqitjen tërheqëse të viseve, njerëzve, kafshëve dhe bimëve, për ndjenjën e ngrohtë, me të cilën ai u rrëfen fëmijëve"<sup>14</sup>. Ai përdori në raporte të caktuara e të drejta elementet fantastike që ia dhuroi tradita, por kurrë s'e humbi vështrimin në temën aktuale. Ndaj dhe kjo është arsyeja që, së bashku me shkrimtarët Spiro Çomora, Qamil Guranjaku, Drago Siliqi, Zihni Sako, Bedri Dedja, Vehbi Bala, etj., solli në letërsinë shqipe për fëmijë e të rinj mjaft elemente të reja. Kur themi elemente të reja kemi paarsysh se ai e zhveshi përrallën nga koncepti i vjetër dhe e veshi me interpretim të ri. Kjo është arsyeja që legjendat e luleve kanë në themel rrëfime e përshkrime të një bukurie të rrallë, që shpirtëzon e frymon përjetësisht vendlindjen e të parëve e vendlindjen e poetit, që shpirtëzon dhe frymon përjetësisht amanetin dhe testamentin artistik të shkrimtarit.

Si përfundim themi: Shkrimtari Teufik Gjyli na dha një model përralle. Ndikimi i përrallës popullore në përrallën e Teufik Gjylit shfaqet në dy drejtime: a) "... në mënyrën e trajtimit të fabulës dhe subjektit, (si dhe) në rrjedhën kompozicionale, ..., veçanërisht në tipin e figuracionit dhe detajet poetike, në qartësinë dhe forcën komunikuese të mjeteve shprehëse."<sup>15</sup> dhe b) në "një brendi realiste, (me) një shpirt të dukshëm popullor..."<sup>16</sup>

12. Mustafa, Dr. Myzaferre: "Përralla shqiptare" -poetika dhe mitikja, fq. 35, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2003.

13. Çadri, As. Dr. Ramazan: "Lindja dhe formimi i Letërsisë shqipe për fëmijë", SH.B. Redona, Tiranë, 2009, 1.1. Fillimet e përrallës së re, faqe 111.

14. Bala, Vehbi:

15. Kallulli, Adriatik: "Poezia jonë për fëmijë dhe folklori" faqe 116; nga libri: "Probleme të traditës dhe të aktualitetit në letërsinë tonë për fëmijë", Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1976.

16. po aty, faqe 118.



# Të jetosh me të vërtetën

*Nuredin Nazarko*

**N**jeriu si qenie, vjen në ekzistencë në këtë botë me padëshirën e tij. Nuk është qenia njerëzore që zgjedh karakteristikat fizike apo anatomike për vetveten. Madje i duhet ta pranojë veten me përmasat që zhvillohet qysh nga ngjizja e deri në vdekje. Përgjatë rritjes, qenia njerëzore ndryshon jo vetëm në përmasa, por edhe në perceptimin ndaj botës që e rrethon. Me zhvillimin e tij fizik dhe mendor, njeriu vetëdijësohet se ecën drejt fundit të pashmangshëm, fund prej të cilit askush nuk ka mundur të shmanget, në një stad të caktuar të jetës. Në varësi të konsideratës së qenies njerëzore për të qenit në botë, modelohen mendimet dhe veprimet e njeriut përgjatë jetës. Qenia njerëzore është përpjekur vazhdimisht për të kuptuar kuptimësinë e të qenit në botë, kuptim që do ta çlironte nga jo pak dilema dhe shqetësime për realitetin e jetës dhe vdekjes. Sidoqoftë, ne kemi një jetë për të jetuar përmbi dhe në këtë botë dhe kjo është e pashmangshme. Njeriu përpiqet të njohë realitetin me të cilin dhe në të cilin jeton. Shpeshherë njohjen e tij për realitetin, e bazon mbi perceptimin shqisor, duke besuar se ekziston vetëm ajo çfarë ai arrin të perceptojë nëpërmjet shqisave.

Ndërkaq, mosnjohjen nëpërmjet shqisave do ta përkufizojë si të dyshimtë dhe të pasigurtë, duke gjykuar se ajo çfarë nuk perceptohet ose është ose nuk është, duke qenë më pranë mosqenies sesa qenies. Duke iu

referuar vetëm kësaj lloji njohjeje, të cilën nuk është se e mohojmë dhe e kosiderojmë të pavlefshme, qenia njerëzore nuk mund të përplotësojë dhe zhbëjë habitin për realitetin metafizik dhe transhental, realitet që shqetëson njeriun dhe kërkon të jetë i pranishëm dhe jo i mosnjohshëm tek qenia njerëzore.

Qenia njerëzore natyrshëm shqetësohet dhe pyet se çfarë do të thotë të ekzistosh, përderisa ekzistenca është një fakt që nuk mund ta mohojmë. Qenies njerëzore i duhet që në jetën përmbi dhe në këtë botë, të përballet me vështirësi dhe sfida, shqetësime dhe probleme, i duhet të durojë në vuajtje dhe gëzime, të marrë apo jo vendime. E meqënëse vdekja është e pashmangshme për njeriun dhe ai është qenie për të vdekur, atëherë duhet të jetë i përgatitur për të duruar deri në vdekje.

Në këtë kuptim, ai që ekziston është vetëm njeriu. *“Vetëm ai ekziston. Janë shkëmbinjtë, por ata nuk ekzistojnë. Janë pemët, por ato nuk ekzistojnë. Janë kuajt, por ata nuk ekzistojnë. Janë engjëjt, por ata nuk ekzistojnë. Është Zoti, por ai nuk ekziston. Megjithatë, pohimi që “vetëm njeriu ekziston”, nuk do të thotë në asnjë mënyrë se vetëm njeriu është qenie reale dhe të gjitha qeniet e tjera janë joreale dhe thjesht dukje ose ide njerëzore.”<sup>1</sup>*

Kësisoj, ekzistencë do të thotë përgjegjshmëri, për-

1. Heidegger, M. (2003) *Leksione dhe konferenca*. Tiranë: Plejad, f. 57-58.

gjegjshmëri për mënyrën se si e jeton jetën deri në vdekje dhe vetëm njeriu pyetet se si e realizoi këtë përgjegjësi, prandaj vetëm ai ekziston.

Ekzistenca e kuptuar në këtë kuptimësi, na vetëdijëson për statusin që na është dhënë si qenie njerëzore dhe përmbushja e statusit shtrohet si domosdoshmëri për përmbushjen dhe përplotësimin e njeriut si njeri. Por a mund ta përmbushë statusin e tij me shmangien ndaj realitetit metafizik dhe transhental dhe këputjen e lidhjes me këtë realitet që e rrethon pandalshëm përçdoanshëm, aq sa nuk ka lëvizje që kryen e të mos përballet me këtë realitet? Kudo që të kthehet dhe të hedhë vështrimin, çfarëdo që të marrë në shqyrtim dhe studim, do të gjejë vetëm shenja të një pranije tejnjerëzore, shenja që i japin të kuptojë se ai nuk mund të jetojë i ndarë dhe i shkëputur nga realiteti në të cilin ekziston.

E ajo çfarë duhet njohur dhe kuptuar prej këtyre shenjave, është fakti që ne nuk mund ta zhbëjmë praninë e realitetit tejshqisor. Kësisoj ose do ta hapim zemrën për të pranuar, me një pranim të pranuar, praninë e të pranishmes me mosfshehjen dhe misterin e vet, ose do të zhvetëdijësohemi për realitetin e ekzistencës sonë, duke e harruar dhe hedhur tej faktin e të qenit në botë.

Por, edhe pse mund ta harrojmë apo hedhim tej faktin e të qenit në botë, prania e realitetit tejnjerëzor në jetën e qenies njerëzore nuk mund të zhbëhet, e në qoftë se qenia njerëzore beson se mund ta zhbëjë, nuk ka arritur asgjë më shumë sesa vetëmashtrimin, pasi qysh në momentin që hidhemi në ekzistencë, nuk mund ta anashkalojmë përgjegjësinë që buron nga statusi i të qenit qenie njerëzore, madje edhe atëherë kur besohet se nuk jemi më shumë sesa shtazë e evoluar. Prania e tejnjerëzores në jetën njerëzore, është e vërteta e pamohueshme, së cilës nuk mund t'i shmangemi. Kjo prani është manifestim, shfaqje e të njohshmes dhe të panjohshmes, të dukshmes dhe të padukshmes.

Ne duhet të përpiqemi që të arrijmë të njohim të vërtetën e përfshirjes, prezencës së Qenies tek natyra njerëzore, pra të arrijmë të kuptojmë dhe ne nuk do të

arrijmë të kuptojmë, në qoftë se nuk mendojmë dhe nuk do të jemi në udhën e të menduarit, përderisa nuk mendojmë mbi thelbin e së vërtetës, që është e vërteta e Thelbit. Fakti që ne mund të mendojmë mbi të vërtetën e Thelbit, nuk na jep të drejtën për të konkluduar se mund ta rrokim të vërtetën në tërësishtëmërinë e saj, përkundrazi ne do ta rrokim të vërtetën në atë masë, sa vetë ka dashur të njihet apo të mos njihet, të shfaqet apo të mos shfaqet, të jetë prezent apo të jetë i fshehur, të jetë i dukshëm apo i padukshëm.

Arritja në këtë pikë përmes mendimit, do të na bëjë të kuptojmë përse ekzistojmë dhe, për më tepër, t'i përgjigjemi pyetjes si duhet të jetojmë në përputhje me atë çfarë kemi kuptuar. Pavarësisht pranisë së shenjave dhe inteligjencës së njeriut për të shuar habinë

përmes hulumtimit, kuptimi nuk mund të përplotësohet vetëm se duke menduar mbi zbuluesin si revelatë. Të menduarit mbi zbuluesin është i pashmangshëm, sepse zbuluesi është gjithpërfshirësja e shenjave që na udhëzojnë drejt kuptimësisë dhe zbërthimit të realitetit në të cilin gjendemi dhe me të cilin jetojmë. Çasti në të cilin arrijmë të kuptojmë, është çasti në të cilin kemi vendosur lidhjen me të vërtetën e prezencës dhe përfshirjes së Qenies tek qenia njerëzore. Kjo lidhje është qenësore tek qenia njerëzore, është ekuilibrujesja dhe dritësuesja e saj për të veshtuar

dhe soditur realitetin në këtillesinë e tij. Dritësimi e vendos njeriun në pozitën e të shqyrtuarit dhe të analizuarit të rrjedhës së jetës me vështrimin nga lartposhtë dhe jo anasjelltas.

Ky vështrim i rrjedhës së jetës është mëse i natyreshëm, përderisa drita që buron nga lidhja në kuptimin që përmendëm, shpërhapet dhe ndriçon qenien njerëzore, duke e vetëdijësuar, qetësuar, me një qetësi të pazakontë, jo vetëm për kohën që jetojmë dhe duke forcuar për hapërimin drejt dritës që dritëson. Qenia njerëzore e kapur në këtë lidhje, shqetësohet, vepron për përmbushjen e statusit dhe përgatitet për momentin kur para saj do të manifestohet ajo çfarë kishte qëndruar e fshehur dhe e pazbuluar nga perceptimi në përkohësi.





## Tefsiri i Surei qentherit



### SEBEBI I ZBRITJES:

Thuhet se disa qesenditare prej kurrejshit si Asi bir Vailit, Akabe bir i Maitit dhe Abu-Lehbi e tjer si shoqet e tyne, kur po e shifnin Pejgamberin qi çunat i vdisnin thojshin: Muhamed Mustafaj ngili Ebter, d.m.th. mbasi atij s'po i ngel mashkull me i a kujtu emnin e tij mbeti Ebter".

Kete vdekjen e bijvet e quanin si nji te mete edhe me kesi fjalesh donin me e merzit boten qe te mos i beheshin tobi (ndjekes) hazreti Pejngambetit.

Kur shifshin se myslimanet ndotheshin te dobet e pakice tallshin tye then se Myslimanija po t'ish nji fe e vertete duhesh me dal bashke me nji pasuni te madhe dhe me nji force te pergjithshme.

Keshtu pra dhe mynafiket (dygjuhsit) kur ndigjojshin kesi fjalesh prej vedhazervet adolater te tyne -me qene se fene e kishin per cipe -u behesh qefi edhe disheronin ardhjen e nji rreziku te shpejte per myslimanizmen, se me te vertete Myslimanismi ahere ndollej ne varferi edhe ne dobeti.

Zoti me madhesine e vet me anen e kesaj

suces deshi me e forcuar kurajon myslimanevet edhe deshi me i poshtenu mentimet e kota te myshriqvet tu e thane se fjalet Pejgamberit (Alejselam) jan te verteta, feja e tij ka me mbretnu, emni i tij s'ka me u haru po armiket e tij jane me u damtu e me u fik .

Kjo sure permban treajete .Me te paren ajet zoti urdheron: (...). I dashtuni im Muhamed! Me madhesine t'eme, me te vertete te kam fal Qevtherin (shumicen e teper).

Armiket te fese se fese vertete pandehin se ti je ebter, je i paket e me nji rreth te pa - fuqishem edhe si nuk mbeti mashkullor kujtojme se s'ka me t'u kujtu emni i-yt, por i dashtuni im nuk eshte si thon ata, se une te kam shumicen e teper te miresive e te mbarsive.

I dashtuni im (Muhamed! Mos u sekelldis se thone myshriqet per ty qi gjoja ngele mbetur (miresi - preme dhe emen - haru). Jo jo, ti kurre s'ke me ngel ebter. Ty te kam fal dhurimet e teperta e fort te shumeta sado qi mendje - shkurtit i qofshin te pakta edhe tallen. Muhamed!

E ku ka hajer ma i tepert e ma i shumet se hidajeti (udhedrejt-terheqja)? Ata pandehin se profetesia duhet te vije bashke me pasunin edhe me fuqin, por nuk eshte ashtu, se udhedrejt - terheqja asht mburimi i fuqise, kry e mallezia e themel i lamtunis.

Se nji pasuni a fuqi qi vjen pa hidajet s'ka jete Pra mos u deshperu perdolloju se ty te kam fal miresite e shumta te kesaj e t'asaj jete .

Emni i - yt qysh mbeteti harushem kurse shoket e gjyrme - djekesit e tu kane me ardh me miljon e me miljar gjer ne kjamet;

Sheriati i yt tevhidi (njitimi ) qe prune ti profetsia jote, driten e zemres t'ate, ditunia e filozofia myslimane, shpirtnalesi e zemres -bardhesija t'ate, bukur vetijet e tua, miresjelljet t'ate shpitnare kane me mbretnu qer

ne kijamet, gjith bota ka me u ba gjurme - ndjeksi i moralit tend, ehli - bejti t'at s'ka me u afru e keshtu emni yt i nalt prej gjithbotes ka me u shejteru.

N' ajetin e dyt urdheron (...) kurse te fala shumicen teper te gjith miresive e mbarsive qi nuk kam as ane, falja pra zotit tant e edhe vetem per kenagjesine e t'yt zoti ther kurban se vetem ay te ka fal gjith keto lumtesi.

N' ajetin e tret te urdheron (...). Vertet mos -dashtesi i yt, armiku shpirt keqi edhe talesi zemer ligu tend asht Ebter, ajy eshte mirsiprem dhe emen shumun.

Myshriqet e arabise nuk ishin armiku i turpit te Pejgamberit, se po na itregon historja se sa shume e dojshim para profeterise. Por ata ishin armiku i rruges te sakte e te vertete qi u pruni.

Pra talleshin me urdhen te vertete qe u tregonte te cilen sja u kishte kenda se ata qene mbyttun rd'ersinet t' injorances edhe keshtu ata e dishin fort mire se pas vdekjes se tyne nuk kish se qysh t'u permendet emir i tyne. Si-kurse shumica e tyne si Asi, Abuxhehli (Abu -lehebi e te tjeret po kujtohen me mallkim e te tjert s'kujtohen fare.

Mirpo Muhamed Mustafaja (alejselam) po kujtohet e po shenjterohet prej milijasesh njeres.

Meret vesht sheshazi se nji njeri po s'la nje shenje te hajrit ka vdek per jete Zot!

Terhiqna ne ruget te mbare e te vertete te Hz Pejgamberit !

Amin!

Zoti e di ma mire kuptimin e fjales se vet .

A. J.

Nr, 4, Vit' i I, fq.99-104

## Zoti të pret të pendobesh, kurse ti refuzon?!

**C**farëdo të ketë bërë njeriu, sado të mëdha të jenë gjynahet, sado të rënda të jenë veprat e liga që ka kryer, nëse ai pendohet dhe kërkon falje prej Zotit, Ai e pranon dhe e fal. Allahu (xh.sh.), thotë: **“O robërit e Mi, që e keni ngarkuar veten me shumë gjynahe, mos e këpusni shpresën nga mëshira e Allahut. Ai i fal të gjitha gjynahet, sepse është Falës dhe Mëshirues.”** (Zumer, 53.)

Sahabët e Pejgamberit (a.s.), kanë thënë: “I dërguari i Allahut (a.s.), nuk është gëzuar me asnjë ajet tjetër, sa është gëzuar kur iu shpall ky ajet.”

Ky ajet është shumë shpresëdhënës dhe shërben si fasha dhe ilaçi për shërimin e plagës. Ky na mëson se, sado të ketë gjynahe, sado i mbytur në gjynahe qoftë, sido të ketë humbur..., nëse i drejtohet Allahut dhe i thotë: “O Zot, pendohem!”, Ai e pranon dhe e fal njeriun.

Shpresëdhënës për këtë fakt janë vetë fjalët: “O robërit e Mi...!”, megjithëse mund t’u drejtohej me fjalët: “O gjynahqarë!”. Shpresëdhënës janë edhe fjalët: “...Që e keni ngarkuar veten me shumë gjynahe.” Ai nuk i përmend gjynahet që kanë bërë... dhe këtë e bën me qëllim që të mos prekë ndjenjat e askujt.

Çdo kompani dhe institucion ka rregullat dhe normat e tij. Nëse dikush bën diçka në kundër-

shtim me normat dhe rregulloren, fillimisht i tërhiqet vërejtja, paralajmërohet me largim nga puna dhe, nëse vazhdon, atëherë largohet nga puna. Ndërsa Allahu (xh.sh.), nuk largon askënd. Nuk ka gjë që të mban larg mëshirës së Zotit, pasi një nga cilësitë dhe emrat e Tij është emri Et-Tevvab (Pranues i pendimit).

Vetëm në suren Et-Tevbe pendimi përmendet 17 herë.

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Allahu gëzohet për pendimin e robit të Tij më shumë se sa gëzohet njeriu në mes të shkretëtirës që gjen devenë e humbur, në të cilën ka ushqimin e tij”. **(Buhari, Muslimi)**. Pejgamberi (a.s.), thotë:

“Çdo bir i Ademit është gabues, por më i miri prej tyre është ai i cili pendohet.” **(Tirmidhi, Ibn Maxhe, Ahmedi, Hakimi, Albani e ka bërë hadithin sahih)**.

Pendimi ka tre kushte:

1. Të pendohesh dhe të bëhesh pishman për ato që ke bërë.
2. Të largohesh nga ato gjynahe, të cilat i ke kryer më parë.
3. Të jesh i vendosur që nuk do t’i bësh më gjynahet e mëparshme.



*“O robërit e Mi, që e keni ngarkuar veten me shumë gjynahet,  
mos e këpusni shpresën nga mëshira e Allahut. Ai i fal të gjitha gjynahet,  
sepse është Falës dhe Mëshirues.”*

*- Zumer, 53 -*

Në kohën e Musait (a.s.), ndodhi një thatësi e madhe që nuk ishte përjetuar më parë. Populli i Musait (a.s.), u mbledh një ditë. Njerëzit shkuan te Musai (a.s.) dhe i thanë: “O Musa, lute Zotin që të lëshojë shi nga qielli, pasi mund të vdesim”. Atëherë Musai (a.s.), e mbledhi popullin dhe filloi të lutej, ndërsa populli thoshte Amin, pas çdo lutjeje. Megjithatë shiu nuk binte. Atëherë Musai (a.s.), u drejtua nga Allahu (xh.sh.) dhe tha: “O Zot, përse nuk po na lëshon shi, megjithëse të lutemi?” Zoti i thotë: “O Musa, nuk do të bjerë shi, pasi në mesin tuaj është një njeri, i cili ka dyzet vite që bën gjynahe, pa iu skuqur faqja një herë prej Meje. Nuk do të bjerë shi, derisa ai të dalë nga mesi juaj. Atëherë Musai i mbledhi të gjithë njerëzit dhe u tha: “Nuk do të bjerë shi, derisa të largohet prej nesh ai që ka dyzet vite që bën gjynahe”

Personi që kishte 40 vjet që bënte gjynahe, shikoi njëherë majtas dhe djathtas se mos dilte dikush tjetër, por, kur pa që nuk lëvizti kush, e kuptoi që flitej për të. Në ato çaste të vështira, filloi të thoshte me vete: “O Zot, ka dyzet vite që nuk të bindem e kam vazhduar me gjynahe dhe Ti m’i ke mbuluar ato për të mos e marrë vesh asnjë njeri. O Zot, po të dal tani do të dal i

poshtëruar dhe, nëse nuk dal, do të vdesim nga etja. O Zot, unë në këto momente pendohem për ato që kam vepruar, prandaj më fal dhe m’i mbulo të metat”. Në atë çast filloi të binte shi. Musai i habitur, e pyeti Zotin (xh.sh.): “O Zot, si ka mundësi që po bie shi, megjithëse nuk doli kush?” “O Musa, - ia ktheu Zoti, - robi im që bëri gjynahe për dyzet vite, u pendua me sinqeritet në ato çaste dhe Unë ia pranova pendimin, prandaj filloi të bjerë shiu”. Musai (a.s.), iu lut: “O Zot, të lutem ma trego, kush është ai njeri!” Por Zoti ia ktheu: “O Musa, ka dyzet vite që bën gjynahe dhe Unë ia kam mbuluar ato, kurse tani që u pendua dhe i la gjynahet, unë ta zbuloj dhe ta poshtëroj para njerëzve?”

Allahu (xh.sh.), thotë: **“A nuk e dinë se Allahu e pranon pendimin e robërve të Tij.”** (Tevbe, 104.)

Kërkesa për pendim në ajetet e Kuranit nuk u adresohet vetëm gjynahqarëve, atyre që kanë shkëputur çdo lidhje me Zotin, atyre që hezitojnë... por u drejtohet të gjithë njerëzve, të mirë dhe të këqij, me besim të dobët dhe me besim të fortë. Rreth kësaj, Allahu (xh.sh.), thotë në Kuran: **“Pendohuni tek Allahu, o besimtarë, sepse vetëm kështu do të shpëtoni.”** (Nur: 31.)



# Proza në kulturën Islame

*Ma. Artur Jagani*

**M**doshta letërsia është treguesi më i mirë i ndryshimit të gjakut kulturor që kalon një popull. Kjo gjë ndodhi edhe në botën islame. Me konvertimin në islam të persëve, vendin e poezive të stilit të lashtë arab dhe të poemave të famshme të beduinëve, e zuri proza e stilit pers, si pasojë e ndikimit të fuqishëm që kishte letërsia perse.

Sipas **Ibn Kutejbes** (vd.889), dikur myslimanët me shije letrare, aftësinë për prozë e konsideronin aq të veçantë, saqë mendonin se një person nuk mund të kishte aftësi edhe për prozë edhe për poezi, pasi shikohej si e papërballueshme për një njeri.

Kaq shumë u shijonte fjala e bukur, saqë **Bejhakiu** (vd. 1066) përmend kohën kur Kalifi i radhës, bashkë me paratë, kishte dërguar edhe një letër ngushëllimi, me rastin e dëmtimit që pësoi Meka në vitin 823. Mekasit e vlerësuan më shumë letrën e shkruar bukur nga Kalifi, sesa paratë që kishte sjellë si ndihmë për ta.

Në botën islame shquheshin mjeshtrit e prozës. **Ebu Akkali** dhe **The'alebiu** janë dy ndër më të hershmit. Madje nuk është e rastësishme që kishte edhe vezirë që kishin aftësi në prozë si: **Hasibi**, **Ibn Mukle**, **Muhalebiu**, **Ibnul-Amid**, **Sahib Ibn Abbad** dhe **el-Iskafi**.

Pa dyshim, njëri nga mjeshtrit më të mëdhenj të prozës ishte eruditi **Ebu Uthman el-Xhahidh** (vd. 869). Tregohet se shkencëtari i famshëm mysliman **Thabit Ibn Kurra** (vd. 901) kishte thënë se tre personalitete i kishte zili: **Hz. Omerin**, **Hasan el-Basriun**

dhe **Xhahidhin**. Një tjetër mjeshtër mjaft i madh i prozës arabe **Ebu Hajjan et-Tevhidi**, ka shkruar një libër për të lëvduar talentin e **Xhahidhit**. Madje, tregohet se **Ebu Hajjani**, vetëm për arsye se ishte një admirues i zjarrtë i fjalës letrare të **Xhahidhit**, mbronte pa kusht edhe teoritë e tij lidhur me Kelimin. Gjithashtu **Ibn Rexheb el-Hanbeliu** (vd. 1344) tregon se veziri që përmendëm më lart, **Ibnul Amidi** (vd.971), pranonte si të mjaftueshme për të punësuar njerëzit, nëse do të dinin të shpreheshin siç duhet, lidhur me Bagdatin dhe Xhahidhin.

Në prozat e kohës bie në sy stili i rimës brenda fjalisë (sexhi'). Kjo mënyrë e të shkruarit të vargjeve të lira, jo vetëm që dominonte në librat e ndryshëm letrarë të kohës, por mund të vërehej edhe në hytbet (ligjeratat fetare) e hoxhallarëve apo në letërkëmbimet zyrtare të kohës, që kishin përmbajtje vendimesh, projektesh apo shkarkimesh nga puna. Madje shihej si e pabukur të shkruheshin letra ndërmjet zyrtarëve pa estetikën letrare, si nga vetë kalifët, ashtu edhe nga nëpunësit. Mirëpo, sado i praktikuar qoftë të shkruarit e vargjeve të lira me rimë, normalisht kishte edhe zona, si Dinever, ku gjuhën e letrave të tilla e konsideronin si "kinezçe".

Oratorët arabë të kohës së kalifatit të **Harun er-Rashidit** (vd.809), ishin më të shquarit. Të gjithë bagdadasit i dinin përmendsh vargjet e tyre.

Tregohet për vezirin e apasionuar pas vargjeve të lira me rimë, **Sahib Ibn Abbad**-in, që ai edhe bisedat e lira i bënte me rimë. Çfarëdolloj ngjarjesh, qoftë edhe fatëkeqësitë familjare, i shpjegonte me rimë. **Jakuti** tregon se **Sahibiu**, në një rast shëtitjeje,

në vend që të ndalonte në një qytezë të bukur, kaloi në një fshat, vetëm për të bërë vargje me rimë:

*"Kitabi hadha min nevbahar*

*Jevmu's-sebti nifsu'n-nehar!"*

Madje, i njëjti historian, **Jakuti**, rrëfen se si **Sahibiu** me fuqinë e vargjeve të lira me rimë të një-pasnjëshme, bëri që t'i binte të fikët një vizitori që kishte ardhur tek ai dhe se vetë **Sahabiu** me lëng trëndafili e zgjoi atë.

Ndër pasuritë letrare më me vlerë të shekullit X, bëjnë pjesë edhe letërkëmbimet mes letrarëve, akademikëve dhe zyrtarëve. Që të gjitha këto i bashkonte një karakteristikë: estetika letrare. **Ibrahim Ibn Hilali** (vd. 994), ishte prej zyrtarëve të lartë të kohës, që shquhej si mjeshtër i estetikës letrare. Letrat e tij u kanë mbijetuar kohëve shkatërrimtare që pësoi bota islame përmes Kryqëzatave dhe pushtimit mongol.

Në këtë kohë, bie në sy pasioni që kishin edhe njerëzit e thjeshtë ndaj fjalës letrare. Veçanërisht në qytetet më të civilizuar të kohës, siç ishte Bagdadi, Horasani, Nishaburi, Basra, etj... Shquheshin gjithashtu edhe letrat personale të stilit grotesk të **Ebu Bekr el-Harezmit** (vd. 993), i cili njihej ndryshe edhe si "shkrimtari" i parë i arabishtes. Le të japim një shembull nga ai:

*"Dëgjova se njëri më paska fyer. Nuk e di ç'i ka ngjarë. A e ka shkundur era apo e ka tërhequr nga poshtë toka? Se mos e ka pickuar gjarpëri apo e kanë shqyer egërsirat? A mos vallë e ka tërbuar shtriga e shkretëtirës apo djajtë e kanë rrokur? Se mos i ka rënë vetëtimja, devetë e kanë shtypur apo udhërrëfyesi e ka shastisur? Hmm.. Se mos ka rënë nga deveja apo i ka shkarë këmba dhe është rrokullisur nga mali? Se mos ka rënë në pus apo i është shembur nga sipër mali? Se mos i janë tharë duart, paralizuar këmbët, lebroza mos e ka zënë apo i është infektuar diafragma? Mos vallë ka humbur rrugën në male, ka plasur në det apo nga temperaturat? Se mos e ka zënë ndonjë shigjetë vrastare apo i kanë bërë rexm për arsye të livatës?"*

Ndërsa një prej rivalëve letrarë më të mëdhenj të Harizmit, **Ebul Fadl el-Hemedani**, ndonëse në moshë të re (22 vjeçar), kishte marrë famë për stilin e veçantë të përdorimit të fjalës letrare. Ai kritikonte letrarët e mëdhenj paraardhës. Për **Xhahidhin** thuhet se ka thënë:

*"Fjalës së tij i mungon shprehia artistike dhe forma magjepsëse".* Ndërsa stilin e shkrimeve të **Harizmit** e shpjegon në këtë mënyrë:

*"Të shkruash letër, që kur të lexohet mbrapsht të konsiderohet përgjigje. Të shkruash letër, pa përdorur mënyrën e thjeshtëzuar të fjalëve. Të nisësh të shkruash diçka që, kur e merr në dorë, ka paraqitje poezie dhe të shkruash letër që të kuptohet edhe si lëvdatë edhe si analizë."*

Për **el-Hemedanin** thuhet se ishte një mjeshtër i fjalës artistike. Poezitë e tij ishin mjaft origjinale, me stil të veçantë letrar dhe një humor të hollë:

*"Ajo mban ritmin e bilbilave me lotët e saj" thotë në një varg dhe në një tjetër: "Si koha është malli që kam për shefin tim, nuk mbaron me kalimin e muajve dhe të viteve." Ndërsa në një varg tjetër shkruan: "Po të pres, ashtu siç presin tregtarët e Mekës karvanet e të huajve."*

Ai bënte akrobaci me fjalën letrare, sa mund të shkruante vargje duke përdorur të gjitha gërmat arabe dhe nuk përdorte qëllimisht gërmën kyçe "vav", për të treguar mjeshtërinë e tij.

**Ebu'l-'Ala el-Ma'arri** (vd. 1057), ishte një tjetër mjeshtër i prozës. Udhëtari pers, **Nasri Husrevi** thoshte për **Ebu'l-'Ala**-në:

*"I përdor fjalët aq në mënyrë letrare dhe fantastike, sa pjesërisht mund të kuptohet dhe vetëm prej tij duhen marrë komentet rreth asaj çfarë shkruan."*

Për t'i dhënë të drejtë **Husrevit**, po shkëpusim një pjesë nga një letër e **Ebu'l-'Ala**-së, për të kuptuar se vërtet edhe mund të mbytesh brenda retorikës, duke përdorur deri në mënyrë mjaft të bukur figurativen në artin e fjalës së shkruar:

*"Dhimbja që ndjej nga ndarja prej jush, është si ajo këngëtarja që fshihet pas perdes apo si një njeri i madh që është dëbuar nga roja për të mos u përzier me popullin; është pors një kumri që, në temperaturat e larta të verës, fshihet mes gjetheve të shpeshta të pemës dhe përcjell vdekjen e njeriut fisnik. Kumria ka një rreth të ngushtë përreth qafës, që thua sa s'ia këput. Sikur të mundej, do e këpuste vetë, për arsye të shqetësimit që ndjen nga malli që i ka sjellë shoku i vet. Një shok, që dikur Nuhu e pati lëshuar. Kumritë ende mbajnë zi për të. Vajtojnë me këngë të ndryshme mbi pullaze dhe rrëfejnë mallin e fshehtë mes degëve..."*

# Dispozitat e udhëheqjes dhe zgjedhjes së prijësit (kalifit)

## HYRJE<sup>1</sup>

Shoqëria e ka të domosdoshme të ketë sistemin e udhëheqjes dhe të drejtimit. Ndaj me të drejtë thuhet se ekzistenca e prijësit në shoqëri është më se e domosdoshme për të ekzistuar rregulli dhe rendi, pasi në këtë mënyrë do të jetë e mundur të respektohet ligji dhe të evitohet anarkia. Për këtë, Shejhul Islami Ibn Tejmije (r.a.), në librin e tij *Es-Sijasetu esh-Sheri'jetu*, shprehet kështu: “Njerëzit mund t’i realizojnë interesat e tyre vetëm me bashkimin me njëri-tjetrin, ndaj pajtëtarë në bashkimin e tyre duhet të jetë një prijës”<sup>2</sup>. Po ashtu, dijetari i mirënjohur el-Maverdiju thotë: “Sipas logjikës së të mençurve, duhet nënshtruar prijësit, i cili i pengon padrejtësitë e bën zgjidhjen e problemeve dhe të lasheve në mesin e njerëzve, pasi, po të mos ishin prijësit, do të bëhej anarki e madhe dhe do të kishte prapambetje”<sup>3</sup>.

Në fenë islame ekziston sistemi udhëheqës dhe dijetarët islamë kanë përcaktuar dhe shpjeguar dispozitat që kanë të bëjnë me këtë sistem.

Është për t’u befasuar kur shtrohet prej disave pyetja: “Ka sistem udhëheqës në fenë islame?” Përgjigja për këtë është e prerë: “**PO**”, sepse njëra prej veçorive të kësaj feje është sistemi gjithëpërfshirës dhe se është më se e qartë se në fenë islame ekzistojnë rregullat dhe dispozitat që kanë të bëjnë, në mënyrë të veçantë, me udhëheqjen në Islam. Ne gjejmë në Kuranin Fisnik urdhrin për të zbatuar institucionin e konsultimit, domosdoshmërinë e dëgjimit të udhëheqësve, sundimin sipas asaj që ka zbritur Allahu etj. Po ashtu edhe në sunetin e të Dërguarit (s.a.v.s.), shohim se janë përsëritur disa herë fjalët prijës, udhëheqës, zbatim i besnikërisë dhe nënshtrimi ndaj prijësit, përderisa ai nuk vepron diçka që bie në kundërshtim me ligjin e Allahut të Lartësuar. Në studimet e thella të juristëve myslimanë shohim se ata kanë konsoliduar shumë rregulla e norma, bazuar krejtësisht në Kuran dhe Sunet e që kanë të bëjnë me çështjet e udhëheqjes. Këto që përmendëm, argumentojnë se feja islame ka sistem të veçantë, që ka të bëjë me udhëheqjen.

1. Ky punim është i bazuar tërësisht në librin “Usulu Daveti” të dr. A - dul Kerim Zejdanit.

2. Ibn Tejmije: *Es-sijasetu esh-Sheri'jetu*, fq. 138.

3. El-Maverdiju: *El-Ahkamu es-Sultanijetu*, fq. 3.

Për ta bërë më të qartë shpjegimin e këtij sistemi, duhet të përmendim bazat e tij, që janë: **kalifi (prijësi), institucioni i konsultimit dhe nënshtrimi ndaj prijësit.**

## KUSH ËSHTË KALIFI (PRIJËSI)?

Kuptimi e shprehjes **kalif**, Imam Ibn Tejmije (r.a.), e shpjegon kështu: **kalif** i thuhet atij që zëvendëson tjetrin në ndonjë çështje.<sup>4</sup> Në terminologjinë e shariatit, me shprehjen kalif kuptohet marrja e përgjegjësisë së udhëheqjes së myslimanëve, d.m.th. udhëheqja e shtetit islam. Ky njihet edhe me emrin imam. Ky pra, (kalifi) është kryetar i shtetit, sipas asaj që përshkruan feja islame, d.m.th. ky e udhëheq shtetin mbi bazat islame dhe zbaton dispozitat e fesë. Pra, kalifi është ai, i cili përkujdeset për zbatimin e ligjeve të Allahut.

Imam Ibn Tejmije thotë: “Është obligim të dihet se udhëheqja e çështjeve të njerëzve, konsiderohet një ndër obligimet më madhështore të fesë islame dhe se feja nuk mund të zbatohet pa të”<sup>5</sup>. Kjo është një e vërtetë, ngase emërimi i kalifit, i cili e ka përgjegjësinë e udhëheqjes dhe administrimin e çështjes së njerëzve, konsiderohet njëri prej farzeve islame për të cilat argumenton Kurani, Suneti, Ixhmai dhe natyrshmëria e dispozitave të shariatit islam.

E para, argumenti prej Kuranit. Fjala e Allahut të Lartësuar: “**O ju që besuat, bindjuni Allahut, respektoni të dërguarin dhe përgjegjësit tuaj.**”<sup>6</sup>. Në këtë ajet me shprehjen: *përgjegjësit nga ju*, nënkuptohet prijësi, kurse disa janë të mendimit se me këtë shprehje synohen edhe dijetarët<sup>7</sup>.

E dyta, argumenti prej sunetit në formën e të shprehurit: “...*Kush vdes dhe nuk e ka kryer zbatimin e besnikërisë ndaj prijësit, ka vdekur si në kohën e injorancës*”. Pra, shihet qartë se emërimi i prijësit është çështje e domosdoshme. Në një hadith tjetër, thuhet: “*Do të shfaroset islami hap pas hapi, nëse në fillim do të kundërshtohet udhëheqja nga prijësi (mysliman), ndërsa në fund do të kundërshtohet namazi*”. Në hadith janë përmendur bashkë, si çështja e

4. Ibn Tejmije: *Minhaxhu Sunneti Nebevijeti*, vol. I, fa 137

5. Ibn Tejmije: *Es-Sijasujetu esh-Sheri'jetu*, fq. 138.

6. En-Nisa: 59.

7. El-Xhesasi: *Ahkamul Kur'ani*, vol. II, fq. 210, Tefsirul Kurtubiji vol. V, fq. 259.

kalifit, ashtu edhe namazi, si obligim, duke argumentuar edhe ekzistencën e kalifës.

E treta, argumenti prej sunetit praktik: vërtet i Dërguari (s.a.v.s.), është i pari që ka formuar shtetin islam në Medine, pasi e kishte përgatitur atë që kur ishte në Mekë. Ndaj i Dërguari (s.a.v.s.), është bërë prijësi i parë i shtetit islam, i cili u konsolidua në Medine... Marrëveshja e të Dërguarit (s.a.v.s.), me hebrenjtë dhe të tjerët, është një manifestim i udhëheqjes si një kryetar i shtetit islam. Juristët myslimanë kanë konkluduar se cilësitë e prijësit dhe të peygamberllëkut janë bashkuar tek i Dërguari (s.a.v.s.) dhe se kanë shpjeguar normën e obligueshmërisë së emërimit të prijësit, duke u bazuar në vetë praktikën e të Dërguarit (s.a.v.s.)<sup>8</sup>.

E katërta, mbështetja në ixhma. Juristët myslimanë thonë se emërimi i kalifës është obligim i prerë, sipas konsensusit (ixhmait) të të gjithë dijetarëve.

E pesta. Që të ekzekutohen, shumica e dispozitave të sheriatit kërkojnë përdorimin e forcës dhe fuqisë. Kështu, zbatimi i dispozitave të xhihadit, i masave sanksionuese dhe dënimeve, konsolidimi i drejtësisë mes njerëzve etj., kërkojnë patjetër emërimin e prijësit, me qëllim që të zbatohen në praktikë. Për këtë, Ibn Tejmije thotë: "Allahu ka obliguar urdhërimin në të mira dhe pengimin prej të këqijave, kryerjen e haxhit, kremtimit e bajrameve, përkrahjen e të dëmtuarve dhe zbatimin e masave sanksionuese. Këto nuk mund të zbatohen pa forcë dhe pa udhëheqje"<sup>9</sup>.

## KUSH KA TË DREJTË NË ZGJEDHJEN E KALIFIT?

Të drejtën për zgjedhjen e kalifit e ka në mënyrë ekskluzive shoqëria islame (umeti) dhe këtë e shpjegon më së miri Ibn Makdesi, në librin e tij el-Mugnij, duke thënë: "Ai, për të cilin myslimanët janë unanimitë, do të jetë prijës i tyre. Përkrahja e tij është obligim"<sup>10</sup>.

Bazën e të drejtës së umetit në zgjedhjen e kalifit, e shohim nga vetë të folurit kuranor, drejtuar myslimanëve në zbatimin e dispozitave të sheriatit, në ngritjen e fjalës së Allahut në tokë, në konsolidimin e shoqërisë së dobishme islame. Prej këtyre teksteve kuranore mund të përmendim: "**Besimtarët dhe besimtare të dashur për njëri-tjetrin; urdhërojnë për të mirë e ndalojnë nga e keqja**"<sup>11</sup>, "**O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë për hir të Allahut, edhe nëse është kundër (interesi) vetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmeve.**"<sup>12</sup> Këto ajete dhe shumë të tjera të ngjashme me to, argumentojnë për përgjegjësinë që ka komuniteti mysliman në zbatimin e dispozitave të sheriatit.

8. El-Karafi: El-Furuk, vol. I, fq. 207-208.

9. Ibn Tejmije: Es-Sijasetu esh-Sherijetu fq. 139.

10. Iben Kuddameh: El-Mugnij vpl. VIII, fq. 17.

11. Et-Teubetu: 71.

12. En-Nisa: 135.

## POZITA E KALIFIT (PRIJËSIT)

Umeti është i autorizuar të përcaktojë zgjedhjen e kalifit (prijësit) dhe, në të njëjtën kohë edhe të mandatit të prijësit. Si rrjedhim, kalifi-prijësi ka pozitën ligjore të përcaktuar nga umeti si i mandatar.

## MËNYRA E ZGJEDHJES SË KALIFIT (PRIJËSIT)

Umeti është ai që e zgjedh kalifin. Atëherë, si duhet ta bëjë këtë zgjedhje? Duhet ta bëjë direkt apo të gjithë anëtarët e umetit duhet të shprehin mendimin e tyre. Apo një grup prej umetit ta kryejnë këtë si përfaqësues të tij? Thënë realisht, ne nuk gjejmë ndonjë sistem të veçantë për zgjedhjen e kryetarit të shtetit. Kjo çështje i është lënë umetit dhe ai vendos metodën për zgjedhjen e prijësit. Mund të bëhet me pjesëmarrjen e gjithë umetit, me përjashtim të disa kategorive si: fëmijët, të çmendurit dhe jomyslimanët. Për këtë metodë të zgjedhjes kemi mbështetje në fjalën e Allahut të Lartësuar: "**dhe ata që konsultohen mes vete për punë të përbashkëta.**"<sup>13</sup> Ky ajete argumenton se myslimanët duhet të konsultohen mes vete për çështjet që i preokupojnë. Zgjedhja e kalifit është njëra prej çështjeve më të rëndësishme për umetin. Kjo bëhet e qartë në komentin, që imam Rraziu i bën ajetit të sipërcituar: "Kur ka ndodhur ndonjë ngjarje, sahabët janë tubuar dhe konsultuar mes vete. Ndaj Allahu për këtë veprim i ka lavdëruar. Pra, nga kjo, kuptohet se ata nuk kanë vepruar sipas mendimit vetjak..."<sup>14</sup>.

Umetit i lejohej të bëjë zgjedhjen e kalifit në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte, me anë të përfaqësuesve të vet. Për mënyrën e zgjedhjes me anë të përfaqësuesve të vet, gjejmë mbështetje në të kaluarën e hershme historike, si në kohën e hulefai rrashidinëve, që është koha më e mirë e kuptimit të islamit dhe praktikimit të tij. Zgjedhja e këtyre kalifëve të respektuar është bërë nga ana e një grupi të myslimanëve. Këta juristët myslimanë i emërtojnë si *ehu-l- hil-li vel akd-i* (njerëzit e besueshëm dhe me influencë të shoqërisë myslimane) e që vendimin e tyre e kanë pranuar myslimanët e Medinës dhe i kanë dhënë besatimin kalifit të zgjedhur prej tyre. Pra, nuk e kanë bërë zgjedhjen që të gjithë myslimanët dhe po ashtu, kalifit i kanë dhënë besatimin që të gjithë myslimanët e viseve islame dhe nuk përmendet se dikush ka kundërshtuar këtë metodë. Nuk e ka kundërshtuar asnjëri prej hulefai rrashidinëve dhe as ndokush tjetër prej myslimanëve. Kjo argumenton për konsensusin e tyre në saktësinë e mënyrës së zgjedhjes së kalifës. Juristët myslimanë e kanë miratuar këtë mënyrë të zgjedhjes së kalifit dhe e kanë shpjeguar. Ata janë shprehur: "Pasi është pranuar se emërimi i kalifit është një obligim, sipas konsensusit (ixhmait), atëherë ky është obligimi kolektiv (farzi kifaje), që u përket atyre që janë *ehlul akdi vel hil-l* (njerëz të besueshëm dhe

13. Esh-Shura: 38.

14. Tefsiru Rrazij, vol. XXVII, fq. 177.



me influencë). Këta duhet ta zgjedhin, ndërsa shoqëria duhet ta respektojë atë<sup>15</sup>.

## KUSHTET E KALIFIT:

Kushtet të cilat duhet të plotësojë kalifi-prijësi për t'u zgjedhur:

1. **Të jetë mysliman.**<sup>16</sup>

2. **Të jetë mashkull.**<sup>17</sup>

3. **Të ketë njohuri rreth dispozitave të shariatit**, sepse është i ngarkuar për implementimin e tyre dhe implementimi i tyre është i pamundur, nëse ai është injorant ndaj tyre. Allahu i Lartësuar ka thënë: **"Dije se nuk ka zot tjetër, përveç Allahut. Kërko falje për mëkatin tënd"**<sup>18</sup>. Disa prej juristëve myslimanë e kanë kushtëzuar që prijësi të jetë muxhtehid dhe nuk e kanë pranuar që ai të ketë njohuri rreth dispozitave të shariatit, duke u mbështetur në taklid.

4. **Të jetë i drejtë**, të mos njihet se ka bërë ndonjë mëkat të madh, të njihet si i devotshëm ndaj Allahut, si njohës i çështjeve politike dhe i mënyrave të udhëheqjes, të jetë guximtar në zbatimin e ligjeve të Allahut, duke mos pasur kurrfarë frike nga keqbërësit, të ketë njohuri për interesat e përgjithshme të umetit dhe mënyrat e realizimit të tyre, duke ditur se cilat duhet të jenë prioritare<sup>19</sup>.

5. **Të jetë prej fisit kurejsh**<sup>20</sup>.

15. Ibn Halduni "Mukadimeh" fq. 193, shiko el-Maverdiju fq. 4

16. Allahu i Lartësuar thotë: **"O ju që besuat, bindjuni Allahut, re - pekonti të dërguarin dhe përgjegjësit nga ju..."** Nga ky ajet kuptohet se thirrja është: o ju myslimanë, nënshtroju atij që është prej prijësve myslimanë. Po ashtu, Allahu i Lartësuar ka thënë: **"Allahu nuk u mundëson jobesimtarëve mbizotërim të plotë mbi besimtarët"**. Hilafeti është mbizotërimi më i madh, andaj kjo detyrë nuk lejohet t'i jepet jo-myslimanit, sepse esenca e hilafetit, siç do ta shpjegojmë, është se me të kuptohet marrja e përgjegjësisë për të ruajtur fenë e Allahut. Ndaj ky emanet mund t'i besohet veç atij që është besimtar i fesë islame dhe kurrësi nuk i lihet në dorë atij që e mohon këtë fe.

17. Allahu i Lartësuar thotë: **"Burrat janë përgjegjës për gratë"**. Gjithashtu i Dërguari (s.a.v.s.), ka thënë: **"Nuk do të ketë shpëtim një popull të cilin e udhëheq femra"**. Ky është hadith i saktë që e transmeton Buhariu dhe imamët e tjerë të hadithit. Realiteti faktik është dëshmitari më i mirë që gruaja është e paaftë për ta zbatuar detyrën e udhëheqjes së shtetit. Rastet kur femra bëhet udhëheqëse e shtetit, janë të rralla dhe të veçanta.

18. Muhamed: 19.

19. El-Maverdiju: eq.4, Ebu Ja'la fq. 4, Ibn Halduni Mukadimetu fq. 193.

20. Hadithi i të Dërguarit (s.a.v.s.), thotë: **"Prijësit duhet të jenë prej Kurejshëve"**. Ky hadith konsiderohet i saktë dhe me të argumentojnë juristët myslimanë. Urtësia e këtij kushti, sipas asaj që thotë Ibn Halduni, është se qëllimi me hilafetin është bashkimi i të gjithëve, unifikimi i fjalës, braktisja e mospajtimeve dhe ndjekja e udhëheqësit nga ana e umetit. Kjo mund të arrihet, kur kalifi i zgjedhur është prej atyre që pranohet nga të gjithë dhe që të gjithë kanë respekt ndaj tij. Kjo rehati shpirtërore dhe ky pranim unanimit do të realizohej kur kalifi të ishte prej kurejshëve, meqë kurejshët ishin të fuqishëm dhe arabët i njihnin ata si përparimtarë dhe të aftë për udhëheqje. Zgjedhja e kalifit prej kurejshëve e bën më të lehtë mundësinë e unitetit të fjalës dhe nënshttrimin me të lehtë ndaj prijësit. I Dërguari (s.a.v.s.), ka thënë se zgjedhja e kalifit prej kurejshëve motivon në mesin e shoqërisë unitetin dhe lehtëson realizimin e synimeve që ka ky institucion. Ne e dimë se Ligjdhënësi nuk i ka veçuar dispozitat e shariatit për një gjeneratë, kohë apo shoqëri. Kjo është prej çështjeve të rekomanduara dhe ne arrijmë të kuptojmë se

## SHKARKIMI I KALIFIT NGA DETYRA E TIJ

Umeti e zgjedh kalifin, ndaj ai ka të drejtë ta shkarkojë atë nga detyra. Por shfrytëzimi i kësaj të drejte bëhet kur ka arsyetim në bazë të shariatit. Kjo ndodh, kur kalifi del nga përgjegjësia që ka ndaj umetit apo kur është i paaftë të kryejë detyrën e kalifit. Kështu e kanë shpjeguar juristët myslimanë. Kur flet për prijësin, Imam Ibn Hazmi thotë: **"...është obligim të respektohet prijësi, përderisa ai i përmbahet Kuranit dhe sunetit të të Dërguarit (s.a.v.s.)"**. Po ndodhi që ai të mos i respektojë këto dyja (Kuranin dhe sunetin), pengohet nga kryerja e detyrës dhe zbatohen masat e dënimit ndaj tij, duke e shkarkuar prej detyrës e duke caktuar si kalif dikë tjetër<sup>21</sup>. Po ashtu, si mendime të juristëve myslimanë mund të përmendim: **"Ummeti ka të drejtën e shkarkimit të prijësit, kur ekzistojnë shkaqet që e kërkojnë një veprim të tillë, si paraqitja e konfuzionit në mesin e myslimanëve dhe shpërfillja e çështjeve fetare. Pra, umeti e ka caktuar kalifin për kryerjen e detyrave të caktuara"**<sup>22</sup>. Prej çështjeve që mund të konsiderohen si paaftësi të kryerjes së detyrës së kalifit e që parashikojnë shkarkimin e tij janë: çmenduria, verbëria, zënia rob nga ana e armikut.<sup>23</sup>

## IMPLEMENTIMI I SHKARKIMIT

Umeti e ka të drejtën e shkarkimit të kalifit, kur ekziston shkak shariatik për shkarkim, por duhet shikuar dhe analizuar shumë mirë, sepse duhen shikuar edhe pasojat që mund të sjellë ky shkarkim. Kur shkarkimi shihet se është i mundur dhe nuk i sjell probleme e pasoja umetit, atëherë duhet të ekzekutohet. Përndryshe, nuk duhet të ekzekutohet. Kjo arsyetohet me faktin se nuk duhet larguar një e keqe, nëse pas saj vjen një e keqe edhe më e madhe.

kushtëzimi i zgjedhjes së kalifit prej kurejshëve nënkupton që të zgjidhet kalif i myslimanëve ai që ka prejardhje prej ndonjë fisi të njohur dhe të fuqishëm, që respektohet dhe që ka pikëpamje përparimtare dhe që në kohën e vet kjo të jetë shkak për unitetin e vetë myslimanëve.

Realiteti është se hadithi: **"Prijësit duhet të jenë prej kurejshëve"** është prej haditheve të sakta dhe se nuk ka kurrfarë hapësire për kundërshtimin e saktësisë së tij, në aspektin e zinxhirit të transmetimit dhe të përmbajtjes, por ajo që mbetet për t'u diskutuar është përcaktimi i qëllimit-synimit parësor të hadithit. Atë që kanë kuptuar juristët myslimanë nga ky hadith është se me këtë kushtëzohet që kalifi të zgjidhet prej kurejshëve. Këtë kuptim e kanë përmendur të gjithë dijetarët. Ajo çfarë mendon Ibn Halduni për kuptimin e këtij hadithi, ka mundësi të këtë edhe këtë kuptim. Ka mundësi që ky hadith ka kuptimin e lajmërimit të ndodhive rreth zgjedhjes së kalifit. Sipas të gjitha këtyre shpjegimeve, rezulton se, kur ndodh që dy kandidatë për kalifë i plotësojnë kushtet e duhura, por vetëm kanë dallim se njëri prej tyre është prej fisit kurejsh, duhet doemos të zgjidhet ai. Por nëse ndodh që kandidati është i fisit kurejsh, por nuk i plotëson kushtet e duhura, ndërsa kandidati tjetër që nuk është i fisit kurejsh i plotëson të gjitha kushtet, atëherë duhet të zgjidhet ky për kalif. Arsyja është se nuk mund të realizohet zgjedhja e kalifit, vetëm pse dikush është kurejsh, por kjo zgjedhje bëhet kur plotësohen të gjitha kushtet. Baza themelore për zgjedhjen e prijësit është forca dhe përshtatshmëria. Po që se nuk gjendet asnjë kurejsh që i plotëson kushtet, zgjidhet edhe tjetri që nuk është prej fisit kurejsh.

21. Ibn Hazmi: El-Milelu ven-Nihelu vol. VI, fq. 102.

22. Dijauddin Rrejs: Kitabu Nedharjeties-Sijasisijetiel-islamijeti fq. 270.

23. Ebu Ja'la fq. 605

## KOMPETENCAT PËR DHËNIEN E PUSHTETIT

Umeti është ai që ka të drejtë të zgjedhë kalifin me anë të *ehlul akdi vel-hil-li*. Mund të kundërshtojmë rreth kompetencave të pushtetit, të cilat juristët myslimanë i kanë vendosur për përcaktimin e pozitës së kalifit. El-Maverdiju dhe Ebu Ja'ala el-Hanbeliju thonë: "Pushteti përcaktohet në dy mënyra: e para është me vendosjen e kalifit nga *ehlul akdi vel-hil-li* dhe mënyra e dytë është, kur vetë kalifi përcakton pasardhësin e tij"<sup>24</sup>.

Zgjedhja e kalifit duke u përcaktuar nga vetë kalifi, është mënyrë e zgjedhjes që ka ndodhur realisht në kohën e hulefai rrashidinëve, ku dihet se Ebu Bekri (r.a.), ka caktuar Umerin (r.a.), si kalif pas tij, ndërsa Umeri (r.a.), kishte zgjedhur gjashtë persona, njëri prej të cilëve do të zgjidhej. Duke u bazuar në këto dy raste, juristët myslimanë kanë konsideruar si të lejuar zgjedhjen e kalifit, sipas asaj që përcakton vetë kalifi dhe veprimi i zgjedhjes është i lejuar sipas konsensusit (ixhmait).

Tani parashtrrohet pyetja se cila është mënyra ligjore e sheriatit ndaj kompetencave për dhënien e pushtetit? Vallë, a mund të caktohet kalifi vetëm nga vullneti i parardhësit? Çfarë duhet t'i paraprijë dhënies së pushtetit? Përgjigja ndaj këtyre pyetjeve është e domosdoshme, me qëllim që të na bëhet e qartë se çfarë pranohet dhe çfarë kundërshtohet rreth kompetencës për dhënien e pushtetit nga e drejta e umetit.

**E para:** Në librin El-Ahkamu-s-Sultanijetu të autorit Ebu Ja'ala njëri prej juristëve të medh'hebit hanbelit, përgjigja është: lejohet që kalifi të përcaktojë se kush do të jetë pas tij...ngase përcaktimi i kalifit nuk mund të konsiderohet se është akt për kalifat"<sup>25</sup>.

Kalifati nuk mund t'i përcaktohet tjetrit vetëm pse këtë e ka përcaktuar kalifi paraprak, por kjo bëhet kur myslimanët ia besojnë këtë detyrë... ngase mundësia e këtij që është përcaktuar si kalif prej kalifit paraprak do të mund të përcaktohet menjëherë pas vdekjes së kalifit me zgjedhjen që do ta bëjnë ata që jetojnë në këtë kohë"<sup>26</sup>.

Të gjitha këto mendime argumentojnë qartë se përcaktimi vetëm nga kalifi paraprak nuk është i mjaftueshëm, por duhet të bëhet edhe me zgjedhjen që e bëjnë *ehlul akdi vel-hil-li*. Ajo që ka përcaktuar kalifi paraprak ka qenë vetëm një lloj nominimi për të marrë pozitën e hilafetit e nuk është përcaktim përfundimtar. Por hilafeti përcaktohet me dhënien e besatimit dhe dhënia e besatimit nuk është e njëjtë me nominimin. Përgjigja jonë për këtë është se fjala (تعقد) është bërë besatimi -ka kuptimin e nominimit për shkak të pajtueshmërisë së fjalëve që kemi përmendur. Mundet që kjo fjalë të ketë kuptimin se kjo dhënie e besatimit mund të bëhet nga

24. El-Maverdiju, fq. 4, Ebu Jala fq. 7

25. Ebu Ja'ala, fq. 9

26. ibid

i nominuari, nëse për këtë pajtohet *ehlul akdi vel-hil-li* e që në të shumtën e rasteve kjo ndodh pas konsultimeve me *ehlul akdi vel-hil-li*.

**E dyta:** Në kohën e Ebu Bekrit, kur përcaktohet prej tij që si kalif të jetë Umeri, ai ishte konsultuar me *ehlul akdi vel-hil-li*, dhe ata ishin pajtuar dhe kishin pranuar një vendim të tillë. Kjo është e vërtetuar historikisht dhe mbi këtë bazë shihet se përcaktimi i Ebu Bekrit që Umeri të ishte kalif pas tij, është me pëlqimin e *ehlul akdi vel-hil-li*. Nga kjo mund të themi se veprimi i Ebu Bekrit ka qenë tërësisht i pranuar nga *ehlul akdi vel-hil-li*. Po ashtu, në kohën e Umerit, vetë Umeri ka nominuar gjashtë veta për t'u zgjedhur dhe kishte anuar nga Abdurrahman bin Aufi. Por pas konsultave që kishte bërë me sahabët e njohur dhe *ehlul akdi vel-hil-li*, tri ditë e tri net, kishte parë se të gjithë ishin të mendimit që si kalif të zgjidhej Uthman bin Affani. Ndaj në këtë rast e shpalli këtë zgjedhje. Ne konsiderojmë që të dy rastet, si ai i Ebu Bekrit dhe i Umerit, janë konsultuar me *ehlul akdi vel-hil-li* dhe kanë marrë pëlqimin e tyre për të nominuarin. Padyshim, vetëm pëlqimi nga *ehlul akdi vel-hil-li* nuk nënkupton se i nominuari e ka marrë pozitën e kalifit. Vetëm pas vdekjes së kalifit legjitim dhe lajmërimit haptas se *ehlul akdi vel-hil-li* janë të pajtimit që i nominuari prej kalifit paraprak të bëhet kalif. Po qe se *ehlul akdi vel-hil-li* nuk e lajmërojnë haptas zgjedhjen e tyre, atëherë i nominuari prej kalifit nuk mund të bëhet kalif. Për këtë çështje ka tërhequr vërejtjen dijetari i njohur Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë!), duke reaguuar ndaj atyre që thonë se dikush mund të bëhet kalif, nëse atij i kanë dhënë besatimin katër veta, tre, dy apo edhe një. Ky dijetar thotë: "Këto nuk janë mendimet e dijetarëve të ehli sunetit, ngaqë çështja e emërimit të kalifit, sipas tyre vërtetohet me dhënien e pëlqimit nga ata që kanë forcë e të cilët me nënshtrimin e tyre arrijnë deri te qëllimi. E nëse këta që janë të fortë dhe që kanë pushtet i japin besatimin për t'u bërë prijës, atëherë ai bëhet... Umeri është bërë imam, pasi atij ia kishte besuar këtë detyrë Ebu Bekri (r.a.) dhe që të gjithë të tjerët kishin dhënë besatimin që Umeri të bëhej prijës. Sikur ata të mos ishin të gjithë të mendimit që Umeri të bëhej prijës në kohën e Ebu Bekrit, atëherë ai nuk do të mund të bëhej, pavarësisht nëse ishte e lejuar apo jo... Ai që mendon se dikush mund të bëhet prijës, nëse pranon një person, dy apo katër dhe që këta nuk kanë forcë, ka gabuar dhe po ashtu, kush mendon se nëse një, dy apo dhjetë veta e kundërshtojnë zgjedhjen e prijësit, ai nuk do të jetë i zgjedhur, e ka gabim... Uthmani (r.a.), nuk është zgjedhur prijës, vetëm pse është zgjedhur veç nga disa vetë - këta ishin gjashtë vetë të zgjedhur prej Umerit (r.a.) - por ai është zgjedhur me besatimin që i kanë dhënë që të gjithë njerëzit dhe të gjithë myslimanët kanë qenë dakord dhe nuk e ka kundërshtuar askush zgjedhjen e tij"<sup>27</sup>.

27. Ibn Tejmije: Minhaxhu Sunneti, vol I, fq. 140-143

# TOLERANCA E MYSLIMANËVE NDAJ TË KRISHTERËVE TË SPANJËS

**N**ë fillimet e pushtimit islam nuk është dëgjuar asnjë rast sulmi ndaj fesë së krishterë as konvertimi të detyrueshëm. Një rrethanë, e cila ka ndikuar më shumë në pushtimin e Spanjës, është fakti që myslimanët kanë mbajtur qëndrim tolerant ndaj krishtërit. Myslimanët kanë mbledhur haraçin, si zëvendësim për detyrën ushtarake, të cilën e kanë marrë nga meshkujt, por jo nga fëmijët, gratë, varfanjakët, kallogjerët, të çalët, të sëmurët dhe robërit.

Në rastet kur nuk binin ndesh me ligjet islame edhe paditësi edhe i padituri kanë qenë të krishterë, ata i ka gjykuar gjyqtari i kësaj feje sipas ligjeve të tyre dhe askush nuk u është përzier në punët fetare. Ritualitë sakrificës, i cili është një prej ritualeve të pastra katolike, kryhej me temjanët e ndezur dhe me jehonën e kabanës. Edhe predikimet janë mbajtur, janë kënduar poezi fetare, shkurtimisht, ritualët kishtarë i kanë kryer sipas traditës. Është e qartë se nuk kanë qenë të detyruar të vishnin rroba të tjera, por gjithsesi, në shekullin IX, të krishterët, përveç priftërinjve, janë veshur si arabët. Nganjëherë merrnin leje të ndërtonin kisha të reja. Nëpunësit myslimanë nuk janë përzier me të krishterët që kanë formuar manastire për kallogjerët. Në vendet publike shiheshin murgjit me mantelet (habitete) e leshta sipas rregullave të rendit të tyre, ndërsa priftërinjtë nuk kanë ndier nevojën t'i fshehin shenjat e besimit të tyre.

Është me rëndësi edhe fakti që gjatë tërë shekullit XVIII është organizuar vetëm një trazirë në vendin e quajtur Bexha (Beja), në veprimin e një prijësi arab. Në gjendje më të mirë nuk gjendeshin as të krishterët, të cilët u shpërngulën brenda kufirit francez me dëshirën që të jetonin nën sundimin e krishterë. Kur Karli i Madh u kthye nga Spanja, në vitin 812, emigrantët e krishterë që kanë ndjekur ushtrinë e tij janë keqtrajtuar nga ana e oficerëve të tij, sa ka qenë i detyruar të ndërhyjë Ludeviti I për mbrojtjen e tyre, madje ka dhënë urdhëresë të veçanta në dobi të të shpërngulurve, pasi aristokracia i kishte grabitur pasuritë që u ishin dhënë refugjatëve. Kjo tirani, edhe pse është ndërprerë për një kohë, më vonë është shfaqur sërish. Urdhëresat që janë dhënë në dobi të të ngjuarve, e kanë bërë gjendjen e tyre edhe më të padurueshme.

Qëndrimin tolerant që ka mbajtur shteti islam në Spanjë dhe kontaktet e lira të ithtarëve të dy feve, kanë bërë që deri diku këto dy bashkësi të përzihen me njëra-tjetrën. Izidari nga vendi Bexha, ka shënuar pa kundërshtim kurorëzimin

e së vejës së mbretit Roderiko me Abdulaziz b. Muadhin. Shumë të krishterë kanë marrë emra arabë dhe madje, qoftë edhe formalisht, kanë ndjekur disa tradita të fqinjëve të vet myslimanë. Për shembull, disa i kanë bërë synet fëmijët e tyre. Shumë prej tyre i kanë imituar myslimanët në ushqim e pije. Emërtimi "muzarab" - i shtrembëruar prej "mustareb" (i arabizuar) - me të cilin nënkuptoheshin të krishterët spanjollë nën sundimin arab, dëfton rrethanat në të cilat është jetuar, përmban në vete rëndësinë mbi prirjet në këtë aspekt. Mësimi i gjuhës arabe zuri vendin e mësimin të gjuhës latine në tërë Spanjën. Kështu, gjuha latine, gjuhë e teologjisë së krishterë, shkallë-shkallë është harruar, aq sa klerikët janë turpëruar nga pozitat e larta, për shkak të mosnjohjes së gjuhës latine. Natyrisht se nuk mund të pritej më shumë kujdes dhe orvatje për këto gjëra nga ata që nuk kanë qenë figura shpirtërore.

Pasi ishin të preokupuar së tepërmi me dritën e letërsisë arabe, e cila i tërhiqte fuqishëm, ata që kanë dëshiruar të njihen me veprat e krishtera kanë pasur pak material. Madje, mësuesit kanë gjetur me vështirësi të dhëna të rëndomta. Gjatë kohës nevojat pedagogjike janë rritur.

Është e njohur se prifti Elipandosi në vitin 810, peshkopi i Toledos, komentues i sektit "mutehazin" dhe dijetar që ka besuar se Jezusi, i cili është njeri, nuk është për nga natyra i biri i Zotit, por që e ka ndjekur rrugën e Zotit - e ka përvetësuar këtë ide, për shkak të kontaktit të shpeshtë me myslimanët. Ky sekt i ri u zgjerua në shumë pjesë të Spanjës dhe filloi të shtrihej, sipas udhëzimeve të peshkopit katalanas Feliksit, deri në Septimani, e cila ka qenë nën mbrojtjen franceze. Peshkopi Feliks është nxjerrë para gjyqit shpirtëror, të kryesuar nga vetë Karli i Madh dhe është detyruar të



heqë dorë dhe të pendohet për shkak të mashtrimit të vet, por, me t'u kthyer në Spanjë, ai vazhdoi prapë në herezinë e vjetër. Kjo, sipas pohimit të papës së atëhershëm Leonit III, ka ndodhur për shkak të kontaktit me jobesimtarët me besim të ngjashëm. Kur ndikimi i kontaktit me myslimanët ka qenë aq i rëndësishëm në dinjitarët e mëdhenj kishtarë, mund të konkludojmë se ka qenë mjaft i madh edhe në të krishterët e tjerë të Spanjës. Dhe vërtet, koncili, që u formua në vitin 936 në Toledo, ka shqyrtuar se çfarë mjetesh duhet të ndërmerren kundër përzjerjes që do të prishte pastërtinë e besimit të krishterë.

Këto ndikime të besimit dhe veprimi mysliman - krahas disa sukseseve të caktuara të konvertimit- përveç përzjerjes së shpeshtë dhe kontakteve, do të rezultojnë me fryte edhe më të mëdha, dhe do ta rrisnin numrin e myslimanëve të gjakut joarab, të quajtur *muvelled*. Nuk kaloi shumë kohë dhe pasardhësit e këtyre muvelledëve formuan partinë e rëndësishme në shtet. Madje, kuptohet se më në fund, këta muvelledë, të cilët përbënin shumicën e popullsisë, qysh në fillim të shekullit IX, janë orvatur ta tronditin pushtetin arab, duke formuar ndër myslimanët e Spanjës parti nacionale.

Duket se nuk ka të dhëna për historinë e konvertimit të këtyre myslimanëve të rinj. Shembujt e këtyre konvertimeve janë vërejtur deri në ditët e fundit të pushtetit islam. Madje, në vitin 1487, kur ushtria e Ferdinandit dhe Izabelës pushtoi Malagën, ka vrarë, duke i torturuar me shkopinj të hollë me majë, ata që kanë rënë nga krishtërimi. Reth dy vjet më pas, me marrëveshjen dorëzuese të Porgeues, është marrë premtim i veçantë se nuk do të detyrohen ata që e kanë lëshuar që të kthehen sërish në krishtërim.

Disa prej tyre e kanë lëshuar islamin që të shpëtojnë nga gjopa në të holla, me të cilat janë gjykuar nga ana e gjyqeve. Shumicën e ka përvetësuar supremacioni shpirtëror i ndikimit islam.

Përzemërsia bujare me virtytet e tjera humane e të larta, që kanë treguar pushtuesit arabë, kanë krijuar fushë të hapur të zhvillimit të këtij ndikimi. Jeta e tillë ka qenë e mbyllur për spanjollët jomyslimanë. Kur krahasohet shkenca dhe letërsia e myslimanëve me shkencën dhe letërsinë e të krishterëve, kjo e dyta duket mjaft e varfër.

Islami në fushën e shkencës dhe letërsisë, si lëvizës dhe faktor entuziazmes, ka kryer shërbim special për ithtarët e vet. Përveç kësaj, islami në Spanjë ka treguar tërheqje të grupit religjioz, energjik të njerëzve të pastër moralë, në krye të të cilëve kanë qenë teologët e devotshëm. Ky grup i singertë dhe religjioz ka zhvilluar ndikim dominues në punët shtetërore dhe ka luftuar për zbatimin e reformave fetare dhe morale.

Kur merren parasysh ndjenjat e zjarra fetare të myslimanëve të Spanjës dhe intrigat e popullatës së krishterë, të cilëve në marrëveshje me bashkëvendimtarët jashtë kufirit kanë revoltuar dhe zemëruar sundimin islam, mund të vërejmë se Spanja ka qenë e kursyer nga persekutimet fetare nën sundimin arab. Po të përjashtohen tre-katër raste të zbatimit të dënimit me vetëdashje të atyre që kanë dëshiruar që në emër të fesë të bëhen martirë, nuk mund të gjendet gjatë gjithë kohës së sundimit islam gjendja për të cilën do të mund të thuhet se është sulm i pastër në fe. Pushteti islam ka ndërmarrë masa rigorozë që ta pengojnë marrëzinë e "sflitjes vullnetare", që është lajmëruar në shekullin e IX në Kordovë. Atëherë në këtë anë të Spanjës, në mesin e të krishterëve është përhapur grupi fanatik, pjesëtarët e të cilit, pa arsye, publikisht kanë ofenduar fenë e myslimanëve dhe e kanë sharë Pejgamberin e tyre, që të prodhojnë rrymën endacake të fanatizmit të krishterë, duke tentuar qëllimisht të nxisin mbi vete dënimin me vdekje.

Në një memorandum që ia parashtroi mbretit Filip III, kryepeshkopi i Valencias, hartuar në vitin 1602, me qëllim internimin, nënçmimin dhe konvertimin e myslimanëve spanjollë, megjithatë shprehet në fillim për frymën tolerante të islamit. Me këtë rast, në memorandum pranohet se Turqit dhe myslimanët e tjerë u kanë dhënë nënshkretasve jomyslimanë lirinë e ndërgjegjes.

Që islami ka lëshuar rrënjë të thella në zemrat e popullit spanjoll, mund ta gjykojmë me faktin se, kur është larguar grupi i fundit i myslimanëve vendas, i quajtur "Morisko", këta të mjerë, ndonëse janë detyruar që pas 100 vjetësh, të tregoheshin formalisht të krishterë, kanë dëftuar se kanë mbetur besnikë të fesë së të parëve. Përkundër emigrimeve, që kanë ndodhur pas rënies së Granadës, numri i grupit të fundit të internuar ka qenë pesëqind mijë.

Qytetet dhe fshatrat janë shkretuar, kurse shtëpitë janë shndërruar në gërmadha, dhe nuk kanë gjetur banorë të ri të cilët do t'i riparoinin. Në damarët e këtyre Moriskosëve ka pasur shumë pak gjak arabi. Sipas një letre spanjolle, prej 250.000 myslimanëve, me banim në Granadë, vetëm 500 kanë qenë të gjakut arab. Gjithë të tjerët kanë qenë pasardhës të spanjollëve myslimanë. Deri në ditët e fundit të ekzistencës së vet në Spanjë, islami ka fituar zemra të reja. Për këtë arsye, një historian, duke shkruar për ngjarjet që kanë ndodhur shtatë vjet pas rënies së Granadës, tërheq vëmendjen në faktin se, madje edhe në atë kohë, disa të krishterë që jetuan në mesin e Marokenëve, kanë hyrë në shtetun fetar të të ndershmit Muhamed.



# Fermanët e sulltanëve në mbrojtje të të drejtave të jomuslimanëve në Shqipëri

**M**egjithëse është një histori komplekse, për të parë shembujt e tolerancës dhe burimin se nga ka rrjedhë, mjafton t'u hedhim një sy edhe disa prej fermanëve të sulltanëve osmanë dhe do të shohim se toleranca dhe harmonia kanë rrjedhë nga nivelet më të larta të pushtetit suprem mbretëror, deri tek shtresat e thjeshta të popullit, në përgjigje të kërkesave, qoftë edhe të zakonshme, si ankime për çështje pronash të kishave apo edhe të individëve të thjeshtë me besim të ndryshëm fetar nga sunduesit e Portës së Lartë.

Fermanët që do të citohen në këtë artikull gjenden në dosje të ndryshme, që ruhen në Arkivin e Shtetit në Shqipëri.

Në vitin 1736 lëshohet një ferman, ku sulltani urdhëron mosndërhyrjen në ullishtën e një të krishteri. Në 1862 Fermani i Sulltanit lejon ndërtimin e kishës së rrënuar të Shën Harallambit, në Kamenë të Sarandës.

Në 1712 Fermani i Sulltanit mbi të drejtat e zotërimit të pronave të priftërinjve të Delvinës.

Në vitin 1680 Fermani i Sulltanit ndalon spahitë t'u kërkojnë taksa arbitrare priftërinjve të kishës së Delvinës për pronat kishtarë.

Në Fermanin e Sulltanit të vitit 1587 urdhërohet (të ndihmohen) të martohen vajzat jetime, pa dallim feje.

Në 1710 Fermani i Sulltanit urdhëron Kadiun e Delvinës të verifikojë çështjen e ndërhyrjes së vojvodëve në pronat e kishës dhe, nëse del se ankimi i priftërinjve është i drejtë, ndalohen ndërhyrjet arbitrare të vojvodëve. "Unë kështu urdhëroj dhe kështu le të bëhet", firmoste Sulltani.

Në 1853 Fermani i Sulltanit urdhëron prefektin dhe kadiun e Beratit që të njohë të drejtat e

kërkuara nga Mitropoli i Beratit.

Me Ferman të Sulltanit i jepen dy medalje Bib Dod Pashës; e para në 1897 për ndihmat që ka dhënë në shumën prej 3.500 groshësh dhe e dyta, në vitin 1902 për shërbimin që ka bërë në ndërtimin e hekurudhës Stamboll-Medine, që do të përdorej nga haxhilerët.

Në 1856 Fermani i Sulltanit shkruan:

"Meqenëse katolikët e Durrësit nuk kanë një faltore dhe, meqë janë lutur të ndërtojnë një kishë, jap lejen që të ndërtohet në një vend të përshtatshëm, sepse kështu është dëshira ime, që të gjithë qytetarët të gëzojnë qetësi të plotë. Urdhëroj që të mos i bëhet asnjë ndalim e pengesë dhe të mos iu merret asnjë para. Kështu, le ta dini."

Në një ferman tjetër sulltanor, dërguar priftit dhe kadiut të Delvinës, ndalohet marrja e taksave për pronat e kishës në Delvinë.

Në fermanin e vitit 1849 urdhërohet rindërtimi i kishës së Elbasanit, kurse në vitin 1850 ndërtimi i Katedrales së Madhe të Shkodrës.

Në vitet 1854, 1860, 1868, 1886, 1906, 1911, 1912, janë dërguar disa fermanë, drejtuar ipeshkvit dhe valiut të Shkodrës, Patriarkanës së Stambollit, drejtuesve të pushtetit vendor në vilajetet shqiptare, konsullatave të ndryshme, etj., në të cilat lejohet dhe urdhërohet ndërtimi, meremetimi dhe regjistrimi i kishave (të paregjistruara) në Shkodër, Durrës, Prevezë, Rrashbull, Shënkoll, në Bregun e Bunës, Llukaçaj, Bajzë, Bushat, Bërdicë, Juban, Obot, Dhrovjan i Poshtëm, Koshovicë, Lugar, Pejë, Prizren, Delvinë, Sarandë, Cetinjë, Tiranë, Elbasan, Kastrat, Ohër, Pulaj, Rubik, Shëngjin, të një kisha rumune në Korçë, manastiri i Cepos, ngritja e këmbanores në kishën e Shën Mërisë në



Korçë, Përmet, etj. Në vitin 1881, Sulltani me një ferman të tij dekoron arqipeshkvin e Shkodrës. Kurse me një ferman tjetër të 1888, emërohet Xhakomo Jungu si misionar apostolik në Shqipëri, Preng Doçi si abat i Mirditës, si dhe Paskal Guezini arqipeshkv i Shkodrës.

Historianët e perandorisë osmane vërtetojnë se me ardhjen në Stamboll, Sulltan Fatihu paraqiti shembullin e tolerancës islame. Ai menjëherë e ripërtëriu patriarkanën bizantine, i ktheu lirinë dhe pavarësinë kishës lindore.

Fermani i Sulltan Fatihut mbi të drejtat e njeriut, shkruar më 28 maj 1463, në Millodrazh, i cili llogaritet si njëri ndër dokumentet më të vjetra mbi të drejtat e njeriut, thotë:

“Unë Fatih Sulltan Han, shpall para të gjithë botës se françeskanët e Bosnjës, për të cilët del ky Ferman, janë nën mbrojtjen time dhe urdhëroj:

As njerëzit, emrat e të cilëve shpallen këtu dhe as kishat e tyre të mos shqetësohen e të mos dëmtohen. Le të jetojnë në paqe e të qetë brenda Perandorisë sime. Të gjithë këta njerëz të rënë në gjendje refugjati, le të jetojnë të lirë dhe të sigurtë. Le të kthehen ata në çdo pjesë të perandorisë e të vendosen e të sistemohen pa frikë nëpër manastiret e tyre.

Askush nga rrethi i nderuar i Padishahut, nga vezirët dhe nga nëpunësit e mi, nga shërbëtorët dhe qytetarët e Perandorisë, nuk do të cenojë dinjitetin e këtyre njerëzve dhe nuk do t’i dëmtojë ata. Askush të mos u cenojë jetën, pasurinë dhe kishat këtyre njerëzve, të mos i shohë e trajtojë keq dhe të mos i rrezikojë. Edhe nëse sjellin njerëz të tyre nga një vend tjetër në shtetin tim, ata do të gëzojnë të njëjtat të drejta.

Duke shpallur këtë ferman të Padishahut, betohem në Emër të Allahut, (Krijuesit, Zotit të tokës e qiellit), të dërguarit të Allahut, Profetit tonë të shenjtë, Muhamedit, e 124 mijë profetëve dhe në emër të shpatës që kam ngjeshur në brez, - se asnjë nga shtetasit e mi, të cilët do t’u binden urdhrave e do të mbesin besnikë të mi, nuk do të veprojnë në kundërshtim me ç’skruhet në këtë Ferman”.

# Hz. Erva binti Abdulmutalib, halla e Profetit (a.s.)

**H**z. Erva (r.a.), është pjesëtare e fisit Hashimi, e bija e Hz. Fatma binti Amr dhe Abdulmutalibit, motra e babait të Profetit (s.a.s), Allahut. Ndoqi hap pas hapi fillimet e para të islamit, duke mos e kursyer kurrë mbështetjen ndaj nipit të saj, megjithëse nuk ishte nderuar akoma me dritën e islamit.

Në periudhën e injorancës ishte e martuar me Umejr ibn Vehbin, ku Allahu i gëzoi me një djalë, Tulejbin. Ky i ri, i rritur dhe i edukuar në sofrën e dijesh të Profetit (s.a.s), gjithnjë i përgjerohej Allahut që edhe nëna e tij e shtrenjtë të përjetonte ndjesinë e lumturisë, që të dhuron besimi në një Zot të vetëm.

Një ditë, teksa bisedonte me nënën e tij, i tha:

- E shtrenjta nënë! Unë pranova islamin, iu binda dhe iu dorëzova Profetit (s.a.s).

Ajo, duke mos e kundërshtuar, iu përgjigj:

- Nuk ka dyshim se djali i dajës tënd meriton mbështetjen tënde.

Kjo ishte një arritje për Tulejbin në misionin e tij për të ftuar nënën në islam, megjithëse ajo nuk ia kishte hapur akoma zemrën fesë së vetme, të pranuar tek Allahu.

Ditët kalonin...ne Mekë islami po përhapej dhe numri i myslimanëve po shtohet gjithnjë. Tulejbi dëshironte me ngulm që edhe nëna e tij të shkëputej nga errësira e injorancës që dhuronte besimi në idhuj. Duke mos hequr dorë nga lutjet, i fliste dhe e ftonte gjithnjë për t'u njohur me bukuritë e islamit, derisa një ditë e pyeti:

- E shtrenjta nënë! Shiko edhe vëllai yt Hamzai (r.a.), ka pranuar islamin. Po ty, çfarë të pengon që të braktisësh tunelet e errëta të injorancës, për

t'u ndriçuar me nurin e islamit?!

Iu përgjigj:

- Biri im i dashur! Jam në dijeni për vëllain tim Hamzanë. Edhe unë, së shpejti mbase, do jem pjesë e juaja."

Nga kjo, Tulejbi kuptoi se nëna e tij po pastronte zemrën nga politeizmi, për ta mbushur me mirësitë e islamit, por akoma nuk e ndiente veten të gatshme të përballej me këtë ndryshim rrënjësor.

Pastaj i tha:

- Nënë e dashur! Unë nuk do resht së luturi Allahun (xh.sh.), derisa ti të shkosh pranë Profetit të nderuar dhe të deklarosh shehadetin.

Pak kohë më vonë, e frymëzuar nga sinqeriteti në lutje dhe këmbëngulja e të birit, gjithashtu duke mos i rezistuar dot dashurisë së zjarrtë që ndjente për nipin, Hz. Erva (r.a.), u bind dhe deklaroi fjalët më kuptimplota me të cilat ishte ndeshur ndonjëherë, deklaroi shehadetin, duke nderuar dhe shtuar numrin në grupin e grave dhe nënave të devotshme e të përkushtuara besimtare.

Ebu Lehebi, me të marrë vesh lajmin se e motra Erva (r.a.), kishte pranuar islamin, iu drejtua i acaruar, duke i thënë:

- Çuditem si ke braktisur fenë e babait, Abdulmutalibit dhe i je dorëzuar Muahmedit?!

Ndërsa Erva (r.a.), e qetë, me durim dhe urtësi e këshilloi vëllain Ebu Lehebin, duke i thënë:

- Ngrihu! Qëndro edhe ti pranë nipit tënd. Ndihej me mirë, mbështete dhe mbroje atë. E, nëse feja e tij triumfon, do jesh nga njerëzit më të mirë e më të shpërblyer.

*Lum për nënat e virtytshme të kësaj toke,  
që trima lindin e rrisin për islamin,  
mjerë për nënat e robëruara pas kësaj bote,  
që zemrat vrasin për shejtanin!*

Ebu Lehebi, i verbuar nga injoranca dhe ashpërsia që mbizotëronte në karakterin e tij, nuk e pranoi këtë këshillë, por duke ushqyer edhe më shumë urrejtje ndaj saj, i tha:

- Mendon se do braktis fenë e etërve tanë arabë, për të përqaftuar këtë risi që na solli Muhamedi mes nesh?!

H. Erva (r.a.), si në periudhën paraislamike, ashtu edhe në periudhën pasislamike, njihej për nderin, urtësinë, moralin dhe virtytin e saj të lartë. Me shpirtin poetik që e karakterizonte, thurte gjithnjë vargje për Profetin (s.a.s.) dhe ata që ndiqnin rrugën e tij.

Rrënoqethëse dhe mbresëlënëse janë këto vargje të skalitura në faqet e historisë:

*Lum për nënat e virtytshme të kësaj toke,  
që trima lindin e rrisin për islamin,*

*mjerë për nënat e robëruara pas kësaj bote,  
që zemrat vrasin për shejtanin!*

Allahu na mundësoftë të gjithave një zemër këmbëngulëse në këtë fe të ndritur, të mbushur me dashuri dhe respekt ndaj Profetit (s.a.s.), ashtu si zemra e sinqertë e Erva binti Abdulmutalibit (r.a.)! Allahu e mëshiroftë dhe e nderoftë me xhennet! Amin.



## FALJA, ulja e njeriut në sexhde, parandalon kancerin



Sipas analizës së bërë nga Instituti Kombëtar i Teknologjisë Laserike në Kajro të Egjiptit, sexhdja ndaj Allahut mbron njeriun nga kanceri.

Sexhdja ndikon shumë pozitivisht tek gratë shtatzëna, duke e mbrojtur embrionin e tyre nga deformimet e mundshme. Krahas kësaj, ndihmon edhe ndaj shumë sëmundjeve trupore dhe psikologjike. Kryetari i Institutit Kombëtar të Teknologjisë Laserike, njëherësh edhe profesor i biologjisë, Muhamed Zijaedin Hamid, pohon se në ditët e sotme trupi i njeriut është duke u përballur me valë të shumta elektromagnetike që vijnë nga çdo anë. Prandaj, është e nevojshme që kjo energji

e tepërt të largohet nga trupi.

“Duke qëndruar në sexhde, njeriu ngacmohet më pak nga valët elektromagnetike dhe me kontaktin e ballit me tokën, largon nga trupi më tepër energji”, pohon profesor Zijaedin. Profeshori thotë se në pozitën e sexhdes, njeriu prek tokën me shtatë pjesët e trupit të tij dhe kjo ndikon në rritjen e energjisë së liruar. Kjo ndikon pozitivisht në eliminimin e lodhjes dhe në shëndetin e njeriut.

Sipas profesorit Zijaedin, për të liruar energjinë në mënyrë sa më të shëndoshë gjatë qëndrimit në sexhde, duhet të kthehemi në drejtim të Qabes që, sipas tij, është edhe qendra e tokës dhe drejtimi kah qendra e tokës është pozicioni më ideal për të liruar energjinë nga trupi.

“Pesë kohët e namazit farz (obligim) janë të mjaftueshme për të larguar energjinë e tepërt nga trupi”, deklaron shkencëtari egjiptian, duke theksuar se tepërcat e formuara gjatë gjumit, largohen gjatë faljes së namazit të sabahut, duke mundësuar një fillim të mbarë dhe të shëndoshë për një ditë të re. Namazi i drekës, i iqindisë dhe akshamit, pakësojnë lodhjen dhe stresin ditor, duke mundësuar një qetësi psikologjike për njeriun, ndërsa namazi i jacisë largon pjesën tjetër të energjisë së tepërt të marrë gjatë ditës, duke mundësuar një gjumë të shëndoshë për njeriun.

## Përdorimi i gabuar i ilaçeve



Ndalja e marrjes së antibiotikëve sapo të shfaqen shenjat e përmirësimit, mund të shkaktojë kthimin e infeksioneve dhe rritjen e sasisë së bakterieve, që bëhen rezistente në antibiotikë të caktuar, theksojnë mjekët.

Për këtë arsye, këshillojnë që kurën me ilaçe, duhet ta pini deri në fund. Nëse harroni të konsumoni të tërën, dhe për këtë gjë kujtoheni dy ditë pas ndaljes, vazhdoni që t’i konsumoni. “Aksidentet” e mundshme, si harrimi i ilaçit apo marrja e rastësishme e dozës së dyfishtë, nuk janë

të rralla, theksojnë ekspertët. Shpesh ndodh, për shembull, konsumimi i dyfishtë i paracetamolit (ilaçi kundër dhimbjeve). Pasi e përmbajnë edhe ilaçet kundër kollës, gripit, madje edhe tabletat për gjumë, njerëzit shpesh marrin dozë të dyfishtë.

“Nëse e bëni këtë gjë vetëm një herë, nuk ka nevojë për panik, por më shumë gabime të tilla mund të shkaktojnë mbidozë dhe dëmtimin e mëlçisë”, paralajmëron doktoresha amerikane Sandra Fryhofer.

Me shkopinj për pastrimin e veshëve, shumë lehtë dëmtohet kanali i veshit. Nëse pas pastrimit të veshëve me shkopinj për veshë ndjeni dhimbje, me siguri e keni gërvishur rastësisht kanalin e veshit, thotë otorinolaringologu amerikan, dr. Ilaaf Darrat. Gërvishtja, mund të shkaktojë infeksion dhe atëherë, më së miri është të vizitoni mjekun.

## Disa këshilla për sëmundjet e stomakut


- ✓ Mjekët janë të mendimit se është më mirë të hahet nga pak dhe shpesh.
- ✓ Mos hani para gjumit, pasi vazhdimi i punës edhe natën e lodh stomakun.
- ✓ Hani minimumi 3-4 orë para gjumit.
- ✓ Hani me kafshata të vogla, për t’u përlypur dhe tretur më mirë.
- ✓ Mos hani në këmbë apo shpejt.
- ✓ Mos hani ushqime shumë të nxehta apo shumë të ftohta.
- ✓ Mos u shtrini menjëherë pas ushqimit.
- ✓ Mos bëni ushtrime gjimnastikore pas ushqimit.
- ✓ Ushqimet me kafeinë (kafeja, kola, çaji) nuk ju bëjnë mirë.
- ✓ Ushqimet apo pijet me aciditet (p.sh lëng portokalli) hollojini me ujë.
- ✓ Mos përdorni alkool apo cigare.
- ✓ Mos përdorni të skuqurat.
- ✓ Mos përdorni shumë qepën.
- ✓ Mos përdorni shumë çokolatën.

## Zbulohet një planet i ngjashëm me tokën

NASA ka vërtetuar ekzistencën e një planeti të ngjashëm me Tokën dhe ku është e mundshme të jetohet. Bëhet fjalë për planetin që quhet "Kepler 22-b" dhe që gjendet në një distancë prej rreth 600 vite dritë nga toka. Ai rrotullohet rreth një ylli të ngjashëm me Diellin tonë (në një distancë 15% më inferiore) dhe është rreth 2.4 herë më i madh se planeti ynë. Planeti blu është më i ngjashmi me Tokën, thonë astronomët dhe ka një periudhë rrotullimi rreth diellit të tij prej 290 ditësh. Ndërkohë që temperaturat aty janë rreth 22 gradë, tamam si në një ditë pranvere. Mirëpo, skuadra e astronomëve nuk e di ende nëse Kepler 22-b është e përbërë nga shkëmbinj, gaz ose ujë.

Zbulimi është bërë nga NASA me rastin e misionit Kepler, që ka si qëllim të gjejë planetë të ngjashëm me Tokën. Faktikisht janë evidentuar rreth 1.094 të tillë, por Kepler

22-b duket se është më afër planetit tonë. "Ky është një gur i rëndësishëm drejt rrugës për të gjetur binjakun e Tokës", ka komentuar Douglas Hudgins i NASA. "Fati na ndihmoi - ka deklaruar një tjetër anëtar i Entit Amerikan për aktivitetin e Hapësirës dhe Aeronautikës, William Borucki. Kontakti i parë me këtë planet erdhi vetëm tre ditë pasi aktivizua teleskopin".



## Ndërhyrje në rrezet e diellit për ftohjen e tokës



Shkencëtarët, studiuesit, si dhe specialistët e fushës, janë duke shqyrtuar mundësinë e një ndërhyrjeje radikale gjeo-inxhinierike për të ftohur Tokën, në mënyrë që të ndalohet ngrohja globale. Pamjet e maleve pa borë në këtë periudhë, kanë terrorizuar shumëkënd, prandaj po kërkohet një zgjidhje për problemin më të madh të shekullit.

Në konferencën për klimën, që është zhvilluar në Afrikën e Jugut, u sugjerua që rrezet e diellit që drejtohen për


në Tokë, të reflektohen sërish në hapësirë, përpara se të godasin sipërfaqen e Tokës. Kjo do të kishte një efekt të menjëhershëm dhe dramatik. Brenda pak vitesh temperaturat globale do ktheheshin në nivelin e 250 viteve më parë, përpara se revolucioni industrial të niste punën për të hedhur dioksid karboni në ajër, çka solli rritjen e temperaturave. Megjithatë, askush nuk e di se cilat do ishin efektet anësore. Në mënyrë të pandërgjegjshme mund të ndryshohej sjellja e motit dhe sasia e shiut që bie. Në raportin e përgatitur nga shkencëtarë e famshëm nga Britania, SHBA e Italia, ka edhe të tjera propozime, që të gjitha shkojnë në një pikë: të ndërhyhet për të ndryshuar klimën në mënyrë artificiale.

## Krimbat në hapësirë

Nëse njerëzit duhet ende të presin para se të shkelin në Mars, duket se rrugën do ta hapin krimbat. Bëhet fjalë për ata të tipit Caenorhabditis (model shumë i përdorur nëpër studime biologjike), të cilët shkencëtarët britanikë i kanë dërguar me sukses në një mision në Stacionin Ndërkombëtar Hapësinor, për të testuar se si i rezistojnë ata udhëtimit në hapësirë. E për çudi, jo vetëm që qëndruan të shëndetshëm, por riprodhuan 24 gjenerata, ndërsa ishin në orbitë. Qëllimi i eksperimentit të kryer nga Universiteti i Notingemit, ishte të shihej se si do ndikojë në trupin e astronautëve udhëtimit i gjatë dyvjeçar drejt Marsit. Krimbat e vegjël, të gjetur në plehra, u dërguan në këtë udhëtim, për shkak se ata kanë 20 mijë gene të ngjashme me njerëzit dhe muskujt e sistemi i tyre nervor punon në të njëjtën mënyrë.

Kur krimbat e mbijetuar u kthyen në tokë, shkencëta-

rët panë se ata kishin një zhvillim normal, ushqeheshin rregullisht dhe kishin kapacitetet për t'u riprodhuar. Ky kërkim mund të ndihmojë shkencëtarët të kuptojnë më shumë në lidhje me sëmundjen e muskujve, të quajtur distrofia muskulare. Po, sepse udhëtimit me gravitet zero shkakton konsumim dramatik të muskujve, pasi reduktohet nivelin i proteinës miozinë, që i mban ata të fortë. Edhe për këtë rast, krimat kanë hasur probleme të ngjashme.



## IRAK: Largohen trupat amerikane, vendi në krizë..!

Në Irak mori fund periudha e sundimit nëntëvjeçar amerikan. Tashmë fillon periudha e udhëheqjes irakiane. Pas shpalljes zyrtare të përfundimit të luftës irakiane nga ana e presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në kryeqytetin e Irakut, Bagdad u organizua ceremonia e uljes së flamurit amerikan. Krahas zyrtarëve civilë dhe ushtarakë irakianë, në ceremoni morën pjesë edhe Sekretari Amerikan i Mbrojtjes, Leon Panetta, Shefi i shtatmadhërisë amerikane, Gjeneral armate, Martin Dempsey dhe komandanti i forcave amerikane në Irak, Gjenerali Lloyd Austin. Gjatë prezencës nëntëvjeçare të forcave amerikane në Irak, janë vrarë 4 mijë e 500 ushtarë amerikanë dhe janë plagosur më shumë se 32.000 të tjerë. Ndërsa, kostoja që pagoi Amerika për luftën në Irak është 1 trilionë dollarë. Ndikimi i luftës për Irakun ishte shumë më i madh. Në ngjarjet e dhunës në vend kanë humbur jetën më shumë se 100 mijë irakianë.

Ushtarët e fundit amerikanë u larguan nga Iraku në fund të muajit të kaluar, duke përfunduar kështu tërheqjen e plotë nga ky vend, që e kishin pushtuar për rreth nëntë vjet. Më 20 mars 2003, forcat amerikane pushtuan Irakun me pretendimin për të rrëzuar ish-diktatorin Saddam Hussein, i cili u kap dhe u ekzekutua që prej asaj kohe. Në këtë vend do të qëndrojnë vetëm 157 ushtarë amerikanë, të ngarkuar

për trajnimin e forcave irakiane dhe një kontigjent nga Marina për mbrojtjen e ambasadës në Bagdad. Karvani i fundit, i përbërë nga 110 makina që transportonin rreth 500 trupa, të cilët i përkisnin brigadës së tretë të divizionit të parë, ka kaluar kufirin në orën 07:30 të datës 18 dhjetor 2011. Ushtria amerikane ka pasur 170.000 trupa dhe ka lënë 505 baza në Irak.

Pas largimit të ushtrisë amerikane, Iraku po përballlet me një nga krizat më të rënda politike. Me vendimin e bllokut laik Iraçiya dhe të ish-kryeministrit lyad Allaoui janë ndërprerë punimet e Parlamentit. Në një komunikatë, Iraçiya kërkoi hapjen e një tryeze të rrumbullakët për gjetjen e një zgjidhjeje në kuadër të mbështetjes së demokracisë dhe institucioneve civile.



Presidenti francez, Nikolas Sarkozy paralajmëroi se rreziku i shpërbërjes së Evropës po bëhet gjithnjë e më i afërt. Gjatë fjalimit në takimin e Partive Popullore Evropiane në Marsejë, Sarkozy kërkoi arritjen e shpejtë të një

marrëveshjeje. "Evropa po përballlet

me një situatë jashtëzakonisht të rrezikshme. Në duhet të arrijmë një marrëveshje e më pas duhet të bëjmë një diagnostikim të ndershëm. Kjo diagnozë është që euro, e cila duhet të nxiste besimin, nuk e bëri këtë. Diagnoza është që Evropa, që duhet të kishte mbrojtur njerëzit, po i shqetëson ata", deklaroi presidenti francez.

Presidenti francez tha se ekonomive të eurozonës u kanë mbetur pak javë për të vendosur dhe koha po punon kundër tyre. "Diagnostikimi është se kemi pak javë për të vendosur dhe koha po punon kundër nesh. Nëse nuk biem dakord për këtë, kam frikë se nuk do të biem dakord për asgjë. Kjo është diagnoza; si të dalim nga kjo situatë?", tha Sarkozy.

Kancelarja gjermane, Angela Merkel foli për ndryshi-

## EVROPA: Afër "shpërbërjes"

me në Kushtetutën Evropiane. Sipas saj, të 27 anëtarët i detyrohen Evropës dhe duhet të punojnë bashkë për të tejkaluar krizën e eurozonës dhe për këtë, egot dhe interesat kombëtare duhet të lihen mënjanë. "Ne duhet të ndryshojmë traktatet në atë mënyrë, që institucionet e përbashkëta të marrin më shumë përgjegjësi, veçanërisht Komisioni. Ne duhet të mbështesim vendimet e Komisionit më shumë se çka ndodhur në të shkuarën, ku vendet anëtare, përfshirë edhe Gjermaninë, sollën dobësimin e rregullave", tha Merkel.

Ndërsa Sarkozy dhe Merkel flisnin në kongresin e PPE-së, Banka Qendrore Evropiane uli normën e interesit në 1%. Presidenti i saj, Mario Draghi u bëri thirrje qeverive evropiane të ulin huamarrjen dhe të reformojnë ekonominë e tyre, por pa përmendur ndonjë mbështetje financiare nga BQE për vendet në vështirësi. Më herët, shefi i Komisionit Europian, Jose Manuel Barroso u bëri thirrje vendeve të eurozonës të bëjnë ç'është e mundur për të shpëtuar euron në prag të së premtes që do të zhvillohet në Bruksel. "Është tejet e rëndësishme të tregojmë që euro nuk zhbëhet", tha Barroso. Edhe SHBA ka interes në suksesin e këtij samiti. Kjo u nënvizua gjatë takimit në Romë mes Sekretarit Amerikan të Thesarit, Timothy Gaitner dhe kryeministrit italian, Mario Monti.